

UDHËZUES LIGJOR PËR TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË

UDHËZUES LIGJOR PËR TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË

*Ky udhëzues trajton legjislacionin relevant të Republikës së Kosovës në fuqi deri
më 31.12.2025.*

AUTORËT:

ADEM VOKSHI – PARTNER

FLORIN LATA – PARTNER

URIM VOKSHI – PARTNER

AGNESA AZEMI ADEMI – AVOKATE

ARDRIT HUMOLLI – AVOKAT

GENT NUZA – AVOKAT

BURIM BALECI – AVOKAT

VALMIR HAZIRAJ - BASHKËPUNËTOR

DIART GASHI – BASHKËPUNËTOR

LAURETA HAZIRI – BASHKËPUNËTORE

KUSHTRIM MUSLIU – BASHKËPUNËTOR

FLORENTINA LATA – MENAXHERE OPERACIONALE E ZYRËS

DHE PR-IT

DIZAJNI:

MAKFIRE ALIU

Të drejtat e autorit

Ky publikim është pronë ekskluzive e Shoqërisë së Avokatëve “Vokshi & Lata” dhe mbrohet nga ligji për të drejtat e autorit. Çdo riprodhim, shpërndarje, ekspozim publik ose përshtatje e këtij publikimi për qëllime komerciale është rreptësisht e ndaluar pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Shoqërisë së Avokatëve “Vokshi & Lata”.

Ky publikim mund të shpërndahet ose ndahet lirshëm për qëllime jo-komerciale, me kusht që të bëhet citimi i duhur i autorit brenda publikimit.

Të drejtat e autorit © 2026, Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

KUFIZIM I PËRGJEGJËSISË

Informacioni i ofruar në këtë udhëzues ka vlerë të përgjithshme dhe nuk përbën këshillë ligjore. Asnjë lexues nuk duhet të veprojë bazuar në këtë informacion pa kërkuar këshillë profesionale. Megjithatë jemi përpjekur të sigurojmë informacion të saktë dhe në kohë, autorët dhe Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” nuk mbajnë përgjegjësi për ndonjë pasaktësi ose lëshim në përmbajtje të këtij udhëzuesi.



Fjala hyrëse

Në emër të Shoqërisë së Avokatëve “Vokshi & Lata” dhe autorëve të këtij botimi, kemi kënaqësinë të prezantojmë edicionin e parë në gjuhën shqipe të “Udhëzuesit Ligjor për të Bërit Biznes në Kosovë”.

Ky udhëzues është hartuar për t'i shërbyer bizneseve që veprojnë në Kosovë, si dhe profesionistëve që merren me çështje ligjore, financiare apo menaxheriale në sektorin privat. Ai synon të ofrojë një pasqyrë të përditësuar dhe praktike mbi kornizën ligjore që ndikon drejtpërdrejt në aktivitetin e përditshëm të biznesit, nga themelimi dhe punësimi, te tatimet, kontratat, sektori energjetik, prokurimi publik dhe fusha të tjera relevante.

Pas botimeve të mëparshme në anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht, ky udhëzues është zhvilluar si një verzion i dedikuar për komunitetin e biznesit në Kosovë, me fokus në çështjet praktike që hasen në mjedisin vendor.

Ju inkurajojmë ta përdorni këtë udhëzues si referencë praktike dhe të na dërgoni komente apo sugjerime për edicionet e ardhshme.

Shpresojmë që të ju ndihmojë në punën tuaj të përditshme dhe në orientimin e saktë brenda kuadrit ligjor në Kosovë.





Për Shoqërinë e Avokatëve “Vokshi & Lata”

Rrënjët profesionale të “Vokshi & Lata” datojnë që nga viti 1982, kur Avokati Adem Vokshi filloi ushtrimin e profesionit të avokatit pas një karriere si gjyqtar. Kjo përvojë u zhvillua ndër vite përmes përfshirjes së brezit të dytë dhe partnerëve të rinj, duke kulmuar me krijimin e strukturës aktuale të firmës si një nga shoqëritë ligjore më të konsoliduara në Kosovë.

Nga një zyrë që nisi në Mitrovicë, deri tek ekipi i sotëm me kapacitet të plotë shërbimi, firma është ndërtuar mbi përvojë afatgjate, stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm profesional.

Fokusi ynë mbetet i qartë: të ofrojmë këshilla ligjore të qëndrueshme dhe të zbatueshme për realitetin e tregut. Ekipi përfshin avokatë me përvojë në fushat komerciale, energji dhe infrastrukturë, tatime, punësim, prokurim publik, pronësi intelektuale dhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve, përfshirë arbitrazhin ndërkombëtar.

Struktura e brendshme është ndërtuar për të garantuar përgjegjësi, reagim të shpejtë dhe qasje të personalizuar për çdo klient. Për ne, çdo projekt është një proces serioz bashkëpunimi, jo një shërbim i standardizuar.

Përveç praktikës ligjore, “Vokshi & Lata” kontribuon në mënyrë të vazhdueshme në edukimin juridik dhe qartësimin e mjedisit të të bërit biznes në Kosovë, përmes publikimeve dhe analizave që janë të qasshme edhe në webfaqen zyrtare të firmës: www.vokshilata.com

SISTEMI GJYQËSOR	16
1. SHOQËRITË TREGTARE	22
1.1. SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.)	23
1.1.1. Pronësia në SH.P.K.	24
1.1.2. Qeverisja e SH.P.K. – së	25
1.2. SHOQËRIA AKSIONARE (SH.A.)	27
1.2.1. Pronësia në SH.A.	27
1.2.2. Qeverisja e SH.A. - së	28
1.3. SUBJEKTET E TJERA PA PERSONALITET JURIDIK TË VEÇANTË	29
1.3.1. Biznesi Individual	29
1.3.2. Ortakëria e Përgjithshme	29
1.3.3. Ortakëria e Kufizuar	29
1.4. FORMAT E VEÇANTA TË ORGANIZIMIT PËR SHOQËRITË E HUAJA TREGTARE	30
1.4.1. Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare	30
1.4.2. Zyra e Përfaqësisë së Shoqërisë së Huaj Tregtare	30
2. PUNËSIMI DHE LIGJI I PUNËS	34
2.1. KUSHTET DHE KRITERET PËR THEMELIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KOSOVË	35
2.2. KONTRATA E PUNËS	35
2.3. ORARI I PUNËS DHE PUSHIMET	37
2.4. PAGA DHE PËRFITIMET TJERA TË TË PUNËSUARVE	39
2.5. MBROJTJA DHE SIGURIA NË VENDIN E PUNËS	39
2.6. MASAT DISIPLINORE DHE SHKËPUTJA E KONTRATËS SË PUNËS	41
2.6.1. Masat Disiplinore	41
2.6.2. Ndërprerja e Marrëdhënies së Punës	41
2.6.3. NJOFTIMI PËR NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIES SË PUNËS	43
2.7. MBROJTJA E VEÇANTË E KATEGORIVE TË CAKTUARA TË TË PUNËSUARVE	43
2.8. NDALIMI I DISKRIMINIMIT	44
2.9. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË TË PUNËSUARVE: PROCEDURAT DHE MJETET JURIDIKE	45

2.10. PUNËSIMI I TË HUAJVE	46
2.10.1. Kush mund të aplikojë për lejeqëndrim të përkohshëm?	47
2.10.2. Aspektet Procedurale	47
2.10.3. Kriteret për Dhënien e Lejeqëndrimit të Përkohshëm?	48
2.11. MBROJTJA E SINJALIZUESVE DHE MEKANIZAMET E RAPORTIMIT	49
2.11.1. Mbrojtja Ligjore	50
2.11.2. Detyrimet e Bizneseve dhe Institucioneve	50
2.11.3. Përcaktime ligjore shtesë dhe me rëndësi	50
3. TATIMET NË KOSOVË	54
1. TATIMI NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE	55
1.1. Tatimpaguesit	55
1.2. Të Ardhurat e Tatueshme	55
1.3. Përjashtimet nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatës	57
1.4. Zbritjet	58
1.5. Çmimet e Transferimit/Transfer Pricing	60
1.6. Pagesa e Tatimit	61
2. TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	62
2.1. Tatimpaguesit	62
2.2. Normat Tatimore të TAP	62
2.3. Të Ardhurat e Tatueshme	62
2.4. Të Ardhurat e Përjashtuara nga TAP	63
2.5. Detyrimet për Pagesa	64
2.6. Deklarimi	65
3. TATIMI MBI VLERËN E SHITUAR (TVSH)	66
3.1. Personat e Tatueshëm	66
3.2. Regjistrimi	67
3.3. Normat e TVSH-së	67
3.4. Përjashtimet	68
3.5. Zbritja	68
4. TAKSAT DOGANORE DHE AKCIZAT	69
4.1. Taksat Doganore	69
4.2. Akcizat	69

4.	SEKTORI FINANCIAR	72
4.1.	BANKAT	73
4.2.	INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKORE	75
4.2.1.	Institucionet Mikrofinanciare	75
4.2.2.	Institucionet Financiare Jobankare (IFJB)	76
4.3.	SIGURIMET	77
4.4.	KRIPTO-ASETET	79
4.4.1.	Aplikimi për Licencim	79
4.4.2.	Kriteret Kryesore të Licencimit	80
5.	INVESTIMET E HUAJA	84
5.1.	LIGJI PËR INVESTIMET E QËNDRUESHME	84
5.1.1.	Të drejtat e investitorëve të huaj	85
5.1.2.	Prioritetet dhe Lehtësirat për Investitorët e Huaj	86
5.2.	INVESTIMET STRATEGJIKE	89
5.3.	ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE	91
5.3.1.	Paneli ankimor dhe ankesa e investitorit	92
5.3.2.	Procedurat gjyqësore	92
5.3.3.	Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi	93
5.4.	MARRËVESHJET E TREGTISË SË LIRË DHE TRAKTATET TJERA	95
5.4.1.	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (Cefta)	95
5.4.2.	Marrëveshja e Stabilizim-Associimit (MSA)	96
5.4.3.	Marrëveshja për Tregti të Lirë me Republikën e Turqisë	97
5.4.4.	Shoqata Evropiane për Tregti të Lirë	98
5.4.5.	Heqja e taksës për mallrat nga SHBA	99
6.	PROKURIMI	102
6.1.	PROKURIMI PUBLIK	102
6.1.1.	Parimet e Përgjithshme	103
6.1.2.	Institucionet Qendrore	104
6.1.3.	Procedura e Prokurimit	105
6.1.4.	Parimet themelore të shqyrtimit të prokurimit	106
6.1.5.	Ankesat në procedurën e prokurimit	107
6.2.	PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT	107
6.2.1.	Llojet e PPP-së	108

6.2.2. Organet kompetente	109
6.2.3. Procedurat e PPP-së	110
7. PALUAJTSHMËRITË	114
7.1. SEKTORI I NDËRTIMIT – FOKUS I VEÇANTË	114
7.2. TË DREJTAT MBI PRONËN E PALUAJTSHME	117
7.2.1. Fitimi i pronësisë mbi pronën e paluajtshme	117
7.2.2. Hipoteka	118
7.2.3. Servitutet	119
8. PRONËSIA INTELEKTUALE	122
8.1. E DREJTA E AUTORIT DHE PRONËSIA INDUSTRIALE	123
8.1.1. Të Drejtat e Autorit	123
8.1.2. Markat Tregtare	125
8.1.3. Patentat dhe Dizajnet Industriale	127
8.1.4. Treguesit Gjeografikë	129
8.1.5. Sekretet Tregtare	130
8.2. MARRËVESHJET PËR PRONËSI INTELEKTUALE	131
8.2.1. Bartja e Pronësisë Intelktuale	131
8.2.2. Kontrata e Licencës	132
8.2.3. Marrëveshja e Franshizës	133
9. KONKURRENCA	136
9.1. NDALIMI I MARRËVESHJEVE KARTEL	136
9.1.1. Marrëveshjet e ndaluara	136
9.1.2. Përjashtimet	137
9.2. NDALIMI I KEQPËRDORIMIT ME POZITËN DOMINUESE	138
9.2.1. Pozita Dominuese	139
9.2.2. Keqpërdorimi me Pozitën Dominuese	139
9.3. PËRQËNDRIMI	140
9.3.1. Përkufizimi	140
9.3.2. Detyrimi për Miratim Paraprak nga AKK	141
10. MBROJTJA E KONSUMATORIT	146
10.1. PRAKTIKAT E PADREJTA TREGTARE	146
10.2. REKLAMIMI DHE MBROJTJA E MITURVE	148
10.3. ETIKETAT, PAKETIMI DHE TREGUESIT E ÇMIMEVE	148

10.4.	MUNGESA E PËRPUTHSHMËRISË	150
10.5.	TË DREJTAT E KONSUMATORIT NË LIDHJE ME KONTRATËN	150
11.	TREGTIA ELEKTRONIKE	156
11.1.	DETYRIMI I INFORMACIONIT	156
11.2.	SHËRBIMET E SHOQËRISË INFORMATIKE	158
11.3.	FATURIMI DHE PAGESA ELEKTRONIKE	160
11.4.	IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK	160
11.4.1.	Nënshkrimi Elektronik	161
11.4.2.	Vula Elektronike	163
12.	MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	166
12.1.	LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE	166
12.1.1.	Parimet dhe kërkesat kryesore	167
12.1.2.	Të Drejtat e Subjektit të të Dhënave	168
12.1.3.	Detyrimet e Kontrolluesit dhe Përpunuesit të të Dhënave	172
12.1.4.	Transferimi Ndërkombëtar i të Dhënave	177
12.1.5.	Ndëshkimet dhe gjokat	178
12.2.	UDHËZUES PRAKTIK: SI TË FILLONI ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË BIZNESIN TUAJ	178
12.3.	SANKSIONET DHE GJOBAT NË RASTET E SHKELJEVE TË TË DHËNAVE PERSONALE	181
12.4.	LIGJI PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE	184
13.	E DREJTA E MJEDISIT	188
13.1.	LEJET MJEDISORE	188
13.1.1.	Pëlqimi Mjedisor	189
13.1.2.	Leja Mjedisore	190
13.1.3.	Leja e Integruar	190
13.1.4.	Autorizimi Mjedisor	191
13.1.5.	Lejet Mjedisore Komunale	191
13.2.	LEJET UJORE	192
13.2.1.	Leje Ujore	192
13.2.2.	Koncesionet për ujëra	193

14.	SEKTORI I ENERGJISË	196
14.1.	INFORMATATA TJERA SHITESË NË LIDHJE ME SEKTORIN E EN- ERGJISË NË KOSOVË	197
14.2.	ANKANDI I PARË SOLAR NË KOSOVË	199
14.3.	ANKANDI ENERGJISË SË ERËS SI NJË MOMENT KYÇ	200
14.4.	STRATEGJIA E ENERGJISË SË KOSOVES 2022-2031	200
14.5.	LIGJI PËR PROMOVIMIN E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË	201
14.6.	PIKA KYÇE TË POLITIKËS DHE MARRËDHËNIEVE PËR INVESTIME	202
15.	FALIMENTIMI	206
15.1.	PASOJAT	206
15.1.1.	Riorganizimi	206
15.1.2.	Likuidimi	207
15.2.	PROCEDURA E FALIMENTIMIT	209
	FJALË PËRMBYLLËSE	213

SISTEMI GJYQËSOR

SISTEMI GJYQËSOR

Kosova ka bërë përpjekje të rëndësishme për të modernizuar gjyqësorin e saj. Shteti garanton ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë gjyqësore sipas Kushtetutës së tij.

Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës në shkallë të parë përfshin:

Gjykatën Themelore – që shërben si gjykatë e shkallës së parë, me seli në shtatë qendra rajonale që përbëjnë ndarje gjeografike të gjykatës themelore.

Shtatë Gjykatat Themelore funksionale në Republikën e Kosovës janë:

Gjykata Themelore e Prishtinës – me degët e saj në komunën e Podujevës, Graçanicës, Lipjanit, Gllgovcit, dhe Fushë Kosovës.

Gjykata Themelore e Mitrovicës – me degët e saj në komunën e Skenderajit, Vushtrisë, Leposaviqit, dhe Zubin Potokut.

Gjykata Themelore e Pejës – me degët e saj në komunën e Istogut, Klinës, dhe Deçanit.

Gjykata Themelore e Prizrenit – me degët e saj në komunën e Dragashit dhe Suharekës,

Gjykata Themelore e Ferizajit – me degët e saj në komunën e Kaçanikut dhe Shtërpçës.

Gjykata Themelore e Gjilanit – me degët e saj në komunën e Kamenicës, Vitisë, dhe Novobërdës.

Gjykata Themelore në Gjakovë – me degët e saj në komunën e Malishevës dhe Rahovecit.

Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, me përjashtim të çështjeve që janë kompetencë e Gjykatës Komerciale dhe Gjykatës Administrative.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale – që shërbejnë si një institucion i specializuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve komerciale dhe atyre të lidhura me investimet.

Ajo përfshin departamentin për çështje ekonomike dhe departamentin e përgjithshëm.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë ka jurisdiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe selinë e ka në Prishtinë.

Gjykatën Administrative – që shërben si gjykatë kompetente për të vendosur në shkallë të parë lidhur me të gjitha konfliktet administrative dhe të gjitha kontestet nga marrëdhënia e punës në mes të personit fizik dhe organeve publike me përjashtim të ndërmarrjeve publike.

Në kuadër të Gjykatës Administrative funksionojnë Departamenti Fiskal, Departamenti për Konteste të Punës, Departamenti për Skemat Sociale dhe Pensionale, dhe Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata Administrative ka jurisdiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe selinë e ka në Prishtinë.

Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës në shkallë të dytë përfshin:

Gjykatën e Apelit të Kosovës – e cila vepron si gjykatë e shkallës së dytë për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata e Apelit të Kosovës i gjykon lëndët e pranuar nga ndonjëra prej gjykatave themelore pas ushtrimit të ankesës si dhe vendos lidhur me konfliktin e kompetencës midis gjykatave themelore.

Për të mundur një proces sa më efikas, Gjykata e Apelit i ka të funksionalizuar 6 departamente dhe atë: Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për Krime të Rënda, Departamenti për Çështje Administrative, Departamenti Special, Departamenti për të Mitur, dhe Departamenti për të Mitur.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale – veprojnë si gjykatë e shkallës së dytë për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale i gjykojnë lëndët e pranuar nga Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale pas ushtrimit të ankesës.

Për të mundësuar një proces sa më efikas, Dhomat e Shkallës së Dytë i ka të funksionalizuar 2 departamente dhe atë Departamentin për Çështje Ekonomike dhe Departamentin e Përgjithshëm.

Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës në shkallë të tretë përfshin:

Gjykatën Supreme të Kosovës – e cila shërben si instanca më e lartë gjyqësore në Republikën e Kosovës dhe ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës përfshin kolegjin e apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Selia e Gjykatës Supreme të Kosovës është në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur lidhur me:

- kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës;
- revizionit, kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së dytë në çështjet kontestimore;
- ankesat në shkallë të tretë, të lejuara me ligj;
- përcakton qëndrime parimore, nxjerrë mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat e Kosovës;
- lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronave;
- lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ose të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Në kuadër të Gjykatës Supreme të Kosovës funksionon: Dega Penale, Dega Civile, Dega Administrative, si dhe Praktika Gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës – është themeluar në janar të vitit 2009. Gjykata Kushtetuese e Kosovës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Ajo siguron funksionalitetin e institucioneve të vendit në pajtim me Kushtetutën dhe garanton mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive individuale të garantuara me Kushtetutë.

Përderisa gjykatat e niveleve të tjera merren me shqyrtimin e fakteve, me verifikimin e ligjshmërisë së krijimit dhe të marrjes së provave, Gjykata Kushtetuese merret vetëm me kontrollin kushtetues të procesit të rregullt gjyqësor.

Sistemet e Noterisë dhe Përmbartimi Privat – Kosova ka mekanizma efektivë për shërbimet e noterisë dhe përmbartimi privat. Noterët luajnë një rol kyç në legalizimin dhe autentifikimin e dokumenteve, ndërsa procedurat e përmbartimit privat ofrojnë bizneseve një mekanizëm ekonomik për të ekzekutuar dokumente ligjore dhe për të mbledhur borxhet.



SHOQËRITË TREGTARE



1. SHOQËRITË TREGTARE

Banka Botërore e ka renditur Republikën e Kosovës në vendin e 12-të nga 190 shtete duke e vlerësuar me “starting a business score” me 95.9/100. Ky vlerësim ka ardhur pasi që për kritere të vlerësimit janë marrë parasysh proceduat, koha, kostoja dhe kërkesa ligjore për kapital të nevojshëm për hapjen e një biznesi në Republikën e Kosovës. Të huajt dhe bizneset e huaja mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore në Republikën e Kosovës pa ndonjë kufizim të veçantë. Procesi i themelimit dhe regjistrimit të biznesit është i njëjtë si për bizneset vendore ashtu edhe për ato të huaja dhe i njëjti kuadër ligjor zbatohet për të dyja. Në përputhje me kërkesat ligjore të zbatueshme për bizneset vendore, shoqëritë e huaja që synojnë të ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Kosovës janë të obliguara të fillojnë procesin e regjistrimit të biznesit pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (në vijim “ARBK”), si hap paraprak.

Regjistrimi i një biznesi në Kosovë është një proces i thjeshtë dhe i shpejtë. Procesi i regjistrimit në ARBK zgjat mesatarisht tre (3) ditë pune. Prania fizike e pronarit apo e drejtorit të shoqërisë nuk është e detyrueshme.

Aplikimi për regjistrim mund të bëhet fizikisht në njërin nga 29 qendrat komunale të ARBK-së, varësisht nga vendndodhja e aktivitetit. Po ashtu, aplikimi mund të realizohet edhe online përmes platformës së Regjistrimit të Bizneseve të ARBK-së (<https://rbk.rks-gov.net/>).

Është e rëndësishme të theksohet se, sipas ndryshimeve të fundit ligjore, ekziston obligimi i detyrueshëm për të dokumentuar dhe dorëzuar të dhënat për pronarin përfitues përfundimtar (në vijim “PPF” – Ultimate Beneficial Owner) gjatë themelimit të shoqërisë pranë ARBK-së. Të dhënat e kërkuara duhet t’i dorëzohen ARBK-së nga personi i autorizuar në momentin e regjistrimit fillestar. Për më tepër, subjekti i obliguar duhet ta njoftojë Agjencinë për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues (ARPP) për çdo ndryshim në të dhënat e personit të autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga dita e ndodhjes së ndryshimit. Mosraportimi i këtyre ndryshimeve mund të rezultojë me vendosjen e gjobave administrative dhe sanksioneve të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pas regjistrimit të shoqërisë dhe pajisjes me Certifikatën e Biznesit, hapat e parë të përgjithshëm përfshijnë hapjen e një llogarie bankare (e cila nuk kërkon praninë e pronarit), dizajnimin e vulës së shoqërisë

dhe pajisjen me certifikatë të TVSH-së (nëse shoqëria regjistrohet vullnetarisht për TVSH në momentin e themelimit).

Investitorët mund të ushtrojnë veprimtari përmes strukturave me ose pa personalitet juridik të veçantë nga themeluesit e tyre. Megjithatë, shoqëritë tregtare me personalitet juridik, si Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (1.1) ose Shoqëritë Aksionare (1.2), zakonisht preferohen ndaj atyre pa personalitet juridik (1.3), me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së investitorëve. Sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës ekzistojnë edhe forma të veçanta të organizimit afarist (1.4) të përshtatshme për shoqëritë e huaja.

1.1. SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.)

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.) është forma më e zakonshme e organizimit të shoqërive tregtare në Kosovë, veçanërisht për investitorët e huaj, pasi që përfshin një barrë më të vogël krahasuar me shoqëritë tjera, si Shoqëria Aksionare, duke ofruar njëkohësisht mbrojtje përmes përgjegjësisë së kufizuar për aksionarët e saj. Sh.p.k.-të kërkojnë më pak dokumentacion, më pak formalitete dhe kanë më pak obligime të vazhdueshme për përputhshmëri ligjore. Aksionarët e një sh.p.k.-je mund të jenë persona fizikë, persona juridikë apo subjekte të tjera dhe kanë liri të zgjedhin mënyrën e menaxhimit të shoqërisë. Sh.p.k.-të i nënshtrohen regjistrimit të detyrueshëm pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Për regjistrimin e një sh.p.k.-je në Kosovë, duhet të përgatitet një set dokumentesh thelbësore, duke përfshirë formularin e regjistrimit të lëshuar nga ARBK, statutin e shoqërisë, marrëveshjen e inkorporimit, kopje të dokumenteve të identifikimit (si letërnjoftime apo pasaporta) për aksionarët dhe personat e autorizuar të përfshirë në veprimtarinë e shoqërisë, si dhe pëlqimin e agjentit të regjistruar.

Sh.p.k.-ja themelohet nga një ose më shumë themelues, është e ndarë dhe e pavarur nga aksionarët e saj dhe, si e tillë, gëzon personalitet juridik të veçantë. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar përgjigjet për të gjitha borxhet dhe obligimet e saj me tërë pasurinë e vet, ndërsa aksionarët e saj nuk mbajnë përgjegjësi për borxhet apo obligimet e shoqërisë vetëm për faktin se janë aksionarët të saj.

1.1.1. Pronësia në SH.P.K.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K.) mund të ketë një ose më shumë aksionarë. Aksionarët mund të jenë persona fizikë ose persona juridikë dhe/ose organizata afariste. Organizatat joqeveritare (OJQ) nuk mund të jenë aksionare. Një aksion (kuotë) mund të jetë në pronësi të më shumë se një aksionari. Bashkëpronarët përgjigjen në mënyrë solidare për të gjitha obligimet që lidhen me pjesëmarrjen e tyre, por i ushtrojnë të drejtat e tyre në SH.P.K. përmes një përfaqësuesi të përbashkët.

Sipas legjislacionit në Kosovë nuk ka kërkesë për kapital themeltar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Gjithsesi, një SH.P.K. mund të krijoj kapital të saj, sipas vullnetit dhe interesit të saj. Pagesa e kapitalit mund të bëhet përmes transferit monetar, kontributeve në pasuri materiale ose jomateriale, si dhe përmes punës apo shërbimeve të kryera paraprakisht. Vlerësimi i kontributeve jo-monetare duhet të jetë në përputhje me statutin e SH.P.K.-së. Në rastet kur statuti nuk përcakton metodën e vlerësimit, ajo caktohet me pëlqimin unanimit të aksionareve.

Aksionarët janë të obliguar t'i paguajnë kontributet e tyre sh.p.k.-së brenda afateve të përcaktuara në statut ose në marrëveshje të tjera ndërmjet aksionareve. Statuti i SH.P.K.-së mund të parashohë masa ndëshkuese ose sanksione në rast të mospagesës së kontributeve nga ana e aksionareve.



Dividentat mund t'i paguhet aksionarëve nga fitimi neto ose nga fitimi i mbajtur i viteve paraprake, pasi të jenë zbritur humbjet e viteve të mëparshme, bazuar në raportin vjetor financiar të miratuar. Dividentat mund të shpërndahet tek aksionarët në çdo kohë me pëlqimin unanimit të aksionareve, përveç rasteve kur Statuti i SH.P.K.-së përcakton një metodë votimi që kërkon një shumicë më të vogël. Shpërndarja bëhet në mënyrë të barabartë për të gjithë aksionaret, përveç nëse statuti parashikon ndryshe.

Sh.p.k.-ja nuk mund të bëjë shpërndarje të dividendëve nëse kjo do të bënte që pasuritë totale të jenë më të vogla se detyrimet totale ose nëse nuk do të ishte në gjendje të shlyente borxhet dhe obligimet e saj normale. Ligji për Shoqëritë Tregtare parashikon përgjegjësi personale për kthimin e dividendëve të ndaluar për ata që i kanë marrë ose shpërndarë me dijeni. Nëse janë të përfshirë më shumë se një person, përgjegjësia është solidare.

1.1.2. Qeverisja e SH.P.K. – së

Sh.p.k.-ja menaxhohet nga të paktën një Drejtor Menaxhues, i cili përfaqëson shoqërinë dhe, si i tillë, ka të drejtë të kryejë veprimtari të zakonshme biznesore dhe të nënshkruajë marrëveshje ose dokumente të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë. Drejtori Menaxhues emërohet dhe mund të shkarkohet nga aksionarët ose, nëse është themeluar, nga Bordi i Drejtorëve. Nuk është e detyrueshme që Drejtori Menaxhues të jetë aksionar. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në Statut, Drejtori Menaxhues emërohet deri në shkarkim ose zëvendësim nga aksionarët ose Bordi i Drejtorëve, ose deri në dorëheqje.

Drejtori Menaxhues është përgjegjës për mbajtjen e librave dhe regjistrave të SH.P.K.-së dhe për sigurimin e qasjes së aksionarëve të këto dokumente. Megjithatë, aksionarët mund të kufizojnë të drejtat dhe autorizimet e Drejtorit Menaxhues përmes dokumenteve të brendshme të shoqërisë. Raporti financiar nënshkruhet nga Drejtori Menaxhues ose Kryetari i Bordit Menaxhues.

Sh.p.k. mund të themelojë gjithashtu një Bord Drejtues, megjithatë kjo nuk është e detyrueshme. Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen dhe shkarkohen nga Kuvendi i Aksionarëve. Bordi Drejtues rregullohet me Statutin e SH.P.K.-së, i cili duhet të përcaktojë autorizimet e bordit,

numrin e anëtarëve, mënyrën e emërimit, afatin e mandatit dhe metodën e votimit. Nëse themelohet, Bordi Drejtues mund të emërojë dhe shkarkojë Drejtorët Menaxhues.

Bordi Drejtues mund të emërojë më shumë se një Drejtor Menaxhues, dhe secili prej tyre mund të përfaqësojë SH.P.K.-në në kryerjen e të gjitha transaksioneve, përveç nëse Bordi ka vendosur që disa ose të gjithë Drejtorët Menaxhues ta përfaqësojnë shoqërinë në mënyrë të përbashkët. Përfaqësimi i përbashkët aplikohet për palët e treta vetëm nëse kjo regjistrohet në Regjistrë dhe publikohet nga ARBK. Dispozitat që zbatohen për Bordet e Drejtorëve të Shoqërive Aksionare zbatohen gjithashtu për Bordet e Drejtorëve të SH.P.K.-ve.

Kuvendi i Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i sh.p.k.-së. Çështjet e rezervuara për aksionarët përfshijnë ndryshimin e Statutit të shoqërisë, lëshimin e aksioneve të reja, transferimin e aksioneve ose pranimin e aksionarëve të rinj, vendimin për shitjen ose transferimin e më shumë se gjysmës së pasurive të shoqërisë, si dhe zgjedhjen ose shkarkimin e Drejtorit Menaxhues dhe anëtarëve të Bordit Drejtues. Kuvendi i Aksionarëve mund të marrë gjithashtu vendime brenda kompetencave të Drejtorit Menaxhues ose Bordit Drejtues.

Është e detyrueshme të mbahet të paktën një mbledhje e Kuvendit të Aksionarëve në vit. Njoftimi për mbledhje duhet të dërgohet të paktën 30 ditë para datës së planifikuar. Mbledhje të jashtëzakonshme mund të thërrasë Drejtori Menaxhues, Kryetari i Bordit Drejtues, ose në kërkesë të aksionarëve që përfaqësojnë të paktën 10% të votave për çështjen në fjalë. Njoftimi për mbledhjen e jashtëzakonshme duhet të dërgohet të paktën 7 ditë para datës së planifikuar. Mbledhja e Kuvendit të Aksionarëve mund të mbahet gjithashtu online.

Përveç nëse Statuti përcakton ndryshe, vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave. Megjithatë, votimi unanim është i nevojshëm për ndryshimin e Statutit dhe për shitjen, qiradhënien, hipotekimin ose transferimin tjetër të 51% ose më shumë të pasurive totale të sh.p.k.-së. Nëse sh.p.k.-ja ka vetëm një aksionar, ai aksionar ushtron të gjitha kompetencat e Kuvendit të Aksionarëve.

1.2. SHOQËRIA AKSIONARE (SH.A.)

Shoqëria Aksionare (SH.A.) është person juridik në pronësi të një ose më shumë aksionarëve por është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët. Ajo përgjigjet për të gjitha borxhet dhe detyrimet e saj. Shoqëritë Aksionare i nënshtrohen regjistrimit të detyrueshëm pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Për regjistrimin e një Shoqërie Aksionare në Kosovë kërkohen dokumentet e mëposhtme: formulari i regjistrimit të lëshuar nga ARBK, Statuti i shoqërisë, Memorandumi i Inkorporimit i nënshkruar nga themeluesit, dokumentet e identifikimit të aksionarëve dhe të personave të autorizuar, si dhe pëlqimi i agjentit të regjistruar. Shoqëritë Aksionare mund të miratojnë gjithashtu rregulloren e brendshme që përcakton menaxhimin e tyre të brendshëm.

1.2.1. *Pronësia në SH.A.*

Aksionet në Shoqërinë Aksionare janë njësitë në bazë të cilave ndahen interesat pronësore në Shoqërinë Aksionare. Shoqëria Aksionare mund të lëshojë aksione të thjeshta dhe të privileguara, sipas përcaktimeve në statutin e tyre. Ato mund të lëshojnë gjithashtu instrumente të tjera financiare, si obligacione, instrumente të konvertueshme ose opsione aksionesh. Secili aksion i të njëjtës klasë duhet të ketë vlerë të barabartë. Aksionet e thjeshta nuk mund të konvertohen në aksione të privileguara ose në instrumente të tjera financiare. Të paktën një aksion i thjeshtë duhet të lëshohet.

Kërkesa minimale për kapitalin themelor të SH.A.-ve është 10,000.00 Euro. Kontributet mund të bëhen në para ose në pasuri jomonetare, të cilat duhet të vlerësohen nga një vlerësues i pavarur dhe i autorizuar dhe të miratohen nga Bordi i Drejtorëve. Puna ose shërbimet nuk pranohen si kontribut, përveç nëse realizohen përmes një skeme të miratuar të aksioneve për punonjësit.

Aksionarët nuk mbajnë përgjegjësi personale për obligimet e shoqërisë, përveç rasteve të abuzimit ose mashtrimit.

Dividentët mund të shpërndahen vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

- *Pasuritë neto mbeten mbi kapitalin themelor të regjistruar dhe të paguar;*
- *Pasuritë totale tejkalojnë detyrimet;*
- *Shoqëria mbetet likuide dhe në gjendje të paguajë detyrimet;*
- *Dividentët nuk tejkalojnë fitimet e shpërndara.*

1.2.2. Qeverisja e SH.A. - së

Çdo Shoqëri Aksionare duhet të ketë Bordin e Drejtorëve, institucion përmes të cilit shoqëria menaxhohet.

Bordi i Drejtorëve duhet të përbëhet nga të paktën një anëtar në rast se Shoqëria Aksionare ka më pak se dhjetë aksionarë, dhe të paktën tre anëtarë në rast se ka dhjetë ose më shumë aksionarë. Anëtarët janë persona fizikë dhe nuk është e nevojshme që të jenë aksionarë ose rezidentë të Kosovës, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Statut.

Bordi është përgjegjës për strategjinë e shoqërisë, mbikëqyrjen, kontrollet e brendshme, menaxhimin e rrezikut dhe thirrjen e mbledhjeve të aksionarëve. Ai mund t'i delegojë kompetenca për lëshimin e aksioneve, shpërndarjen e dividendëve dhe miratimin e instrumenteve financiare.

Drejtori Menaxhues emërohet nga Bordi Drejtues. Ai menaxhon veprimtarinë e përditshme dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet e jashtme. Në rast se emërohen më shumë se një Drejtor Menaxhues, përfaqësimi i përbashkët zbaton vetëm nëse regjistrohet në ARBK.

Kuvendi i Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Ajo miraton ndryshimet e Statutit, pasqyrat financiare, emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të Bordit, si dhe vendime të rëndësishme përfshirë shpërbërjen ose falimentimin e shoqërisë. Mbledhjet vjetore janë të detyrueshme, ndërsa mbledhje të jashtëzakonshme mund të thirren nga Bordi Drejtues ose nga aksionarët që përfaqësojnë të paktën 10% të votave. Të drejtat e votës dhe procedurat përcaktohen nga Statut.

1.3. SUBJEKTET E TJERA PA PERSONALITET JURIDIK TË VEÇANTË

Megjithëse nuk kanë personalitet juridik të veçantë, SH.A.-të janë të obliguara të regjistrohen pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe mund të lidhin kontrata, të zotërojnë pasuri, si dhe të paraqiten si pale paditëse ose të paditur në emër të tyre.

1.3.1. Biznesi Individual

Një person mund të regjistroj vetëm një biznes individual. Pronari i biznesit individual ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe obligimet e biznesit.

1.3.2. Ortakëria e Përgjithshme

Ortakëria e Përgjithshme përbëhet nga dy ose më shumë ortakë, të cilët kontribuojnë me kapital, pasuri ose shërbime. Ortakët përgjigjen në mënyrë solidare dhe të pakufizuar për të gjitha obligimet e shoqërisë, përfshirë edhe ato të krijuara para pranimi të tyre në shoqëri.

Të drejtat e menaxhimit të OP-së janë të barabarta, përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshjen e OP-së. Për vendimet kyçe, si ndryshimi i marrëveshjes, shpërbërja e shoqërisë, përcaktimi i ortakëve të ri ose shitja e pasurive kryesore, kërkohet pëlqimi unanim.

1.3.3. Ortakëria e Kufizuar

Ortakëria e Kufizuar (OK) duhet të ketë të paktën një ortak të përgjithshëm, i cili mban përgjegjësi të pakufizuar dhe të paktën një ortak të kufizuar i cili mban përgjegjësi të kufizuar, përveç rasteve kur ndërhyr në menaxhimin e OK-së.

Ortakët e kufizuar nuk mund të veprojnë në emër të OK-së, përveç nëse veprimet e tyre miratohen nga ortaku i përgjithshëm. Pjesëmarrja e tyre në menaxhim i bën ata ortak përgjegjës si të ishin ortakë të përgjithshëm.

1.4. FORMAT E VEÇANTA TË ORGANIZIMIT PËR SHOQËRITË E HUAJA TREGTARE

1.4.1. Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare

Një shoqëri e huaj tregtare mund të ushtrojë aktivitetin e saj biznesor në Republikën e Kosovës përmes regjistrimit të një dege në Kosovë. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim përfshin certifikatën e regjistrimit të shoqërisë amë, vendimin për emërimin e përfaqësuesve lokal, dokumentet e identifikimit, si dhe pëlqimin e agjentit të regjistruar.

Degët janë të obliguara të mbajnë evidencë financiare që lidhet me veprimtarinë e tyre lokale në adresën e regjistruar në Republikën e Kosovës.

1.4.2. Zyra e Përfaqësuesit të Shoqërisë së Huaj Tregtare

Një shoqëri e huaj mund të ushtrojë veprimtari në Kosovë përmes regjistrimit të një Zyre Përfaqësuese pranë ARBK-së, e cila themelohet përmes të njëjtës procedurë regjistrimi si dega e shoqërisë së huaj tregtare.

Zyra përfaqësuese nuk ka personalitet juridik dhe shërben vetëm për qëllime të hulumtimit të tregut, marketingut dhe promovimit.



PUNËSIMI DHE LIGJI I PUNËS



2. PUNËSIMI DHE LIGJI I PUNËS

Në një kohë ku marrëdhëniet e punës evoluojnë vazhdimisht, ligji i punës luan një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punëtorëve dhe punëdhënësve. Republika e Kosovës si një vend me zhvillim dinamik, nuk përbën përjashtim nga nevoja globale për një kuadër ligjor të fortë që rregullon marrëdhëniet komplekse ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve të tyre.

Si bazë ligjore e punësimit në Republikës së Kosovës është Ligji Nr. 03/L-212 i punës, i cili zbatohet për të gjitha individët në sektorin privat, përfshirë dhe shtetasit e huaj që punojnë te një punëdhënës në territorin e Republikës së Kosovës, në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se misionet ndërkombëtare, si dhe misionet diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja, kanë rregullime të veçanta për marrëdhëniet e punës.

Kosova aktualisht është në proces të draftimit të ligjit të ri të punës në të cilin pritet të rregullohet edhe fusha e punës në distancë.

Përveç ligjit kryesor, ekzistojnë edhe disa akte tjera ligjore dhe nënligjore që plotësojnë peizazhin e legjislacionit të punës në Kosovë, duke përfshirë ligje për fondet pensionale, sigurinë dhe shëndetin në punë, inspektoratin e punës dhe të tjera.

Ligji i punës ofron një strukturë të gjithanshme që adreson dimensionet e shumta të marrëdhënieve të punës. Ky udhëzues do të shqyrtojë dispozitat dhe rregullimet kryesore të ligjeve të përmendura, duke hedhur dritë mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe punëdhënësve. Ai gjithashtu do të analizojë mekanizmat që sigurojnë një mjedis pune të drejtë dhe të barabartë në këtë vend dinamik.



2.1. KUSHTET DHE KRITERET PËR THEMELIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KOSOVË

Mosha

Marrëdhënia e punës mund të themelohet në mes të punëdhënësit dhe çdo personi i cili ka mbushur moshën 18 vjeç. Marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat në mes të moshës 15 deri në 18 vjeç, të cilët mund të angazhohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe në qoftë se ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor.

Obligimi i regjistrimit të punëtorit

Secili punëdhënës është i obliguar që të regjistrojë punëtorin e tij dhe ta raportojë atë para Administratës Tatimore të Kosovës dhe para Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

2.2. KONTRATA E PUNËS

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe të punësuarve rregullohen përmes kontratës së punës. Kontrata e punës duhet të lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar.

Një kontratë e punës duhet të përmbajë:

- Të dhënat për punëdhënësin dhe të punësuarin;
- Emërtimin, natyrën, llojin e punës, llojin e shërbimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës;
- Vendimin e punës dhe njoftimin që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme;
- Orët dhe orarin e punës;
- Datën e fillimit të punës;
- Kohëzgjatjen e kontratës së punës;
- Lartësinë e pagesë bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër;
- Kohëzgjatjen e pushimeve;
- Përfundimin e marrëdhënies së punës;
- Të dhëna tjera të cilat punëdhënësi dhe i punësuar i vlerësojnë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënies së punës.

Format e kontratave të punës

Ligji i punës i njeh disa lloje të ndryshme të kontratave të punës, bazuar në kritere të ndryshme:

- **Kontrata e punës me afat të caktuar:** këto kontrata kanë një afat të paracaktuar, por nuk mund të lidhen për një periudhë që tejkalon dhjetë (10) vite.
- **Kontrata e punës me afat të pacaktuar:** Një kontratë pune që nuk përmban ndonjë afat të përcaktuar konsiderohet si një kontratë punë me afat të pacaktuar. Edhe në rastin kur një kontratë me kohë të caktuar vazhdohet për më shumë se dhjetë (10) vite ajo konsiderohet kontratë punë me afat të pacaktuar.
- **Kontrata për punë dhe detyra specifike:** Këto kontrata janë të kufizuara deri në njëqind e njëzet (120) dite brenda një viti. Të punësuarit i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit, përveç kur ligji përcakton ndryshe. Për shembull, të punësuarit me kontrata për detyra specifike nuk kanë të drejtën për pushim vjetor.

Puna Provuese dhe Puna Praktike

Edhe pse nuk konsiderohen kontrata të veçanta pune, punëdhënësit mund të angazhojnë individë për punë provuese dhe punë praktike përmes marrëveshjeve të shkruara që përfshijnë dispozita specifike.

Puna Provuese

Puna provuese e cila nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë (6) muaj, është pjesë e kontratës së punës dhe mund të përfundojë me një njoftim paraprak prej shtatë (7) ditësh.



Puna Praktike

Praktikantët mund të angazhohen pa pagesë. Megjithatë, punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Një praktikant, sipas kontratës me punëdhënësin, ka të njëjtat të drejta dhe detyra si të punësuarit të rregullt. Praktikantët e angazhuar pa kompensim duhet të raportohen pranë institucioneve përkatëse.

Kohëzgjatja e praktikës:

- *Për praktikantin me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit.*
- *Për praktikantin me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj.*

2.3. ORARI I PUNËS DHE PUSHIMET

Orari i punës: I punësuarit me orar të plotë të punës pritet të punojë për 40 orë në javë, me një pushim ditor prej 30 minutave i cili është pjesë e orarit të punës. Të punësuarit, nën moshën 18 vjeç nuk mund të punojnë më gjatë se 30 orë në javë.

Puna më e gjatë se orari i punës: Kur volumi i punës rritet ose në raste tjera të nevojshme, punëdhënësi mund të kërkojë nga i punësuarit të punojë dhe tetë (8) orë shtesë, të cilat konsiderohen si orë të zgjatura pune ose punë shtesë. Orët shtesë lejohen vetëm për kohën që janë të nevojshme.

Të punësuarit nën moshën 18 vjeç, të punësuarit me orar të shkurtuar, gratë shtatzëna, prindërit e fëmijëve nën moshën 3 vjeçare, dhe të punësuarit me aftësi të kufizuara, nuk mund të bëjnë punë më të gjatë se orari i punës të obligueshme.

Ndërrimi i natës: Puna e kryer nga ora 22:00 deri në ora 06:00 konsiderohet si punë e natës dhe të punësuarit kanë të drejtë në kompensimin e një pagese shtesë prej 30% për çdo orë pune në ndërrim të natës.

Pushimi ditor: Të punësuarit kanë të drejtë në pushim ditor të pandërprerë prej 12 orëve në mes të dy ditëve të njëpasnjëshme të punës.

Pushimi javor: Të punësuarit kanë të drejtë në pushim javor në kohëzgjatje prej së paku 24 orëve pa ndërprerje. Të punësuarit i takon paga shtesë prej 50% në orë për punën gjatë fundjavës.

Pushimi vjetor: Të punësuarit me orar të plotë dhe orar të shkurtuar të punës kanë të drejtën në pushim vjetor për të paktën 4 javë me pagesë, me një ditë shtesë për çdo 5 vite përvojë pune. Punonjësit në pozita pune me efekte të dëmshme kanë të drejtë për të paktën 30 ditë pushim vjetor. Nënata me fëmijë deri në tre (3) vjeç, prindërit e vetëm dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për dy ditë shtesë. Ditët e papërdorura të pushimit vjetor nuk kompensohen me para, përveç në rast të përfundimit të marrëdhënies së punës.

Punonjësit që krijojnë marrëdhënie pune për herë të parë do të fitojnë të drejtën për pushim vjetor vetëm pas gjashtë (6) muajve të punës së vazhdueshme.

Pushimi i lindjes (materniteti): Gratë e punësuarat kanë të drejtë për 12 muaj pushim lindje: 6 muaj me 70% të pagës të paguar nga punëdhënësi, 3 muaj me 50% të pagës të paguar nga Qeveria e Kosovës, dhe 3 muaj shtesë pa pagesë. Pas pushimit të lindjes, në rastet kur fëmija kërkon kujdes të veçantë për shkak të gjendjes shëndetësore së dobët ose aftësive të përhershme të kufizuara, njëri nga prindërit ka të drejtë të punojë me kohë të pjesshme deri sa fëmija të mbushë 2 vjeç.

Pushimi i lindjes (paterniteti): Baballarët kanë të drejtë të marrin pushim paterniteti në rast se nëna vdes ose braktis fëmijën para përfundimit të pushimit të lindjes. Babai ka të drejtë për dy (2) ditë pushim të paguar në lindjen e fëmijës dhe dy (2) javë pushim pa pagesë pas lindjes ose në çdo kohë para se fëmija të mbushë tre (3) vjeç. Gjatë gjashtë (6) muajve të fundit të pushimit të lindjes, pushimi mund t'i kalojë babait me marrëveshje me nënën.

Ndalimi i përfundimit të kontratës: Gjatë shtatzënisë, pushimit të lindjes dhe mungesës për shkak të kujdesit të veçantë për fëmijën, punëdhënësi është i ndaluar të përfundojë kontratën e punës ose të transferojë punonjësin në një pozitë tjetër.



2.4. PAGA DHE PËRFITIMET TJERA TË TË PUNËSUARVE

Paga: Në Kosovë, të punësuarit paguhen në Euro ashtu siç përcaktohet në kontratën e punës. Të punësuarit pagën dhe përfitimet tjera duhet t'i pranojnë së paku një herë në muaj.

Pagesa shtesë: Të punësuarit kanë të drejtë për pagesë shtesë për punën jashtë orarit të rregullt, e cila llogaritet si përqindje e pagës bazë, si më poshtë:

- njëzet për qind (20%) kujdestari;
- tridhjetë për qind (30%) për orët e punës gjatë ndërrimit të natës, për orët e punuara ndërmjet orës 22:00 dhe 06:00;
- tridhjetë për qind (30%) për orë të zgjatura të punës, si pagesë shtesë për punën jashtë orarit në raste të rritjes së vëllimit të punës ose raste të tjera të nevojshme;
- pesëdhjetë për qind (50%) për orë për punë gjatë festave zyrtare, si kompensim i shtuar për orët e punuara gjatë festave shtetërore; dhe
- pesëdhjetë për qind (50%) për orë për punë gjatë fundjavës, si pagesë e rritur për orët e punuara gjatë fundjavës.

2.5. MBROJTJA DHE SIGURIA NË VENDIN E PUNËS

Garantimi i sigorisë dhe mirëqenies së punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të punës përbën një detyrim themelor të punëdhënësve në Kosovë. Ky angazhim për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëtorëve nuk është vetëm një detyrim moral, por edhe një kërkesë ligjore, e përcaktuar si në Ligjin e Punës ashtu edhe në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Përcaktimet ligjore

Ligji i punës: Ligji i Punës shërben si bazë kryesore për përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësi të punëdhënësve dhe punonjësve në Kosovë. Ai vendos kornizën e marrëdhënieve të punës, duke përfshirë pritshmërinë që punëdhënësit duhet të krijojnë dhe të mirëmbajnë një mjedis pune të sigurt dhe të mbrojtur.

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë: Ky ligj specifik elaboron më tej aspektet e sigurisë dhe mbrojtjes gjatë punës në Kosovë. Ai ofron udhëzime dhe rregulla gjithëpërfshirëse që punëdhënësit duhet t'i zbatojnë për të parandaluar aksidentet në vendin e punës, për të reduktuar rreziqet shëndetësore dhe për të promovuar mirëqenien e përgjithshme të punonjësve.

Detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësit në Kosovë kanë disa detyrime kyçe në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen gjatë punës, përfshirë:

Sigurimin e kushteve të sigurt të punës: Punëdhënësit duhet të sigurojnë që vendet e punës të mos paraqesin rreziqe që mund të rrezikojnë jetën ose shëndetin e punonjësve. Kjo përfshin trajtimin e rreziqeve fizike, kimike, biologjike dhe ergonomike.

Trajnimin për siguri: Punëdhënësit duhet t'u ofrojnë punonjësve trajnime dhe informacione të përshtatshme për t'u mundësuar atyre të punojnë në mënyrë të sigurt dhe të përdorin siç duhet pajisjet mbrojtëse.

Raportimin dhe hetimin: Punëdhënësit janë të detyruar të raportojnë dhe të hetojnë pa vonesë çdo aksident, lëndim ose sëmundje që ndodh në vendin e punës, me qëllim parandalimin e përsëritjes së tyre.

Masat mbrojtëse: Punëdhënësit duhet të sigurojnë masat mbrojtëse, pajisjet dhe veshjet e nevojshme për të reduktuar ose eliminuar rreziqet në vendin e punës.



2.6. MASAT DISIPLINORE DHE SHKËPUTJA E KONTRATËS SË PUNËS

2.6.1. *Masat Disiplinore*

Punëdhënësi mund të shqiptojë masa disiplinore ndaj të punësuarit në rast të shkeljes së detyrave të punës. Masat disiplinore përfshijnë: vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, ulje në pozitë, suspendim të përkohshëm dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Vërejtja me gojë, vërejtja me shkrim dhe ulja në pozitë shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës, në përputhje me aktet e brendshme të punëdhënësit dhe kontratën e punës, ndërsa suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës, në përputhje me aktet e brendshme të punëdhënësit dhe kontratën e punës.

Vendimi i punëdhënësit për shqiptimin e masave disiplinore duhet të nxirret në formë të shkruar dhe të përmbajë arsyetim të qartë si dhe udhëzim për mjetet juridike në dispozicion lidhur me masën e shqiptuar.

2.6.2. *Ndërprerja e Marrëdhënies së Punës*

Ndërprerja e marrëdhënies së punës përbën një aspekt thelbësor të së drejtës së punës dhe ka rëndësi të veçantë si për punëdhënësin ashtu edhe për të punësuarin.

Ligji njej forma të ndryshme të përfundimit të marrëdhënies së punës, si në vijim:

- ***Ndërprerja e kontratës së punës sipas ligjit:*** Ky përfundim ndodh për arsye të ndryshme, si vdekja e të punësuarit, vdekja e punëdhënësit (kur puna ose shërbimet janë të natyrës personale dhe nuk mund të vazhdojnë nga pasardhësit), skadimi i afatit të kontratës, arritja e moshës së pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjetësh, humbja e aftësisë për punë, dënimi i të punësuarit me burgim efektiv mbi gjashtë (6) muaj, vendimi i gjykatës kompetente që çon në përfundimin e marrëdhënies së punës, falimentimi ose likuidimi i ndërmarrjes.

- ***Ndërprerja e kontratës së punës me marrëveshje:*** Punëdhënësi dhe i punësuar mund të bien dakord për përfundimin e kontratës së punës në formë të shkruar. Në këto raste, punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë të punësuarit pagën deri në datën e përfundimit të marrëdhënies së punës.

- ***Ndërprerja e kontratës së punës nga i punësuar:*** I punësuar mund ta përfundojë në mënyrë të njëanshme kontratën e punës. Për kontratat me afat të caktuar kërkohet njoftim paraprak prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike, ndërsa për kontratat me afat të pacaktuar kërkohet njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike.

- ***Ndërprerja e kontratës së punës nga punëdhënësi:*** Punëdhënësi mund ta përfundojë kontratën e punës për arsye ekonomike, teknike ose organizative, apo në rast se i punësuar nuk është i aftë të kryejë punën. Në këto raste, kontrata mund të përfundohet vetëm nëse nuk është e mundur transferimi i të punësuarit në një pozitë tjetër ose ofrimi i trajnimit të nevojshëm.

Punëdhënësi mund gjithashtu ta përfundojë kontratën e punës për shkelje të rënda disiplinore ose për kryerje të pakënaqshme të detyrave të punës, me kusht që të respektohen rregulloret e brendshme. Në rast të përfundimit të kontratës për shkak të performancës së pakënaqshme, punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin me shkrim për mangësitë në punë, duke përcaktuar një afat kohor për përmirësim dhe duke theksuar se mos-përmirësimi i performancës do të rezultojë me largim nga puna pa ndonjë njoftim tjetër me shkrim. Punëdhënësi është i detyruar të ndjekë procedurë disiplinore përpara përfundimit të kontratës së punës.

Punëdhënësi është i detyruar të mbajë një takim me të punësuarin për të shpjeguar arsyet e përfundimit të kontratës së punës ose për qëllim të dhënies së vërejtjes. I punësuar ka të drejtë të shoqërohet nga një përfaqësues sipas zgjedhjes së tij ose të saj.



2.6.3. Njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës

Vendimi i punëdhënësit për ndërprerjen e kontratës së punës duhet të nxirret në formë të shkruar dhe të përmbajë arsyetimin përkatës, në të cilin shpjegohen bazat ligjore dhe faktike të këtij vendimi.

Afati i njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës ndryshon në varësi të llojit të kontratës së punës, respektivisht nëse kontrata është me afat të caktuar ose me afat të pacaktuar, si dhe në varësi të kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës. Për kontratat e punës me afat të pacaktuar, afati i njoftimit përcaktohet sipas viteve të shërbimit të punonjësit, si më poshtë:

- për punonjësit me gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vjet përvojë pune: tridhjetë (30) ditë kalendarike;
- për punonjësit me dy (2) deri në dhjetë (10) vjet përvojë pune: dyzet e pesë (45) ditë kalendarike;
- për punonjësit me më shumë se dhjetë (10) vjet përvojë pune: gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

Kontratat e punës me afat të caktuar kërkojnë një afat njoftimi prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike për përfundim. Në rast se punëdhënësi nuk ka për qëllim vazhdimin e kontratës së punës me afat të caktuar, ai është i detyruar ta njoftojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Mosrespektimi i këtij detyrimi i jep të drejtë të punësuarit për vazhdimin e marrëdhënies së punës me pagesë të plotë për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike.

Pavarësisht nga forma e përfundimit të marrëdhënies së punës, punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë të punësuarit pagën dhe çdo përfitim tjetër deri në ditën e përfundimit të marrëdhënies së punës.

2.7. MBROJTJA E VEÇANTË E KATEGORIVE TË CAKTUARA TË TË PUNËSUARVE

Mbrojtja e të rinjve

Legjislacioni i punës dhe të drejtës së punës në Kosovë parasheh masa të veçanta mbrojtëse për punonjësit nën moshën 18 vjeç. Këto rregulla kanë për qëllim sigurimin e sigurisë dhe mirëqenies së tyre.

Të punësuarit e rinj nuk mund të kryejnë punë të rrezikshme që mund t'u shkaktojnë dëm. Punëdhënësit janë të detyruar të vlerësojnë rreziqet dhe të sigurojnë një mjedis pune të sigurt për të rinjtë.

Mbrojtja e grave

Ekzistojnë rregulla për sigurimin e shëndetit dhe sigurisë së grave shtatzëna dhe të gjdhënësve në vendin e punës. Këto rregulla i ndalojnë ato të kryejnë detyra që mund të rrezikojnë mirëqenien e tyre ose shëndetin e fëmijëve. Kjo përfshin punë fizike të rënda dhe pozicione me rreziqe të mundshme shëndetësore.

Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara

Të punësuarit me aftësi të kufizuara përfitojnë mbrojtje dhe mbështetje të veçantë nga rregulloret e punës dhe të drejtës së punës në Kosovë.

Të punësuarit me aftësi të kufizuara mund të vazhdojnë të punojnë në pozicionet e tyre aktuale ose në detyra të ngjashme, nëse kapaciteti i mbetur i punës e lejon këtë pa nevojën për rehabilitim profesional. Në rast se kapaciteti i punës i punonjësit përmirësohet pas rehabilitimit profesional, ai/ajo mund të marrë përsipër detyra të veçanta. Në këto raste, punëdhënësi është i detyruar t'i ofrojë të punësuarit detyra të përshtatshme pas rikuperimit nga rehabilitimi.

2.8. NDALIMI I DISKRIMINIMIT

Mbrojtja kundër diskriminimit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me nenin 7 të saj garanton të drejtën e mosdiskriminimit. Ky parim nënvizon barazinë gjinore si një vlerë themelore.

Për më tepër, Ligji për Punën forcon masat kundër diskriminimit, duke përfshirë mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, pagesën e barabartë për punë të barabartë, si dhe ofrimin e mundësive të barabarta për të gjitha gjinitë në proceset e punësimit.

Në rastet e supozuara të diskriminimit, punonjësit mund të kërkojnë zgjidhje përmes punëdhënësit, organeve administrative ose gjykatës. Mjetet e mundshme juridike mund të përfshijnë rikthimin në vendin e punës ose kompensimin financiar.

Legjislacioni i Kosovës përfshin dispozita të rrepta kundër diskriminimit.

Dy ligje kyçe që trajtojnë këtë çështje janë:

- *Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore;*
- *Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi*

2.9. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË TË PUNËSUARVE: PROCEDURAT DHE MJETET JURIDIKE

Mbrojtja e të drejtave të punësuarve nga punëdhënësi

- *I punësuarit që vlerëson se të drejtat e tij të punës janë shkelur, mund të paraqesë kërkesën e tij të punëdhënësi ose organet përkatëse të punëdhënësit.*
- *Punëdhënësi është i detyruar të marrë një vendim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dorëzimi i kërkesës.*
- *Vendimi duhet t'i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda tetë (8) ditëve nga marrja e vendimit.*

Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të punësuarve

Nëse i punësuarit nuk është i kënaqur me vendimin e punëdhënësit ose nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar, ai mund të iniciojë një kontest pune në gjykatën kompetente.

- *Nëse gjykata vlerëson se vendimi është i paligjshëm në përputhje me Ligjin për Punën, ajo mund t'i urdhërojë punëdhënësit të paguajë kompensim për të punësuarin, përveç çdo përfitimi dhe shume tjetër të të drejtave të të punësuarit.*
- *Në rastet kur përfundimi i marrëdhënies së punës konsiderohet i paligjshëm për shkak të diskriminimit, gjykata mund të rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe të caktojë kompensim për pagat dhe përfitimet e humbura gjatë periudhës së pushimit të paligjshëm.*

Mbrojtja e të drejtave të punësuarve nga Inspektorati i Punës

Inspektorati i Punës, veprimtaria e të cilit rregullohet me Ligjin Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, luan një rol kyç në sigurimin e zbatimit të ligjit të punës dhe vendos gjoba në rast të shkeljes së të drejtave të të punësuarve. Të punësuarit mund të paraqesin ankesë pranë Inspektoratit të Punës në çdo kohë për çështje që bien nën kompetencat e këtij organi, dhe Inspektorati është i detyruar të nxjerrë një vendim lidhur me ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve.

Ndërmjetësimi

Mosmarrëveshjet mund të zgjidhen gjithashtu përmes ndërmjetësimit, sipas Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim. Ndërmjetësimi mund të ofrojë një mënyrë për zgjidhjen e konflikteve pa nevojën e procedurave gjyqësore.

2.10. PUNËSIMI I TË HUAJVE

Sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, të huajve iu jepet mundësia e rëndësishme që të punojnë brenda territorit të Kosovës përmes pajisjes me lejeqëndrim të përkohshëm. Kjo leje mund të kërkohej pranë misionëve diplomatike ose konsullore të Republikës së Kosovës për shtetasit e huaj të cilët kanë nevojë për vizë për hyrje në Republikën e Kosovës.

Në rastet kur i huaji nuk ka nevojë për vizë, kërkesa për lejeqëndrim të përkohshëm mund të paraqitet edhe drejtpërdrejt pranë Divizionit për të Huaj në Republikën e Kosovës. Kjo kërkesë duhet të parashtrohet para skadimit të qëndrimit afatshkurtër, dhe aplikuesi ka të drejtë të qëndrojë në Republikën e Kosovës deri në marrjen e vendimit lidhur me këtë kërkesë.

Një përparësi e rëndësishme që duhet theksuar është se shtetasit e më shumë se njëqind (100) vendeve mund të hyjnë në Republikën e Kosovës pa pasur nevojë për vizë. Ky regjim i lehtësuar i hyrjes thjeshton ndjeshëm procedurat e udhëtimit dhe rrit qasjen për të huajt, duke e bërë Kosovën një destinacion edhe më tërheqës për punë dhe angazhim profesional.

2.10.1.Kush mund të aplikojë për lejeqëndrim të përkohshëm?

Kërkesa për pajisje me lejeqëndrim të përkohshëm mund të paraqitet personalisht nga personi i cili dëshiron të pajiset me këtë leje. Po ashtu, kërkesa mund të paraqitet edhe nga punëdhënësi i tij.

Kur aplikuesi për lejeqëndrim të përkohshëm ka fëmijë, kërkesa për lejeqëndrim për ta paraqitet nga prindi përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.10.2.Aspektet Procedurale

Procedura për pajisje me lejeqëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës është e thjeshtë, jo burokratike dhe nuk kërkon kohë të gjatë nga aplikuesi. Po ashtu, edhe trajtimi i kërkesës nga autoritetet kompetente është efikas dhe brenda afateve të shkurtra ligjore.

Lidhur me kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion merr vendim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Lejeqëndrimi i përkohshëm lëshohet për një periudhë deri në një (1) vit, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Kjo leje mund të vazhdohet me kërkesë të të huajit, e cila duhet të paraqitet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para skadimit të vlefshmërisë së lejeqëndrimit të përkohshëm. Shtetasit e huaj që kanë paraqitur kërkesë për vazhdimin e kësaj leje kanë të drejtë të qëndrojnë në Republikën e Kosovës deri në marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me kërkesën e tyre.

Dokumenti i udhëtimit i aplikuesit duhet të ketë një afat vlefshmërie të paktën tre (3) muaj më të gjatë se periudha për të cilën lëshohet lejeqëndrimi i përkohshëm.

Anëtarët e ngushtë të familjes së të huajit i cili qëndron në Republikën e Kosovës mbi bazën e një lejeqëndrimi të përkohshëm për punë me afat një (1) vjeçar mund të pajisen me lejeqëndrim të përkohshëm për qëllime të ribashkimit familjar vetëm në rast se i huaji ka të paktën dy (2) vite qëndrimi të përkohshëm dhe kërkon ribashkim familjar në Republikën e Kosovës.

Ky kufizim nuk zbatohet për transferimet korporative, pasi anëtarët e familjes së personit të transferuar kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për lejeqëndrim të përkohshëm njëkohësisht me sponsorin.

2.10.3.Kriteret për Dhënien e Lejeqëndrimit të Përkohshëm?

Një shtetas i huaj pajiset me lejeqëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës në qoftë se:

- Dëshmon qëllimin e lejeqëndrimit të përkohshëm në Republikën e Kosovës;
- Posedon dokument udhëtimi të vlefshëm, me afat vlefshmërie të paktën tre (3) muaj më të gjatë se periudha për të cilën kërkohet lejeqëndrimi i përkohshëm;
- Nuk ka ndalim hyrjeje apo qëndrimi në Republikën e Kosovës dhe nuk paraqet rrezik për imigrim apo qëndrim të paligjshëm;
- Paraqet dëshmi për mungesë të dënimeve penale ose hetimeve në vazhdim, të lëshuar nga shteti i shtetësisë ose nga shteti i qëndrimit të fundit, të përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Dëshmon mjete të mjaftueshme për jetesë, përmes ekstrakteve bankare, kontratës së punës ose dëshmive të tjera që vërtetojnë se i huaji ka burime financiare të mjaftueshme për qëndrim;
- Posedon sigurim shëndetësor të vlefshëm;
- Ka të lidhur kontratë pune, në përputhje me legjislacionin e punës në Republikën e Kosovës, përveç rasteve kur i huaji është pronar i biznesit;
- Posedon certifikatë të regjistrimit të biznesit, kur qëndrimi bazohet në ushtrimin e veprimtarisë afariste;
- Paraqet dëshmi mbi arsimin, kualifikimet dhe aftësitë profesionale, përveç rasteve kur i huaji është pronar i biznesit;

2.11. MBROJTJA E SINJALIZUESVE DHE MEKANIZAMET E RAPORTIMIT

Sinjalizimi është një nga mjetet më efektive për të zbuluar shkelje dhe veprime të paligjshme. Ai luan një rol kyç në zbulimin e shkeljeve serioze në sektorin publik dhe privat, përfshirë keqpërdorimet financiare në shkallë të gjerë, shkeljet mjedisore, keqpërdorimin e fondeve publike përmes prokurimeve publike dhe veprime të tjera që dëmtojnë interesin publik. Për këtë arsye, sinjalizimi kontribuon në mënyrë të ndjeshme në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Në Kosovë, mbrojtja e sinjalizuesve garantohet nga Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i miratuar në vitin 2018 dhe i harmonizuar me praktikat më të mira evropiane. Ky ligj vendos mekanizma ligjorë për raportimin e veprimeve të paligjshme, joetike ose të dëmshme dhe siguron mbrojtje të fortë kundër ndëshkimeve për individët që raportojnë këto veprime me ndërgjegje të mirë.

Sinjalizuesit mund të jenë punonjës, ish-punonjës, kontraktorë, konsulentë ose çdo individ tjetër që ka qasje në informacion relevant lidhur me shkelje të ligjit ose etikës gjatë angazhimit të tij/pas tij.

Raportet e shkeljeve mund të dorëzohen përmes kanaleve të mëposhtme:

- *Raportim i brendshëm, drejtuar punëdhënësit ose organizatës përkatëse;*
- *Raportim i jashtëm, dërguar autoriteteve publike të caktuara;*
- *Publikim publik, në përputhje me kushtet ligjore, kur raportimi i brendshëm ose i jashtëm ka dështuar, nuk është i mundur, ose paraqet rrezik për sinjalizuesin.*

Punëdhënësit kanë detyrë ligjore të krijojnë mekanizma konfidencialë të raportimit të brendshëm dhe të caktojnë zyrtarë ose organe përgjegjëse për marrjen, trajtimin dhe ndjekjen e raporteve të sinjalizuesve.

2.11.1.Mbrojtja Ligjore

Ligji ndalon çdo formë të hakmarrjes ndaj sinjalizuesve. Veprimet e ndaluara përfshijnë, por nuk kufizohen në: shkarkim, ulje në detyrë, diskriminim, intimidim, kërcënime ose ngacmime.

Sinjalizuesit që janë subjekt i hakmarrjes kanë të drejtë të kërkojnë mjetet ligjore të mbrojtjes, duke përfshirë:

- *Riatdhesim në pozitën e mëparshme;*
- *Kompensim për dëmet materiale dhe jomateriale;*
- *Garantimin e anonimitetit dhe konfidencialitetit.*

2.11.2.Detyrimet e Bizneseve dhe Institucioneve

Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private me më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës janë të detyruara:

- *Të krijojnë procedura të brendshme për sinjalizimin;*
- *Të sigurojnë mbrojtjen, konfidencialitetin dhe anonimitetin e sinjalizuesve;*
- *Të trajtojnë stafin mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.*

2.11.3.Përcaktime ligjore shtesë dhe me rëndësi

Përveç mbrojtjeve dhe detyrimeve kryesore, Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve përfshin edhe dispozitat e tjera të rëndësishme:

- ***Afatet kohore për raportim:*** Ligji nuk vendos afate të rrepta për dorëzimin e raporteve. Megjithatë, sinjalizuesit inkurajohen të raportojnë menjëherë pas njohjes së shkeljeve për të mundësuar hetime efektive dhe mbrojtje.
- ***Barrë prove në rastet e hakmarrjes:*** Në procedurat ligjore për hakmarrje, barrë prove bartet nga punëdhënësi ose pala e akuzuar; e cila duhet të tregojë që çdo veprim i dëmshëm nuk ka lidhje me aktivitetin e sinjalizimit.

- **Roli i Agjencisë Kundër Korrupsionit:** Agjencia Kundër Korrupsionit vepron si autoritet qendror për marrjen dhe përpunimin e raporteve të jashtme të sinjalizuesve dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të mbrojtjeve ligjore.
- **Monitorimi dhe zbatimi:** Institucionet publike dhe subjektet e mëdha private duhet të raportojnë rregullisht te autoritetet kompetente, përfshirë Agjencinë Kundër Korrupsionit, mbi implementimin e mekanizmave të brendshëm të sinjalizimit dhe numrin e raporteve të marra.

TATIMET NË KOSOVË



3. TATIMET NË KOSOVË

Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ndërtimin e një sistemi tatimor tërheqës dhe konkurrues. Mjedisi tatimor karakterizohet nga norma të ulëta tatimore, duke e bërë Kosovën një destinacion të favorshëm për investitorët dhe bizneset që synojnë të operojnë në rajon.

Një nga aspektet më tërheqëse të këtij sistemi është norma e ulët e tatimit në fitim të korporatave prej 10 për qind, që është dukshëm më e ulët në krahasim me shumë shtete evropiane. Kjo normë konkurruese është një nga faktorët kyç që nxit investimet vendore dhe të huaja.

Administrata Tatimore e Kosovës ka zhvilluar një sistem deklarimi elektronik përmes platformës EDI. Deklarimet kryhen plotësisht online dhe nuk kërkohet prezencë fizike, duke lejuar që të gjitha procedurat tatimore të realizohen në distancë, në mënyrë të thjeshtë dhe efikase.

Një përparësi tjetër unike e Kosovës është përjashtimi nga tatimi i të ardhurave nga dividendët, çka përbën një nxitje të rëndësishme për investitorët dhe një faktor shtesë në krijimin e një klime të favorshme biznesi.

Kosova ka një sistem të TVSH-së të thjeshtuar, me normë standarde prej 18 për qind. Megjithatë, për eksportet e mallrave dhe shërbimeve zbatohet norma 0 për qind, duke rritur konkurrueshmërinë e Kosovës në tregtinë ndërkombëtare. Për mallrat dhe shërbimet esenciale zbatohet një normë e reduktuar prej 8 për qind.

Kosova ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë me shumë vende, duke nxitur tregtinë dhe investimet ndërkombëtare. Këto marrëveshje sigurojnë shmangien e tatimit të dyfishtë për të njëjtat të ardhura dhe ofrojnë lehtësira si kreditime tatimore ose përjashtime.

Për më tepër, Kosova ofron skema të posaçme nxitëse për sektorë të caktuar, si teknologjia e informacionit dhe turizmi, me qëllim stimulimin e rritjes ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.



1. TATIMI NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

Tatimi në të Ardhurat e Korporatës (TAK) në Kosovë rregullohet nga Ligji Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (“Ligji për TAK”).

1.1. Tatimpaguesit

Për këtë lloj tatimi, tatimpagues janë korporatat dhe ndërmarrjet afariste që kanë status personi juridik; shoqëritë tregtare që operojnë me pasuri publike apo shoqërore; OJQ-të dhe personat jorezidentë me vendqëndrim të përhershëm në Kosovë. Tatimpaguesit rezidentë tatohen për të ardhurat nga burimet brenda dhe jashtë Kosovës. Tatimpaguesit jorezidentë tatohen vetëm për të ardhurat që burojnë nga Kosova.

Deklarimi: Deklarata tatimore dhe pasqyrat financiare duhet të dorëzohen në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) më së voni deri më 31 mars të vitit pasues për periudhën tatimore paraprake.

1.2. Të Ardhurat e Tatueshme

Sipas legjislacionit të Kosovës, të ardhurat e tatueshme janë të ardhurat që i nënshtrohen tatimit dhe llogariten si diferenca ndërmjet të ardhurave bruto të realizuara dhe të pranuar, dhe shpenzimeve të lejuara. Me fjalë të tjera, paraqesin pjesën e të ardhurave që mund të tatohet pas zbritjes së shpenzimeve dhe përjashtimeve të lejuara me ligj.

Shmangia e tatimit të dyfishtë: Rezidentët e Kosovës që realizojnë të ardhura nga veprimtari afariste jashtë shtetit dhe që për to paguajnë tatim në një shtet tjetër, kanë të drejtë në kreditim tatimor për shumën e paguar jashtë vendit. Megjithatë, kjo zbritje nuk mund të kalojë detyrimin tatimor që do të llogaritej sipas normës tatimore në Kosovë. Këto dispozita tejkalohen nëse ekziston një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë. Kosova ka marrëveshje të tilla me: Shqipërinë, Austrinë, Belgjikën, Kroacinë, Finlandën, Gjermaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Irlandën, Letoninë, Lituaninë, Arabinë Saudite, Maltën, Maqedoninë e Veriut, Holandën, Slloveninë, Zvicrën, Turqinë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Gjithashtu, ka marrëveshje me Çekinë, Francën dhe Italinë, por ato ende nuk kanë hyrë në fuqi.

Në sistemin tatimor të Kosovës, shmangia e tatimit të dyfishtë rregullohet përmes këtyre rregullave:

Kushtet për rezidentë: Individët apo kompanitë duhet të përmbushin kriteret specifike për rezidentë, zakonisht përmes qëndrimit për një periudhë të caktuar në territorin e Kosovës gjatë një kohe të përcaktuar.

Dokumentacioni i kërkuar: Duhet të dorëzojnë dokumente për të dëshmuar të drejtën për zbritje tatimore, zakonisht përfshirë certifikatat nga administrata tatimore e vendit të origjinës.

Tatimi mbi dividendin: Kosova në përgjithësi nuk taton dividendët në burim, për të shmangur tatimin e dyfishtë mbi këtë të ardhur.

Shembull: Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë për shmangien e tatimit të dyfishtë parashikon:

Përcaktimi i statutit të personit rezident: Sipas numrit të ditëve të qëndrimit.

Pragu i qëndrimit: Zakonisht 183 ditë brenda vitit tatimor.

Përfshirjet për të ardhura të caktuara: Si të ardhurat nga shërbime shtetërore apo të ardhura të studentëve dhe praktikantëve.

Rregulla për zgjidhjen e konfliktit për rezidentë: Përfshijnë analizën e vendbanimit të përhershëm, qendrës së interesave jetësore, vendit të zakonshëm të qëndrimit, dhe në fund, kombësisë.

Statuti i personit rezidentë për bizneseve: Përcaktohet në bazë të selisë së menaxhimit apo vendndodhjes së qendrës së aktivitetit.

Kufizimet për punonjësit publikë: Për ata që punojnë përkohësisht jashtë vendit.

Si përmbledhje, marrëveshja e Kosovës me Gjermaninë për shmangien e taksimit të dyfishtë përcakton kritere dhe pragje të qarta për rezidencën tatimore. Ajo gjithashtu trajton përjashtimet për të ardhurat dhe përfshin rregulla ndarëse për të zgjidhur mosmarrëveshjet mbi rezidencën tatimore.

1.3. Përjashtimet nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatës

Janë të përjashtuar nga TAK:

- *OJQ-të, nëse të ardhurat e tyre përdoren ekskluzivisht për qëllime të interesit publik;*
- *Banka Qendrore e Kosovës dhe institucionet financiare ndërkombëtare;*
- *Instrumentet financiare të emetuara apo të garantuara nga autoritetet publike të Kosovës;*
- *Bashkësitë fetare;*
- *Kontraktorët dhe nënkontraktorët e huaj që furnizojnë qeveri të huaja apo organizata ndërkombëtare;*
- *Të ardhurat nga grante, subvencione dhe donacione;*
- *Dividentët e paguar apo të pranuar nga persona rezidentë dhe iorezidentë.*



1.4. Zbritjet

Nga të ardhurat bruto mund të zbriten shpenzimet që lidhen me veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit, si:

- *sigurimi shëndetësor për punonjësit dhe familjarët e tyre;*
- *shpenzimet për arsimim dhe trajnime;*
- *donacione dhe sponzorime për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mjedisore dhe sportive (deri në 10% të të ardhurave të tatueshme, plus 10% shtesë nëse parashikohet në ligje të veçanta);*
- *shpenzime për përfaqësim, reklama dhe promovime (deri në 1% të të ardhurave bruto vjetore);*
- *humbjet nga borxhet e këqija (nën kushte të caktuara);*
- *amortizimi i ndërtesave dhe strukturave të ndërtuara (5%), automjeteve, mobilieve dhe pajisjeve të zyrës, instrumenteve dhe bagëti (20%), makinerisë, pajisjeve të rënda, avionëve, anijeve, trenave (10%);*
- *riparime apo përmirësime deri në 1000 euro për një pasuri (nëse tejkalojnë këtë vlerë dhe zgjasin jetëgjatësinë e pasurisë, kapitalizohen);*
- *amortizimi i pasurive jomateriale për kohëzgjatjen e dobishme të tyre ose për 20 vjet në mungesë të përcaktimit;*
- *amortizimi i shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim në fushën e burimeve natyrore;*
- *humbjet kapitale nga shitja apo alienimi i pasurive kapitale, të cilat njihen si humbje të biznesit;*
- *humbjet tatimore që ndodhin kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat – këto mund të bartën si zbritje deri në 4 periudha tatimore pasuese, përveç rasteve kur ka ndryshim organizativ ose pronësor mbi 50%;etj.*



Ligji për TAK përjashton shpenzimet në vijim nga zbritja: kostoja për blerjen apo përmirësimin e tokës; gjobat, dënimet, interesat nga autoritetet publike; tatimet mbi të ardhurat dhe TVSH-ja e zbritshme; humbjet tatimore nga transaksione mes personave të lidhur (përveçse nëse janë në përputhje me vlerën e tregut të hapur); kontributet pensionale përtej kufirit të lejuar; dhuratat, përveç atyre që kanë emrin dhe logon e biznesit; shpenzimet për argëtim dhe rekreacion.

Rezervat për humbjet e pritshme në përgjithësi nuk zbriten, përveç rasteve specifike si humbjet e pritshme nga kreditë për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe ato jobankare, deri në 80%. Institucionet e sigurimeve dhe risigurimeve mund të zbresin rezervat teknike dhe matematikore brenda kufijve të caktuar.

1.5. Çmimet e Transferimit/Transfer Pricing

Çmimi i transferimit i referohet çmimit të vendosur për transaksione ndërmjet kompanive shumëkombëshe të së njëjtit grup, për mallra, shërbime apo pasuri jomateriale. Këto quhen transaksione të kontrolluara. Rregullat e Kosovës për çmimet e transferimit janë të harmonizuara me udhëzimet e OECD-së dhe janë të rregulluara nga Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2017 për Transferimin e Çmimit.

Tatimpaguesit në Kosovë taten për transaksionet e kontrolluara me palët e lidhura. Palët konsiderohen të lidhura nëse: një person zotëron apo kontrollon 50% ose më shumë të tjetrit; një person kontrollon drejtpërdrejt ose tërthorazi tjetrin; të dy kontrollohen nga një palë e tretë; ose janë të afërm familjarë.

Metodat që përdoren për përcaktimin e çmimit të transferimit janë: metoda e çmimit të krahasueshëm, metoda e çmimit të rishitjes, metoda e kostos plus, metoda e marzhit neto dhe metoda e ndarjes së fitimit. Tatimpaguesit me transaksione të kontrolluara mbi 300,000 euro janë të obliguar:

- të përgatisin dokumentacionin e çmimit të transferimit sipas standardeve të Kodit të Sjelljes të BE-së (2006/C176/01); dhe
- ta dorëzojnë formularin vjetor të transaksioneve të kontrolluara pranë ATK-së deri më 31 mars të vitit pasues.

Për transaksione nën 300,000 euro:

- dokumentacioni duhet të përgatitet gjithashtu, por konsiderohet i mjaftueshëm edhe nëse përdoren krahasime të huaja;
- nuk ka obligim për dorëzimin e formularit vjetor.

1.6. Pagesa e Tatimit

Tatimpaguesit në Kosovë janë të obliguar të bëjnë pagesa tatimore paraprake çdo tremujore, në këto data: 15 prill, 15 korrik, 15 tetor dhe 15 janar.

Për tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore deri në 30,000 euro, që nuk kanë zgjedhur të dorëzojnë deklaratë tatimore, pagesat tremujore përcaktohen si:

- *3% e të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtari të ngjashme, me pagesë minimale 37.5 euro;*
- *9% e të ardhurave bruto nga shërbimet, profesionet, artizanati, argëtimi dhe veprimtari të ngjashme, me pagesë minimale 37.5 euro;*
- *10% e të ardhurave neto nga qiraja, pas zbritjes së shumës së mbajtur gjatë tremujorit.*

Tatimpaguesit që janë të obliguar të dorëzojnë deklaratë (me të ardhura mbi 30,000 euro) ose që e zgjedhin këtë opsion, duhet të bëjnë pagesa tremujore si më poshtë:

- *një e katërta e detyrimit tatimor për periudhën aktuale, bazuar në të ardhurat e parashikuara, pas zbritjes së shumave të mbajtura gjatë tremujorit;*
- *për periudhat e dyta dhe në vijim, të paktën një e katërta e 110% të detyrimit tatimor të vitit të kaluar, pas zbritjes së shumave të mbajtura.*



2. TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE

Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) në Kosovë rregullohet nga Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale ("Ligji për TAP").

2.1. Tatimpaguesit

Tatimpagues janë personat fizikë rezidentë dhe jorezidentë, ndërmarrjet personale afariste, ortakëritë dhe shoqëritë, të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto gjatë periudhave tatimore.

Rezidentët tatohen për të ardhurat e tyre nga burimet brenda dhe jashtë Kosovës. Jorezidentët tatohen vetëm për të ardhurat e tyre nga burimet brenda Kosovës.

2.2. Normat Tatimore të TAP

Normat tatimore për TAP janë si vijon:

- *Deri në 3000 euro: 0%;*
- *Nga 3001 deri në 5,400 euro: 8% e shumës mbi 3000 euro;*
- *Nga 3,001 deri në 5,400 euro: 81.6 euro + 8% e shumës mbi 3,000 euro;*
- *Mbi 5,400 euro: 182 euro + 10% e shumës mbi 5,400 euro.*

2.3. Të Ardhurat e Tatueshme

Të ardhurat e tatueshme përfaqësojnë dallimin ndërmjet të ardhurave bruto të realizuara dhe të pranuar dhe shpenzimeve të zbritshme.

Të ardhurat e tatueshme përfshijnë:

- *Pagat, përfshirë pagat për punë, bonuse, komisione, sigurimet shëndetësore dhe të jetës të paguara nga punëdhënësi, falje borxhesh për punonjës, kompensime për shpenzime personale dhe përfitime në natyrë. Nuk përfshihen në të ardhura bruto nga pagat: rimbursimet për udhëtime pune, kompensimi për lëndime në vendin e punës, përfitime*

në natyrë në formë ushqimi dhe transporti, si dhe rimbursimet për transport nga banesa në vendin e punës (nën kushte të caktuara);

- *Qiratë nga pasuri të paluajtshme apo pajisje dhe automjete të dhëna me qira;*
- *Përdorimi i pasurisë jomateriale;*
- *Interesi nga hua, obligacione dhe llogari bankare (përjashtohet interesi nga fondet pensionale);*
- *Fitimet kapitale, përfshirë ato nga shitja e pasurive kapitale;*
- *Pensionet;*
- *Fitimet nga lotaritë dhe lojërat e fatit;*
- *Dhuratat me vlerë më të madhe se 5,000 euro për periudhë tatimore;*
- *Të ardhurat nga veprimtaria afariste;*
- *Çdo e ardhur tjetër që nuk është përjashtuar.*

2.4. Të Ardhurat e Përjashtuara nga TAP

Të ardhurat e mëposhtme janë të përjashtuara nga tatimi:

- *Pagat e përfaqësuesve, zyrtarëve dhe stafit të organizatave ndërkombëtare, shteteve të huaja dhe agjencive të tyre, si dhe agjencive donatore apo kontraktorëve të tyre;*
- *Kompensimet për dëmtim ose shkatërrim të pasurisë;*
- *Politikat e sigurimit të jetës që paguhen në rast vdekjeje të të siguruarit;*
- *Interesi nga instrumente financiare të emetuara ose të garantuara nga një Autoritet Publik i Kosovës;*
- *Pagat e personave me aftësi të kufizuara;*
- *Pensionet dhe ndihmat sociale;*
- *Pasuritë e trashëguara;*
- *Dhuratat ndërmjet bashkëshortëve, nga prindërit të fëmijët dhe nga fëmijët të prindërit, pavarësisht nga vlera e tyre;*
- *Shpenzimet për programe arsimore dhe trajnime të paguara nga punëdhënësi për punonjësën (nën kushte dhe kufizime të caktuara);*

- *Bursat shkollore;*
- *Kompensimi për eksproprijim;*
- *Kontributet e detyrueshme të paguara nga punëdhënësi për sigurimin shëndetësor të punonjësit;*
- *Kompensimet e përfituara përmes vendimeve gjyqësore;*
- *Grantet, subvencionet dhe donacionet;*
- *Dividentët;*

2.5. Detyrimet për Pagesa

Tatimpaguesit që realizojnë të ardhura nga biznesi, qiraja ose pasuria jomateriale duhet të bëjnë pagesa tremujore në një llogari të specifikuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Të ardhurat nga biznesi:

Për tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto nga biznesi nën 50,000 euro, të cilët nuk mbajnë libra dhe regjistra të hollësishëm, pagesat tremujore përcaktohen si vijon:

- *3% e të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtari të ngjashme, me pagesë minimale prej 37.5 eurosh;*
- *9% e të ardhurave bruto nga shërbimet, aktivitetet profesionale, zëjtaritë, argëtimi dhe të ngjashme, me pagesë minimale prej 37.5 eurosh.*

Për tatimpaguesit e tjerë (ata me të ardhura bruto mbi 50,000 euro ose që kanë zgjedhur të mbajnë libra të detajuar), pagesat tremujore bëhen si më poshtë:

- *Një e katërta e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore aktuale, bazuar në të ardhurat e vlerësuara si të tatueshme, pas zbritjes së shumës së mbajtur gjatë tremujorit;*
- *Për periudhat e dyta dhe pasuese, të paktën një e katërta e 110% të detyrimit tatimor të periudhës paraprake, pas zbritjes së shumës së mbajtur gjatë tremujorit.*

Të ardhurat nga qiraja:

Pagesat tremujore për të ardhurat nga qiraja duhet të llogariten si 10% e të ardhurave të tatueshme nga qiraja të pranuar gjatë tremujorit paraprak, pas zbritjes së shumës së mbajtur gjatë atij tremujori, në përputhje me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatës.

Të ardhurat nga pasuria jomateriale:

Pagesat tremujore për të ardhurat nga pasuria jomateriale llogariten si 10% e të ardhurave të tatueshme nga pasuria jomateriale të pranuar gjatë tremujorit paraprak, pas zbritjes së çdo shume të mbajtur si royalty.

Të ardhurat nga burime të tjera:

Tatimpaguesit me të ardhura të tatueshme nga burime të tjera, përfshirë fitimet kapitale, janë të obliguar të bëjnë pagesat tatimore më së voni deri më 31 mars të vitit pasues të përfundimit të periudhës tatimore.

2.6. Deklarimi

Tatimpaguesit janë të obliguar të përgatisin dhe dorëzojnë deklaratën vjetore të tatimit më së voni deri më 31 mars të vitit pasues për periudhën tatimore. Nuk janë të obliguar të dorëzojnë deklaratë vjetore tatimore tatimpaguesit që marrin të ardhura nga:

- pagat;
- veprimtaria afariste, për tatimpagues me të ardhura vjetore nën 50,000 euro ose që nuk kanë zgjedhur të mbajnë libra dhe regjistra (shih më sipër) – këta tatimpagues mund të zgjedhin gjithsesi të dorëzojnë deklaratë vjetore;
- qiraja, kur pagesat janë kryer tërësisht çdo tremujor (shih më sipër) edhe këtu tatimpaguesi mund të zgjedhë të dorëzojë deklaratë vjetore;
- interesi;
- fitimet nga lotaritë;
- të ardhurat nga pasuria jomateriale; dhe
- të ardhura nga kategori të veçanta (si fermerë, mbledhës të materialeve për riciklim, fruta pylli, bimë mjekësore etj.).

3. TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH)

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në Kosovë rregullohet nga Ligji Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, i cili është i harmonizuar me Direktivën e BE-së. TVSH aplikohet për mallrat dhe shërbimet e prodhuara në Kosovë nga persona të tatueshëm ose për mallrat e importuara në Kosovë.

3.1. *Personat e Tatueshëm*

Person i tatueshëm është secili person i cili është, ose kërkohet që të regjistrohet për TVSH dhe i cili në mënyrë të pavarur zhvillon një aktivitet ekonomik në mënyrë të rregullt apo jo të rregullt, pavarësisht nga qëllimi ose rezultati i atij aktiviteti ekonomik. Çdo aktivitet i prodhuesve, tregtarëve ose personave që furnizojnë mallra ose shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, të profesioneve, duhet të konsiderohet si aktivitet ekonomik. Eksploatimi i pasurisë së prekshme dhe të pa prekshme me qëllim të krijimit të të ardhurave nga ato në baza të rregullta, në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik.

Subjektet e huaja që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Kosovë konsiderohen si tatimpagues që nga fillimi i veprimtarisë së tyre në territorin e Kosovës. Nuk konsiderohen persona të tatueshëm:

- *Organizatat jofitimprurëse, përveç rasteve kur pranojnë pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike;*
- *Organizatat ndërkombëtare, shtetet e huaja dhe agjencitë e tyre;*
- *Autoritetet publike në nivel qendror dhe lokal, dhe subjektet e tjera të përcaktuara me ligj. Megjithatë, kur këto subjekte merren me aktivitete specifike në masë të konsiderueshme, si p.sh. shërbime të telekomunikacionit, furnizim me ujë dhe energji ose transport, bëhen persona të tatueshëm.*

3.2. Regjistrimi

Personat e tatueshëm duhet të regjistrohen në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) kur qarkullimi i tyre vjetor tejkalon shumën prej 30,000 euro brenda një viti kalendarik. Subjektet e regjistruara marrin certifikatën e regjistrimit, e cila duhet të jetë e ekspozuar në vendin e ushtrimit të veprimtarisë. Personat që ushtrojnë më shumë se një veprimtari ekonomike në vende të ndryshme brenda territorit të Kosovës identifikohen me një numër të vetëm të TVSH-së. Ortakëritë dhe grupet e personave gjithashtu marrin një numër të vetëm regjistrimi për TVSH.

Subjektet që nuk janë të vendosura në Kosovë duhet të regjistrohen për TVSH në fillim të aktivitetit të tyre në Kosovë. Ato duhet të caktojnë një përfaqësues tatimor dhe të regjistrohen në emër të përfaqësuesit brenda pesë ditëve nga caktimi i tij dhe para fillimit të aktivitetit. Megjithatë, këto subjekte nuk janë të obliguara të regjistrohen nëse i ofrojnë mallrat apo shërbimet e tyre vetëm për persona të regjistruar për TVSH në Kosovë. Subjektet që nuk kanë obligim për t'u regjistruar mund të kërkojnë regjistrim vullnetar në ATK.

3.3. Normat e TVSH-së

Kosova aplikon:

- Normë standarde prej 18%;
- Normë të reduktuar prej 8% për furnizimin dhe importin e mallrave dhe shërbimeve të caktuara, përfshirë: ujë të pijshëm (jo ujë të ambalazhuar), energji elektrike (përfshirë shërbimet e transmetimit dhe shpërndarjes), drithëra dhe produkte drithërash për konsum njerëzor, produkte të caktuara të qumështit, kripë për konsum njerëzor, vezë, libra shkollorë, botime serike dhe të tjera.

3.4. Përrjashtimet

Përrjashtime pa të drejtë zbritjeje të TVSH-së (me normë zero) zbatohen për aktivitete me interes publik, si: shërbimet spitalore dhe kujdesi mjekësor; shërbimet për fëmijë dhe të rinj, arsimi, veprimtaria e sindikatave, OJQ-ve, partive politike dhe organizatave fetare, mediat publike, gazetatat dhe mediat elektronike, shërbimet e transportit publik, etj.

Përrjashtime me të drejtë për zbritje të TVSH-së zbatohen për raste të caktuara importi, përfshirë: furnizimin me metale të çmueshme dhe kartëmonedha për Bankën Qendrore të Kosovës, importimin e gazit dhe energjisë elektrike, makineri dhe lëndë të para për prodhim, pajisje të teknologjisë informative, etj.

3.5. Zbritja

E drejta për zbritjen e TVSH-së së blerjeve lind në momentin kur TVSH bëhet e zbatueshme. TVSH e blerjeve është e zbritshme nëse lidhet me mallrat dhe shërbimet që përdoren ose janë të destinuara për t'u përdorur në transaksionet e tatueshme të tatimpaguesit. TVSH nuk mund të zbritet për: pasuri të caktuara të përdorura për qëllime jobiznesi, si: jahte, aeroplanë privatë, vetura dhe motoçikleta; për veturat që përdoren si për qëllime private ashtu edhe për biznes, mund të zbritet vetëm deri në 50%; shpenzimet që lidhen me pasuri të paluajtshme të përdorura njëkohësisht për qëllime biznesi dhe personale zbriten vetëm për pjesën që përdoret për biznes.

Kur mallrat dhe shërbimet përdoren për transaksione si të zbritshme, ashtu edhe të pazbritshme, vetëm pjesa që lidhet me transaksionet jozbritshme përjashtohet nga zbritja.

Tatimpaguesit mund të llogarisin proporcionin e zbritjes nëse marrin autorizim nga ATK dhe ofrojnë arsyetim të mjaftueshëm.

4. TAKSAT DOGANORE DHE AKCIZAT

4.1. Taksat Doganore

Taksat doganore në Kosovë variojnë nga 0% deri në 10%. Importet nga vendet anëtare të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) zakonisht janë të përjashtuara nga taksat doganore. Për më tepër, që nga data 1 prill 2016, disa produkte bujqësore, peshq dhe produkte të peshkimit nga Bashkimi Evropian janë gjithashtu të përjashtuara nga taksat doganore në Kosovë.


Sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Turqisë dhe Kosovës, disa mallra tashmë përfitojnë nga reduktime në taksat doganore. Kosova është zotuar që t'i eliminojë të gjitha taksat doganore për mallrat e përcaktuara në këtë marrëveshje brenda një periudhe 9-vjeçare, duke filluar nga 1 shtatori 2019, kur marrëveshja hyri në fuqi.

Për mallrat e importuara nga vendet që nuk kanë marrëveshje të tregtisë së lirë me Kosovën, shumica e tyre tatohen me normë doganore 10%.

4.2. Akcizat

Akcizat në Kosovë zbatohen për produkte të caktuara të prodhuara, si: cigare dhe produkte të tjera të duhanit, pije alkoolike, ujë i ambalazhuar, pije joalkoolike, derivate të naftës. Akciza llogaritet si shumë fikse për një sasi të caktuar të mallit (p.sh., për litër, kilogram apo njësi).

Normat aktuale të akcizës janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-220, i cili ndryshon dhe plotëson Ligjin Nr. 03/L-112 për normat e akcizës në Kosovë.



SEKTORI FINANSIAR

+0.19%

.590

▲ 35,140.5

2.59%



4. SEKTORI FINANCIAR

Sektori financiar i Kosovës po përjeton rritje dhe qëndrueshmëri të konsiderueshme, duke reflektuar përkushtimin e vendit ndaj stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik. Sipas Raportit Vjetor 2024 të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), deri në dhjetor 2024, asetet totale të sistemit financiar të Kosovës arritën në 12.75 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 14.8 për qind krahasuar me vitin 2023. Sektori bankar vazhdon të dominojë peizazhin financiar të Kosovës, me asete në vlerë prej 8.6 miliardë euro, që përfaqësojnë rreth 67 për qind të aseteve totale të sistemit financiar. Si shtyllë kryesore e sektorit financiar, bankat luajnë një rol kyç në mbështetjen e aktivitetit ekonomik përmes financimit dhe ofrimit të shërbimeve thelbësore financiare.

Sektori i mikrofinancave dhe institucionet financiare jobankare vazhduan zgjerimin edhe gjatë vitit 2024, me asete totale që arritën në 650.7 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 20.5 për qind krahasuar me vitin paraparak.

Në fund të vitit 2024, numri i institucioneve financiare arriti në 139, nga 136 sa ishin një vit më parë. Gjatë vitit, katër ndihmës financiarë të rinj hynë në treg, ndërsa një bankë me kapital të huaj, e licencuar dhe e mbikëqyrur nga BQK, ndërpreu vullnetarisht aktivitetin dhe dorëzoi licencën e saj.

Vlera e kredive dhe produkteve kreditore u rrit në 5.8 miliardë euro, duke përfaqësuar 45.5 për qind të aseteve totale të sektorit financiar, çka dëshmon rolin gjithnjë në rritje të kreditimit në financimin e familjeve dhe bizneseve në Kosovë.

Kosova po avancon gjithashtu drejt integritit në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), një nismë e Bashkimit Evropian që harmonizon pagesat elektronike në euro në të gjithë Evropën. Në dhjetor 2024, Banka Qendrore e Kosovës dorëzoi aplikimin e përditësuar paraparak për anëtarësim në SEPA, pas miratimit të ligjeve dhe rregulloreve kyçe financiare, duke kompletuar kornizën legislative të nevojshme për anëtarësim. Integrimi në SEPA pritet të sjellë përfitime të rëndësishme ekonomike dhe financiare, përfshirë uljen e kostove të transfereve ndërkombëtare dhe rritjen e efikasitetit të pagesave ndërkufitare në euro për qytetarët dhe bizneset.

Për më tepër, Kosova ka miratuar së fundmi ligjin për krypto-asetet, duke përcaktuar kërkesat për licencim dhe rregullim të pjesëmarrësve në treg. Ky zhvillim e pozicionon Kosovën ndër vendet e para në rajon që formalizojnë sektorin e krypto-aseteve, duke krijuar mundësi të reja për investitorët dhe bizneset e financave digjitale.

Banka Qendrore e Kosovës, e themeluar si person juridik publik i pavarur në bazë të Ligjit për BQK-në, është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorit financiar. BQK siguron stabilitetin, integritetin dhe funksionimin efektiv të sistemit financiar të Kosovës, duke bashkëpunuar ngushtë me pjesëmarrësit e tregut për të ruajtur një mjedis financiar të qëndrueshëm dhe rezistent.

Në tërësi, sektori financiar i Kosovës dëshmon përkushtimin e vendit ndaj rritjes ekonomike dhe stabilitetit financiar, duke ofruar shërbime financiare të qasshme dhe konkurruese. Për investitorët potencialë, veçanërisht sektori i mikrofinancës dhe institucionet financiare jobankare ofrojnë mundësi të veçanta për angazhim në një ekosistem financiar dinamik dhe në zgjerim të vazhdueshëm, me perspektivë të fortë për rritje në vitet e ardhshme.

4.1. BANKAT

Sektori bankar i Kosovës përfaqëson një dëshmi të qartë të zhvillimit dhe avancimit të infrastrukturës financiare të vendit. Aktualisht, në Kosovë operojnë gjithsej 10 banka, prej të cilave 7 janë në pronësi të huaj, çka pasqyron besimin e investitorëve ndërkombëtarë në stabilitetin dhe sigurinë e sistemit financiar të Kosovës. Ndërkohë, 3 banka janë në pronësi vendore.

Një nga veçoritë që e dallon Kosovën është prania strategjike dhe dinamike e këtyre institucioneve financiare. Kjo prani ka krijuar një mjedis konkurrues të fortë, në përfitim të drejtpërdrejtë të bizneseve dhe individëve. Konkurrenca e lartë ndërmjet bankave ka sjellë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, duke u mundësuar klientëve të zgjedhin ofertat më të përshtatshme sipas nevojave të tyre.

Përdoruesit përfitojnë nga struktura konkurruese të çmimeve, norma të favorshme interesi, si dhe qasje në sisteme bankare moderne dhe teknologjikisht të avancuara, të krahasueshme me standardet më të mira ndërkombëtare.

Në thelb, sistemi bankar i Kosovës karakterizohet nga moderniteti dhe orientimi drejt klientit. Shumëllojshmëria e opsioneve financiare dhe niveli i lartë i shërbimeve krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e bizneseve dhe përmbushjen e nevojave financiare të individëve, duke kontribuar në rritjen ekonomike, inovacionin dhe prosperitetin financiar në vend.

Kërkesat Ligjore për Institucionet Financiare

Themelimi dhe veprimtaria e bankave në Republikën e Kosovës rregullohen nga Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat. Në kuadër të këtij rregullimi, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) luan një rol kyç në licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave, duke përfshirë dhënien e licencave për banka të reja dhe lejeve për bankat e huaja për të themeluar zyra përfaqësuese. Gjithashtu, çdo vendim për mbylljen, zhvendosjen ose themelimin e degëve apo zyrave, si lokale ashtu edhe të huaja, kërkon miratimin paraprak të BQK-së.

Bankat mund të themelohen vetëm si shoqëri aksionare dhe duhet të plotësojnë kërkesa të rrepta për kapitalin dhe likuiditetin, ndërsa statuti dhe aktet e tyre themelore duhet të miratohen nga BQK.

Bankat e huaja që dëshirojnë të operojnë në Kosovë mund të hapin një degë, por kërkesat janë të njëjta me ato të bankave vendore, me kontroll shtesë. BQK kërkon dëshmi që autoriteti mbikëqyrës i vendit të origjinës së bankës huaj miraton themelimin dhe ushtron mbikëqyrjen globale konsoliduese mbi bankën huaj. Për më tepër, BQK kërkon garanci nga autoriteti mbikëqyrës i juridiksionit të bankës huaj lidhur me organizimin, licencimin, kapitalin dhe likuiditetin e aplikantit.

Për bankat e huaja që kërkojnë një prani më të kufizuar, BQK mund të japë autorizim për themelimin e një zyre përfaqësuese në Kosovë. Megjithatë, këto zyra janë të pritshme të merren kryesisht me: ofrimin e informacionit, aktivitete lidhëse, kërkime tregu dhe studimin e mundësive të investimeve. Ato nuk lejohen të kryejnë operacione bankare brenda Kosovës.

4.2. INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKORE

Përderisa sektori bankar mbetet themeli i sistemit financiar të Kosovës, është po aq e rëndësishme të njihet prania në rritje dhe dinamike e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. Këto luajnë një rol të pazëvendësueshëm në ofrimin e zgjidhjeve financiare inovative për tregje të pashfrytëzuara, promovimin e përfshirjes financiare dhe nxitjen e rritjes ekonomike.

4.2.1. *Institucionet Mikrofinanciare*

Institucionet Mikrofinanciare (IMF-të) janë entitete të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, të cilat mund të organizohen si organizata joqeveritare (OJQ) ose si shoqëri aksionare. Ato ofrojnë kryesisht kredi dhe një gamë të kufizuar shërbimesh financiare për entitete mikro dhe të vogla ligjore, familje me të ardhura të ulëta dhe individë me të ardhura të ulëta. Aktualisht, Kosova ka 10 IMF-të të regjistruara, shumica e të cilave janë organizata joqeveritare dhe jofitimprurëse.

Kriteret për licencimin e bankave zbatohen gjithashtu për regjistrimin e IMF-të. Një IMF e organizuar si OJQ duhet të regjistrohet në Ministrinë e Administratës Publike për statusin e përjashtuar nga tatimi, ndërsa IMF-të e organizuara si shoqëri aksionare duhet së pari të regjistrohen në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

IMF-të janë të autorizuar të angazhohen në aktivitete të ndryshme, përfshirë ofrimin e shërbimeve të pagesave në lidhje me kreditë, sigurimin e fondeve përmes granteve ose huamarrjes, marrjen hua dhe vendosjen e fondeve në tregje dhe institucione të miratuara, blerjen, zotërimin ose shpronësimin e pronës për qëllime biznesi, ofrimin e ndihmës financiare, teknike dhe profesionale për klientët, si dhe aktivitete të tjera financiare të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) përmes Rregulloreve ose Urdhrave.

4.2.2. Institucionet Financiare Jobankare (IFJB)

Institucionet financiare jo-bankare (IFJB) janë entitete ligjore që nuk janë banka ose Institucione Mikrofinanciare (IMF) dhe që licencohen nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për t'u angazhuar në një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme:

- *Të japin kredi, të hyjnë në kontrata huaje dhe kontrata të lizingut financiar;*
- *Të nënshkruajnë, tregtojnë ose shpërndajnë letra me vlerë;*
- *Të veprojnë si kompani investimi ose këshilltar investimesh;*
- *Të ofrojnë shërbime të tjera financiare si shkëmbim valutor dhe këmbim parash, karta krediti, factoring ose garanci;*
- *Të ofrojnë shërbime të tjera këshilluese financiare, trajnuese ose transaksionale.*

Si pjesë e qëllimit të tyre, IFJB mund të angazhohen gjithashtu në aktivitetet e mëposhtme:

- *Ofrimin e shërbimeve të pagesave në lidhje me kreditë e dhëna klientëve;*
- *Sigurimin e fondeve përmes granteve, investimeve ose huamarrjes për qëllime të kreditimit ose për përdorim të tyre;*
- *Marrjen hua dhe vendosjen e fondeve në tregje dhe institucione të miratuara nga BQK për menaxhimin e likuiditetit;*
- *Ofrimin e kredisë për financimin e blerjes së pajisjeve;*
- *Blerjen, zotërimin, qiradhënien, marrjen me qira, mirëmbajtjen, transferimin, shitjen ose shpronësimin e çdo prone të paluajtshme ose lëvizshme që përdoret për kryerjen e aktivitetit të tyre;*
- *Transferimin dhe marrjen e parave, ose shërbime pagesash, për pagesa që origjinojnë brenda ose jashtë vendit;*
- *Ofrimin e ndihmës financiare, teknike dhe profesionale dhe trajnim klientëve të tyre, ose ndihmën në sigurimin e shërbimeve në këto fusha.*

Kur themelohet një IFJB me aktivitet dhënien e kredisë, duhet marrë parasysh kufizimi mbi shumën maksimale të kredisë që IFJB mund t'i japë një personi. Shuma maksimale e kredisë që një IFJB mund t'i japë një personi ose një entiteti ligjor nuk mund të tejkalojë 20% të portofolit aktual të kredisë.

4.3. SIGURIMET

Aktivitetet e kompanive të sigurimeve, kompanive të ri-sigurimit dhe ndërmjetësve të sigurimeve në Kosovë rregullohen nga Ligji Nr. 05/L-045 për Sigurimet ("Ligji për Sigurimet").

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka autoritetin ekskluziv për lëshimin e licencave, mbikëqyrjen dhe rregullimin e siguruesve (përfshirë ri-siguruesit), ndërmjetësve të sigurimeve dhe trajtuesve të kërkesave për kompensim. Licencat jepen për klasa specifike sigurimesh. Sipas Ligjit për Sigurimet, sigurimi në Kosovë ndahet në sigurim jo-jetë dhe sigurim jetë. Në vitin 2022, sigurimi jo-jetë përfaqësonte 91.6% të totalit të aseteve të sektorit, ndërsa sigurimi jetë përbënte pjesën tjetër.

Sigurimi jo-jetë përfshin sigurim për: aksidente; shëndet; automjete tokësore; automjete hekurudhore; aeroplanë; anije; mallra të transportuara; zjarr dhe forcë natyrore; dëmtime të tjera të pronës; përgjegjësi të përgjithshme; kredi; garanci; humbje financiare; mbrojtje ligjore; dhe asistencë; etj. Licencat për sigurimin jo-jetë lëshohen nga BQK për klasë të veçantë.

Sigurimi jetë përfshin: sigurim jete; sigurim martese dhe lindje; sigurim jete i lidhur me ndërmarrje investimi kolektive; sigurim shtesë në lidhje me vdekje ose paaftësi për shkak të aksidenteve, paaftësi të përhershme për punë ose paaftësi në punë, shërbime spitalore dhe mjekësore, sëmundje të pashërueshme; etj. Licencat për sigurimin jetë lëshohen nga BQK veçmas ose për të gjitha klasat.

BQK mund të japë gjithashtu leje për një zyrë përfaqësuese për një sigurues të huaj, me kusht që siguruesi i huaj të mos angazhohet në aktivitete sigurimi dhe të kufizojë aktivitetet e tij në ofrimin e informacionit dhe aktivitete lidhëse, si dhe studimin e tregjeve dhe mundësive të investimeve.

Kompanitë e sigurimeve në Kosovë mund të themelohen vetëm në formën e një shoqërie aksionare, të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve. Një kopje e aktit themelues dhe statutit të siguruesit duhet të aprovohet nga BQK.

Kapitali themelues i të gjithë siguruesve jo-jetë nuk duhet të jetë më i ulët se 2,200,000 euro, ose 3,200,000 euro kur përfshihen një ose më shumë nga rreziqet e mëposhtme: përgjegjësi për përdorimin e automjeteve, aeroplanëve, anijeve, përgjegjësi të përgjithshme, sigurim kredie dhe garantim sigurimi. Siguruesi duhet gjithashtu të ketë një fond shtesë për shpenzime fillestare që nuk duhet të jetë më pak se 20% e kapitalit.

Një ndërmjetës i sigurimeve është një person fizik ose juridik i kontraktuar nga siguruesi dhe i licencuar nga BQK për të kryer prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe asistencën gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Ndërmjetësit e sigurimeve veprojnë qoftë kryesisht në emër të siguruesit ose të siguruarit.

Trajtuesit e kërkesave janë persona juridikë të kontraktuar nga siguruesi dhe siguruari ose të licencuar nga BQK për të kryer aktivitetet e vlerësimit të dëmeve dhe aktivitete të tjera vlerësimi që lidhen me sigurimin.



4.4. KRIPTO-ASETET

Më 22 nëntor 2024, Kosova ndërmori një hap të rëndësishëm drejt rregullimit të tregut të krypto-aseteve, duke miratuar Ligjin Nr. 08/L-295 për Kripto-Asetet. Ky ligj vendos bazat e para formale ligjore për një sektor që deri më tani funksiononte kryesisht pa një kornizë të qartë rregullative dhe shpesh jashtë mbikëqyrjes financiare.

Ligji përcakton se operatorët që merren me emetimin, shpërndarjen, tregtimin ose ruajtjen e krypto-aseteve duhet të jenë të licencuar dhe të mbikëqyrur nga autoritetet kompetente, përfshirë Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Administratën Tatimore të Kosovës dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare. Si rrjedhojë, asnjë person fizik ose juridik nuk mund të ofrojë shërbime për krypto-asete pa mbikëqyrjen e këtyre autoriteteve.

Në përputhje me këtë ligj, BQK miratoi më 29 gusht 2025 Rregulloren për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve për Kripto-Asete, e cila përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet për licencimin e operatorëve që ofrojnë shërbime si:

- *Tregtimi i krypto-aseteve me valutë fiat (përfshirë ATM-të për krypto) dhe anasjelltas, përmes zyrave fizike;*
- *Tregtimi i krypto-aseteve për krypto-asete të tjera.*

Vetëm personat juridikë të licencuar nga BQK si Ofrues të Shërbimeve për Kripto-Asete (CASP) mund të ofrojnë këto shërbime. Operatorët e licencuar mund të tregtojnë vetëm krypto-asete të njohura ligjërisht sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian.

4.4.1. Aplikimi për Licencim

Aplikimi për licencë për krypto-asete nuk është një formalitet. Përveç kriterëve të përgjithshme të parashikuara në ligj, Rregullorja e BQK përcakton kërkesa specifike që çdo aplikant duhet të përmbushë. Dokumentacioni i aplikimit duhet të përfshijë:

- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe statutet e tij;*
- *Programin operativ që përshkruan shërbimet për krypto-asete që do të ofrohen;*

- *Strukturën e qeverisjes dhe informacion mbi aksionarët dhe menaxhmentin e lartë;*
- *Planin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut, përfshirë masat kundër pastrimit të parave (AML) dhe financimit të terrorizmit (CFT);*
- *Dëshminë e kapitalit të paguar dhe pagesën e tarifës së licencës.*

4.4.2. Kriteret Kryesore të Licencimit

Rregullorja e BQK thekson tre fusha kyçe që përcaktojnë nëse një operator do të marrë licencë: kapitali minimal, qeverisja dhe organizimi i brendshëm, dhe reputacioni i aksionarëve.

1. Kapitali Minimal

Aplikantët duhet të kenë një kapital minimal prej 125,000 euro, plus 20% shtesë për mbulimin e kostove fillestare të themelimit, operimit dhe administrimit. Ky kapital duhet të jetë paguar në para, i dokumentuar ligjërisht dhe nuk duhet të rrjedhë nga borxhe apo kredi, duke shërbyer si garanci për stabilitetin financiar.

2. Qeverisja korporative dhe Organizimi i Brendshëm

Operatorët duhet të demonstrojnë një qeverisje të qëndrueshme dhe një strukturë të qartë organizative me linja përgjegjësie të përcaktuara dhe transparente. Kërkesat kryesore përfshijnë:


- *Bord menaxhimi me të paktën tre anëtarë, ku shumica janë jo-ekzekutivë dhe të pavarur;*
- *Anëtarët e bordit duhet të përmbushin kriteret e BQK-së, përfshirë diploma universitare relevante dhe të paktën tre vjet përvojë në bankë, financë ose sektorë të ngjashëm;*
- *Një komitet për auditim të brendshëm ose menaxhimin e rrezikut që ndihmon bordin, duke përfshirë të paktën një ekspert të jashtëm në kontabilitet ose auditim.*

3. Reputacioni i Aksionarëve

Aksionarët kryesor që zotërojnë më shumë se 10% të aksioneve duhet të kenë një reputacion të mirë, pa dënime për pastrim parash, financim të terrorizmit, ose përgjegjësi për falimentimin e ndonjë subjekti ekonomik. Nëse ndikimi i një aksionari rrezikon stabilitetin, BQK mund të ndërmarrë masa, përfshirë pezullimin e të drejtave të votës të lidhura me aksionet e tij.

Këto kërkesa sigurojnë që licencimi në sektorin e krypto-aseteve të jetë një proces rigoroz, duke garantuar siguri financiare, qeverisje të përgjegjshme dhe transparencë në një treg dinamik dhe në zhvillim të shpejtë.

Vendosja e një kornize ligjore dhe rregullative për krypto-asetet pozicionon Kosovën si një treg pionier në rajon, duke ofruar qartësi, transparencë dhe besim për investitorët. Përmes kërkesave për licencim, qeverisje dhe mbikëqyrje, ligji siguron që sektori i krypto-aseteve të funksionojë me integritet dhe përgjegjësi financiare, duke krijuar gjithashtu mundësi të reja për inovacion dhe rritje brenda ekosistemit financiar në zhvillim të Kosovës.





INVESTIMET E HUAJA

5. INVESTIMET E HUAJA

Më 6 shtator 2024, ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, i cili shfuqizon Ligjin Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligjin Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike.

Ky ligj vendos një kornizë të re ligjore për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e investimeve, duke përcaktuar parimet themelore të zhvillimit të qëndrueshëm.

Përmes këtij ligji, përcaktohen parimet themelore që rregullojnë investimet, si dhe të drejtat dhe detyrimet e institucioneve publike, autoriteteve kompetente dhe investorëve, në lidhje me realizimin e investimeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij ligji është se ai është pjesërisht i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, konkretisht me Rregulloren (BE) 2019/452 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 19 mars 2019, e cila përcakton kornizën për verifikimin e investimeve të huaja direkte në Bashkimin Evropian.

Ky harmonizim reflekton orientimin e Kosovës drejt përafrimit me standardet evropiane në fushën e investimeve.

5.1. LIGJI PËR INVESTIMET E QËNDRUESHME

Investitorët e huaj përfshijnë çdo person fizik ose juridik që nuk ka shtetësi të Republikës së Kosovës, si dhe çdo shoqëri tregtare të themeluar sipas legjislacionit të një shteti të huaj.

Gjithashtu, investitor i huaj konsiderohet edhe shoqëria tregtare e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, në të cilën personat e huaj zotërojnë shumicën e të drejtave të vendimmarrjes.

Si investime konsiderohen:

- *valuta;*
- *e drejta mbi sendin e luajshëm ose të paluajshëm, siç është pronësia, qiraja ose e drejta e ngjashme;*
- *aksioni ose forma tjetër e pjesëmarrjes në shoqëri tregtare;*

- *e drejta e pronësisë intelektuale ose industriale, siç është e drejta e autorit, patenta, marka tregtare, dizajni industrial, e drejta e mbarështuesit, ecuria teknike, njohuria praktike, fshehtësia tregtare, treguesi gjeografik, emri tregtar lidhur me investimin;*
- *instrumenti financiar;*
- *leja, licenca ose e drejta tjetër komerciale e përcaktuar me ligj, kontratë ose akt tjetër.*

Ky kategorizim i gjerë i formave të investimit kontribuon në rritjen e sigurisë juridike për investitorët, duke garantuar mbrojtje ligjore për një spektër të gjerë aktivitesh ekonomike si dhe duke krijuar një mjedis më të favorshëm për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në Republikën e Kosovës.


5.1.1. Të drejtat e investitorëve të huaj

Kosova mbron të drejtat dhe parimet thelbësore për të krijuar një klimë të favorshme investimi.

Çdo person ka të drejtë të investojë në çdo lloj veprimtarie ekonomike dhe në çdo pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjithë investitorët dhe investimet e tyre trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit, pa diskriminim, duke garantuar një mjedis të hapur dhe konkurrues për zhvillimin e veprimtarive ekonomike.

Trajtimi i Barabartë i Investitorëve të Huaj dhe Vendorë

Investitorët e huaj gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime ligjore si investitorët vendorë. Ky parim siguron trajtim të barabartë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike dhe thekson angazhimin e Republikës së Kosovës për krijimin e një klime të favorshme dhe të parashikueshme për investime, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kosova ushtron të njëjtin trajtim ndaj të gjithë investitorëve të huaj dhe diskriminimi është rreptësisht i ndaluar.



Mbrojtja dhe Siguria e Investimeve

Investitorët dhe investimet e tyre gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Niveli i mbrojtjes nuk mund të jetë më pak i favorshëm se ai i parashikuar me këtë ligj ose sipas normave të pranueshme të së drejtës ndërkombëtare.

Në veçanti, sipas legjislacionit në fuqi, investitorët mund të përfitojnë nga trajtim i veçantë bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, veçanërisht për sa i përket:

- *Mënyrës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të investimeve;*
- *pjesëmarrjes në bashkime doganore, ekonomike ose monetare;*
- *tregjeve të përbashkëta dhe zonave të tregtisë së lirë; dhe*
- *shmangies së tatimit të dyfishtë.*

Njohja dhe Respektimi i të Drejtave

Autoritetet publike në Kosovë janë të detyruara të njohin dhe respektojnë të gjitha të drejtat e investitorëve të huaj, përfshirë ato që lidhen me të drejtat kontraktuale, pronën (të paluajtshme dhe të luajtshme), pronësinë intelektuale dhe asete të tjera.

5.1.2. Prioritetet dhe Lehtësirat për Investitorët e Huaj

Ligji i ri përcakton sektorët që konsiderohen prioritarë për investime në Kosovë, për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe social.

Këta sektorë përfshijnë:

- *industrinë prodhuese dhe përpunuese;*
- *bujqësinë;*
- *teknologjinë e informacionit dhe komunikimit;*
- *arsimin dhe aftësimin, hulumtimin dhe inovacionin;*
- *shëndetësinë;*
- *turizmin;*

- *administrimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave;*
- *transportin;*
- *energjinë; dhe*
- *minierat.*

Lehtësirat për Investitorët e Huaj

Investitorët që realizojnë investime që përmbushin objektivat shtetërore dhe/ose veprojnë në sektorët prioritarë mund të përfitojnë lehtësira të ndryshme të ofruara nga shteti.

Këto lehtësira përfshijnë:

- *masa për lehtësimin e importit të makinerive, lëndëve të para, ose pajisjeve për prodhim dhe përpunim;*
- *mbështetje financiare për blerjen e makinerive dhe zhvillimin e kapaciteteve prodhuese.*

Ligji gjithashtu parashikon:

- *subvencione për pagat e qytetarëve të Republikës së Kosovës që punësohen ose aftësohen;*
- *mbështetje për hulumtim dhe zhvillim;*
- *përparësi në qasje në parqet industriale dhe teknologjike;*
- *përkrahje për qasje në financa.*

Investitorët mund të përfitojnë edhe nga masa të lehtësimit administrativ, përfshirë reduktimin ose mbulimin e kostove administrative. Përparësi në përfitimin e këtyre lehtësirave u jepet investimeve strategjike dhe investimeve të qëndrueshme që japin kontributin më të madh në realizimin e objektivave shtetërore. Të gjitha lehtësirat jepen dhe publikohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë.

Është e rëndësishme të theksohet se, për të shërbyer dhe kuptuar më mirë nevojat e investitorëve të huaj, ligji i ri parashikon themelimin e dy agjencive të specializuara me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë:

Agjencia për Investime dhe Eksport (AIE) – AIE është themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si agjenci ekzekutive dhe do të ofrojë shërbime gjithëpërfshirëse, përfshirë promovimin e investimeve, lehtësimin e investimeve, kujdesin pasues për investorët, vlerësimin e investimeve strategjike dhe promovimin e eksporteve.

Shumica e funksioneve që lidhen me investimet dhe eksportet do të përqendrohen nën AIE, duke e bërë atë një pikë të vetme kontakti për investorët dhe eksportuesit. Në këtë drejtim, AIE mbledh dhe analizon informacion të përditësuar mbi trendet e investimeve, zhvillon dhe menaxhon fushata promovuese për të kontaktuar investitorë potencialë, përgatit dhe përditëson materiale promovuese që ofrojnë informacion të qartë dhe të besueshëm mbi mjedisin investues, dhe organizon ngjarje, panairë dhe aktivitete tregtare në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

AIE ofron kujdes të veçantë për investorët strategjikë përmes lehtësimit të procedurave administrative, përkrahjes për qasje në infrastrukturë dhe përparësisë në parqe industriale e teknologjike. Për të siguruar transparencë, AIE mban dhe publikon regjistrin e investimeve strategjike, investitorëve, projekteve të përgatitura dhe informacioneve relevante mbi pronat publike dhe procedurat administrative.

Duke përqendruar këto funksione të investimeve dhe eksportit brenda një agjencie të vetme, ligji synon të reduktojë barrierat burokratike, duke lehtësuar operacionet e biznesit dhe investimet në Kosovë.

Agjencia për Inovacion dhe Përkrahjet të Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK) – është agjenci ekzekutive e themeluar në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Roli kryesor i saj është forcimi dhe zhvillimi i inovacionit dhe ndërmarrësisë në Kosovë.

Përveç ofrimit të informatave bazë për bizneset, këshillimit financiar dhe mbështetjes së vazhdueshme, AIPNK angazhohet edhe në ndërtimin e partneriteteve strategjike, organizimin e aktiviteteve të rrjetëzimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar,

si dhe në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese të destinuara për eksport, përmes asistencës teknike, granteve, trajnimeve dhe masave të tjera.

Për më tepër, AIPNK kontribuon në promovimin e turizmit dhe zhvillimin e parqeve industriale dhe teknologjike, duke krijuar një mjedis të favorshëm për bizneset dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar.

Këshilli i Investimeve

Përveç dy agjencive të përmendura, ligji i ri parasheh edhe një organ tjetër me rëndësi të veçantë institucionale – Këshillin e Investimeve.

Këshilli i Investimeve është një organ qeveritar me kompetenca vendimmarrëse, përgjegjës për vlerësimin, përzgjedhjen, miratimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e investimeve strategjike. Brenda mandatit të tij, Këshilli:

- *nxjerr vendime,*
- *negocion marrëveshje,*
- *miraton plane veprimi,*
- *përcakton masa dhe procedura për autoritetet publike, dhe*
- *kërkon dhe vendos lidhur me verifikimin plotësues të investimeve.*

Këshilli kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga ministrat përgjegjës për sektorët kryesorë ekonomikë, ndërsa Agjencia për Investime dhe Eksport (AIE) ushtron funksionin e sekretariatit të Këshillit.

5.2. INVESTIMET STRATEGJIKE

Sipas Ligjit Nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, Republika e Kosovës ofron një kornizë ligjore të avancuar për investimet strategjike, të cilat përfaqësojnë projekte me rëndësi të veçantë për zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Këto investime realizohen në sektorët prioritarë dhe/ose në përputhje me objektivat e përcaktuara me këtë ligj, duke përfutur përparësi dhe përkrahje shtetërore.

Një projekt investues mund të shpallet investim strategjik nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

- *Kontribuon në arritjen e objektivave shtetërore të Republikës së Kosovës;*
- *Është i orientuar drejt sektorëve prioritarë të investimeve;*
- *Propozuesi tregon kapacitet të mjaftueshëm financiar për zbatimin e projektit;*
- *Projekti është në përputhje me procedurat e përcaktuara në Nenin 30 të Ligjit (lidhur me propozimin e investimeve strategjike);*
- *Projekti i nënshtrohet verifikimit plotësues nëse kërkohet sipas Kapitullit VII dhe është dhënë vendim për autorizimin e investimit në përputhje me Nenin 40 të Ligjit.*

Vlera minimale e një investimi strategjik duhet të jetë së paku 10 milion Euro. Procedurat administrative për investimet strategjike trajtohen me prioritet të lartë. Agjencia për Investime dhe Eksport (AIE) ofron përkrahje të individualizuar përmes një zyrtari përgjegjës dhe siguron përcjellje të shpejtë të kërkesave pranë organeve kompetente, me afate të shkurtuara shqyrtimi, sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e investimeve strategjike, prona e paluajtshme publike mund të jepet në shfrytëzim, pas miratimit të autoriteteve përkatëse (Kuvendi i Republikës, kuvendi komunal ose organet kompetente të ndërmarrjeve publike). Shfrytëzimi i pronës publike mund të zgjasë deri në 99 vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës.

- Procedura e Njohjes së Investimeve Strategjike

Propozimi për një investim strategjik i parashtrohet Agjencisë për Investime dhe Eksport (AIE) për shqyrtim. Procesi i shqyrtimit të propozimit përbëhet nga dy faza kryesore:

Faza e Shqyrtimit Paraprak

Kjo fazë përdoret për të prezantuar informacionet bazë mbi projektin dhe propozuesin. Qëllimi i shqyrtimit paraprak është që AIE të kryejë një verifikim fillestar dhe të përcaktojë nëse projekti është i përshtatshëm për një shqyrtim më të thelluar.

Faza e Shqyrtimit Përfundimtar

Gjatë kësaj faze dorëzohen dokumente më të detajuara dhe të kompletuara për të vlerësuar kapacitetin dhe aftësinë e propozuesit për të realizuar projektin. Kjo fazë mundëson që AIE të marrë një vendim përfundimtar lidhur me autorizimin e investimit strategjik.

Shqyrtimi i propozimit

Shqyrtimi i një propozimi për investim strategjik përfshin:

- *Verifikimin e të dhënave dhe dokumenteve;*
- *Vlerësimin teknik, financiar dhe ligjor.*

AIE kryen këtë shqyrtim bazuar në opinionet e institucioneve mbështetëse, duke përfshirë ministritë përkatëse, komunat, institucionet përgjegjëse për ndihmën shtetërore dhe institucionet që rregullojnë sektorët ku propozohet investimi, me ndihmën e profesionistëve dhe ekspertëve të jashtëm, për të siguruar një vlerësim të plotë dhe profesional.

AIE shqyrton propozimet për investime strategjike brenda këtyre afateve:

- *Shqyrtimi paraprak: 60 ditë nga dorëzimi i një propozimi të plotë;*
- *Shqyrtimi përfundimtar: 90 ditë nga dorëzimi i një propozimi të plotë;*
- *Shqyrtimi përfundimtar me të dhëna shpesh: 60 ditë nga dorëzimi i plotë i të dhënave dhe dokumenteve të kërkuara.*

5.3. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Investitorët e huaj gëzojnë të drejtën për të zgjidhur mosmarrëveshjet që lidhen me investimet përmes procedurave të dakorduara. Sipas ligjit në fuqi, investitori ka fillimisht të drejtën të kërkojë ndihmë institucionale përmes konsultimeve, për të zgjidhur mosmarrëveshjet me institucionet publike ose ofruesit e shërbimeve publike. AIE ka rol lehtësues, duke ndihmuar palët në ecurinë e procesit të konsultimit.

Në rastet kur nuk ekziston një marrëveshje paraprake që përcakton procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, investitorët e huaj kanë mundësinë të zgjidhin konfliktet ose përmes gjykimeve në gjykatat vendore, ose duke u angazhuar në arbitrazh lokal ose ndërkombëtar.

5.3.1. Paneli ankimor dhe ankesa e investitorit

Paneli Ankimor i Investimeve është një organ i emëruar nga Qeveria, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të investitorëve. Investitori mund të parashtrojë ankesë pranë Panelit Ankimor kundër institucioneve publike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimit, me përjashtim ankesës ndaj vendimit të Këshillit.

Paneli Ankimor shqyrton ankesën, dëgjon palët sipas nevojës dhe nxjerr një rekomandim brenda nëntëdhjetë (90) ditëve. Institucionet publike janë të detyruara të njoftojnë Panelin për veprimet e ndërmarra ose të japin arsyet për moszbatimin e rekomandimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

5.3.2. Procedurat gjyqësore

Përveç mjeteve juridike të garantuara me Kushtetutë dhe ligj, investitori mund të iniciojë:

- *padi për kontest të investimit;*
- *padi për konflikt administrativ, përfshirë kontestimin e vendimeve specifike të këtij ligji.*

Në praktikë, shumë investitorë të huaj zgjedhin procedurën gjyqësore si mënyrën e tyre të preferuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kjo zakonisht përfshin nisjen e procedurave gjyqësore pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës. Për investitorët e huaj, kjo gjykatë ka një rëndësi të veçantë, pasi ligjërisht është detyruar të ketë një divizion të specializuar të njohur si “Divizioni për Kontestet e Investitorëve të Huaj”. Ky divizion trajton ekskluzivisht çështjet e iniciuara nga investitorët e huaj, duke pasqyruar rëndësinë që sistemi juridik i Kosovës i kushton trajtimit të posaçëm të kontesteve që lidhen me investimet e huaja brenda kuadrit ligjor të Kosovës.

Kjo qasje e veçantë ndaj trajtimit të investimeve të huaja ofron disa përparësi të rëndësishme. Në veçanti, ajo siguron që çështjet që përfshijnë investime të huaja të kenë prioritet në caktimin e seancave dhe në shqyrtimin gjyqësor. Si rezultat, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

përmes gjykatës karakterizohet nga efikasiteti dhe shpejtësia edhe më e madhe, një veçori kjo e favorizuar nga investitorët e huaj. Ekzistenca e Divizionit për Kontestet e Investitorëve të Huaj dëshmon për angazhimin e Kosovës për krijimin e një mjedisi të favorshëm për investitorët e huaj, duke nënvizuar rëndësinë e mbrojtjes së interesave të tyre dhe sigurimin që shqetësimet e tyre trajtohen në mënyrë të shpejtë dhe efektive përmes sistemit gjyqësor vendor.

Përkushtimi i Gjykatës Komerciale për zgjidhjen e shpejtë dhe efikase të mosmarrëveshjeve jo vetëm që përbën një përfitim për investitorët e huaj, por gjithashtu rrit reputacionin e Kosovës si destinacion që i jep përparësi nevojave dhe interesave të investitorëve të huaj. Ky kuadër ligjor nxit investimet e huaja dhe mbështet krijimin e një mjedisi biznesor të sigurt dhe të qëndrueshëm për bizneset vendore dhe ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

5.3.3. Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi

Republika e Kosovës dhe investitori mund të bien dakord që kontesti i investimit të zgjidhet përmes ndërmjetësimit ose arbitrazhit, sipas kushteve dhe rregullave të dakorduara paraprakisht. Këto procedura mund të zhvillohen në Kosovë ose në një shtet anëtar të BE-së që është palë e Konventës së Nju-Jorkut.

Marrëveshjet e ndërmjetësimit dhe vendimet e arbitrazhit njihen dhe zbatohen sipas ligjit në fuqi. Në mungesë të një marrëveshjeje të veçantë midis palëve, ligji i Republikës së Kosovës do të zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së investimit nga gjykata ose tribunali i arbitrazhit. Agjencia për Investime dhe Eksport (IEA) monitoron procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të investimit dhe jep rekomandime për masa parandaluese për të minimizuar konfliktet e mundshme

- Arbitrazhi

Kjo metodë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve shpesh preferohet për të shmangur procedurat gjyqësore, duke reduktuar vonesat dhe kostot, si dhe duke garantuar një zgjidhje të drejtë dhe efikase të mosmarrëveshjeve. Megjithëse klauzolat e arbitrazhit nuk përdoren shpesh në marrëveshjet vendore të bizneseve, klauzolat e arbitrazhit përfshihen më shpesh në marrëveshjet e lidhura nga palët e huaja.



Dispozitat e përgjithshme mbi arbitrazhin në Kosovë

Arbitrazhi në Kosovë rregullohet me Ligjin Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin. Ky ligj rregullon aspekte të ndryshme të procedurës së arbitrazhit, përfshirë përbërjen e Tribunalit të Arbitrazhit, kompetencën, zhvillimin e procedurës, nxjerrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre.

Marrëveshja e Arbitrazhit: Marrëveshja e arbitrazhit është një kontratë e shkruar ndërmjet dy ose më shumë palëve, me të cilën palët pajtohen që kontestet juridike t'i nënshtrohen arbitrazhit. Ajo mund të jetë pjesë përbërëse e një kontrate më të gjerë ose të lidhet si marrëveshje e ndarë dhe e pavarur.

Juridiksioni: Tribunali i arbitrazhit vendos për juridiksionin dhe vlefshmërinë e marrëveshjeve të arbitrazhit. Kundërshtimet lidhur me kompetencën duhet të ngritën që në fillim të procedurës.

Institucionet Vendore të Arbitrazhit: Përveç institucioneve ndërkombëtare të arbitrazhit, Kosova ofron edhe institucione vendore të arbitrazhit, siç janë: Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit i Odës Ekonomike të Kosovës dhe Qendra e Arbitrazhit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Ekzekutueshmëria: Vendimet e arbitrazhit janë të zbatueshme në të njëjtën masë si vendimet përfundimtare të gjykatës më të lartë në Kosovë.

Karakterit Detyrues: Vendimet e arbitrazhit konsiderohen përfundimtare dhe detyruese për të gjitha palët, përfshirë edhe Republikën e Kosovës. Imuniteti ligjor nuk mund të përdoret si pengesë për zbatimin e vendimit.

E drejta e zbatueshme: Mosmarrëveshjet mbi investimet rregullohen nga e drejta e zgjedhur nga palët me shkrim. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, zbatohen ligjet e Republikës së Kosovës.

Njohja dhe Zbatimi i Vendimeve të Arbitrazhit: Vendimet e arbitrazhit konsiderohen përfundimtare në Kosovë dhe kanë karakter detyrues. Megjithatë, për t'u zbatuar brenda Kosovës, ato duhet të shpallen të zbatueshme nga gjykata dhe, në disa raste, mund t'i nënshtrohen një procedure të njohjes nga gjykata. Procedura ndryshon në varësi të originës së vendimit. Nëse vendimi vjen nga një organ vendor i arbitrazhit, mjafton shpallja dhe ekzekutimi i tij nga gjykata. Ndërsa, në rastin e vendimeve të nxjerra nga institucione ndërkombëtare ose të huaja të arbitrazhit, përveç shpalljes së ekzekutueshmërisë, kërkohet edhe procedura e njohjes nga gjykata. Këto procedura zhvillohen në mënyrë të përsheptuar dhe janë në kompetencë të Gjykatës Komerciale.

Ky kuadër ligjor gjithëpërfshirës promovon një mjedis të favorshëm për investorët, duke siguruar trajtim efikas të kontesteve të investorëve të huaj dhe duke forcuar reputacionin e Republikës së Kosovës si destinacion që i jep prioritet investimeve të huaja dhe zhvillimit ekonomik.

5.4. MARRËVESHJET E TREGTISË SË LIRË DHE TRAKTATET TJERA

5.4.1. Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA)

Kosova është palë e Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) së bashku me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Moldavinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë.

CEFTA ka për qëllim promovimin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve përmes krijimit të një zone të tregtisë së lirë dhe investimeve në rajon përmes tregtisë dhe rregullave të drejta, të qarta, të qëndrueshme dhe të parashikueshme. Po ashtu, kjo marrëveshje ka për qëllim harmonizimin e kornizës rregullative të palëve nënshkruese me standardet e Bashkimit Evropian.

Sa i përket parimeve të përgjithshme të CEFTA-s mbi investimet, palët duhet të promovojnë sa më shumë që të jetë e mundur investimet e investorëve të palëve të tjera në territorin e tyre, të lejojnë këto investime në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare dhe të japin lejet dhe autorizimet e nevojshme në lidhje me to.



Çdo palë duhet të garantojë parimet e trajtimit të drejtë dhe të barabartë të investimeve dhe mosdiskriminimit në lidhje me investimet apo themelimin e ndërmarrjeve nga investitorët e palëve të tjera.

Objektivi themelor, si dhe arsyeja historike e ekzistencës së një marrëveshjeje të tillë është mobilizimi i përpjekjeve të përbashkëta të shteteve evropiane drejt integritetit dhe përgatitjes për funksionimin në një treg të lirë. Ky hap përgatitor është thelbësor pasi krijon rrugën që shtetet anëtare, përfshirë Kosovën të integrohen në mënyrë të qetë dhe graduale në tregun e Bashkimit Evropian në momentin e anëtarësimit të tyre.

5.4.2. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) është nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian në vitin 2015 dhe ka hyrë në fuqi në gjysmën e parë të vitit 2016. Në aspektin e marrëdhënieve ekonomike, kjo marrëveshje synon zhvillimin e tregtisë dhe investimeve, të cilat konsiderohen thelbësore për ristrukturimin dhe modernizimin ekonomik të Kosovës.

MSA përfshin angazhimin e të dyja palëve për të krijuar brenda 10 vitesh një zonë bilaterale të tregtisë së lirë. Ajo vendos një parim të mosdiskriminimit në lidhje me themelimin e bizneseve të BE-së në Kosovë, si dhe në mënyrë reciproke për bizneset kosovare në vendet anëtare të BE-së. Sipas kushteve të caktuara, një kompani e BE-së e themeluar në Kosovë mund të punësojë në Kosovë shtetas të BE-së ose të Kosovës. Në kuadër të MSA-së, palët duhet gjithashtu të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet direkte dhe themelimin e kompanive.

Marrëveshja përmban edhe dispozita specifike për promovimin dhe mbrojtjen e investimeve, sipas të cilave bashkëpunimi ndërmjet palëve synon krijimin e një klime të favorshme për investime private, si vendore ashtu edhe të huaja. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është përmirësimi i kornizës ligjore të Kosovës, me qëllim favorizimin dhe mbrojtjen e investimeve.

MSA parasheh objektivin që Kosova të negociojë me shtetet e tjera që kanë nënshkruar Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit me Bashkimin MSA parasheh objektivin që Kosova të negociojë me shtetet e tjera që

kanë nënshkruar Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, me synimin e lidhjes së marrëveshjeve dypalëshe për zgjerimin e bashkëpunimit, veçanërisht në fushën e krijimit të zonave të tregtisë së lirë, lëvizjes së punëtorëve, shërbimeve dhe kapitalit. Ashtu si edhe pjesëmarrja e Kosovës në Marrëveshjen CEFTA, objektivi kryesor i nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është përgatitja e Republikës së Kosovës për anëtarësim të ardhshëm në Bashkimin Evropian.

5.4.3. Marrëveshja për Tregti të Lirë me Republikën e Turqisë

Marrëveshja për Tregti të Lirë (MTL) ndërmjet Kosovës dhe Turqisë hyri në fuqi më 1 shtator 2019, duke shënuar marrëveshjen e parë dypalëshe të tregtisë së lirë që Republika e Kosovës ka lidhur me një shtet tjetër. Kjo marrëveshje përfaqëson një moment të rëndësishëm në politikën tregtare ndërkombëtare të Kosovës dhe synon promovimin e tregtisë dypalëshe përmes heqjes së barrierave tregtare, liberalizimit të qasjes në treg dhe krijimit të një kornize të parashikueshme dhe të sigurt për shkëmbimet tregtare ndërmjet dy vendeve.

Marrëveshja parashikon eliminimin e tarifave doganore për shumicën e produkteve industriale, si dhe koncesione të veçanta për produktet bujqësore. Rregullat e origjinës sigurojnë që vetëm mallrat e prodhuara në vendin eksportues të përfitojnë nga trajtimi preferencial.

Përtej tarifave doganore, MTL-ja përfshin edhe dispozita lidhur me standardet sanitare dhe fitosanitare, rregulloret teknike, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, masat antidumping dhe mekanizmat mbrojtës, duke lehtësuar tregtinë dhe njëkohësisht duke mbrojtur industritë vendore.

Që nga hyrja në fuqi, kjo marrëveshje ka kontribuar në forcimin e lidhjeve tregtare dhe investuese ndërmjet Kosovës dhe Turqisë, me Turqinë që është shndërruar në një nga partnerët kryesorë tregtarë dhe investitorë të Kosovës. Në tërësi, MTL-ja mbështet integrimin e Kosovës në ekonominë globale dhe krijon një bazë të qëndrueshme për bashkëpunim të mëtejshëm ekonomik ndërmjet dy vendeve.

5.4.4. Shoqata Evropiane për Tregti të Lirë

Tregtia dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA) ka filluar në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, dhe që nga ajo kohë ka shënuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2023, vëllimi i tregtisë arriti nivelin më të lartë deri më tani, duke kapur vlerën totale prej 176 milionë euro, ku eksportet e Kosovës drejt vendeve të EFTA-s arritën në 76 milionë euro, ndërsa importet nga këto vende në 99 milionë euro.

Më 22 janar 2025, pas më shumë se dy vjet e gjysmë negociatash, Kosova nënshkroi një marrëveshje gjithëpërfshirëse me EFTA-n. Me këtë marrëveshje, Kosova u bë vendi i parë në rajon që përfshin sektorin e shërbimeve në një marrëveshje të tregtisë së lirë me EFTA-n, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt liberalizimit të mëtejshëm ekonomik.

Eksportet kryesore të Kosovës drejt vendeve të EFTA-s përfshijnë mobilje, produkte plastike, hekur dhe çelik, si dhe produkte prej druri. Ndërkohë, importet nga vendet e EFTA-s përbëhen kryesisht nga automjete, produkte farmaceutike, produkte të duhanit dhe makineri.

Kjo marrëveshje krijon mundësi të konsiderueshme për investitorët dhe bizneset, duke ofruar lehtësira tregtare dhe përmirësim të qasjes në treg. Përfitimet kryesore përfshijnë:

Eksport pa tarifa doganore: Prodhuesit me bazë në Kosovë mund të eksportojnë produkte industriale dhe bujqësore në vendet e EFTA-s pa pagesë të doganave;

Qasje e përmirësuar në tregje: Rritje e qasjes së produkteve kosovare në tregjet e EFTA-s, veçanërisht në Zvicër, ku jeton një pjesë e konsiderueshme e diasporës kosovare;

Ulja e kostove të importit: Çmime më të ulëta për lëndët e para dhe mallrat e importuara nga vendet e EFTA-s;

Integrim ekonomik: Mbështetje për integrimin e Kosovës në ekonominë evropiane dhe globale;

Zhvillimi i sektorit të shërbimeve: Si vendi i parë i Ballkanit Perëndimor që përfshin shërbimet në këtë marrëveshje, Kosova synon të forcojë sektorin e shërbimeve, përfshirë tregtinë dhe investimet.

Në tërësi, kjo marrëveshje rrit ndjeshëm atraktivitetin e Kosovës si destinacion për investime, duke u ofruar bizneseve vendore dhe ndërkombëtare një mjedis konkurrues tregtar dhe qasje të përmirësuar në tregjet evropiane.

5.4.5. Heqja e taksës për mallrat nga SHBA


Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Vendimit Nr. 13/265, datë 01.08.2025, ka vendosur heqjen e tarifës doganore për mallrat me origjinë preferenciale nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Ky vendim përfaqëson një masë të njëanshme nga ana e Republikës së Kosovës dhe ka si qëllim lehtësimin e tregtisë, duke ofruar përfitime për operatorët ekonomikë dhe konsumatorët, si dhe forcimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare me SHBA-në.


Në mënyrë që këto mallra të përfitojnë nga ky trajtim favorizues, të njëjtat me rastin e importit duhet të shoqërohen me:

- *Certifikatë të vlefshme të origjinës preferenciale të lëshuar nga autoritetet amerikane;*
- *Deklarata për origjinën në faturë, në përputhje me ligjin në fuqi të të dyja vendeve.*

Të gjitha mallrat e importuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga data 01.08.2025, të cilat përmbushin kriteret për t'u trajtuar si mallra me origjinë preferenciale, por që në momentin e importit nuk kanë përfituar këtë trajtim, do t'u nënshtrohen procedurave për rimbursim të detyrimeve doganore, në përputhje me dispozitat në fuqi.



PROKURIMI PUBLIK



6. PROKURIMI

Kosova ka zhvilluar legjislacion dhe rregullore të plota në lidhje me prokurimin publik dhe siguron qasje, transparencë dhe drejtësi të procesit të prokurimit, veçanërisht përmes sistemit të saj të E-prokurimit.

Përveç prokurimit publik “tradicional”, ku shërbimet, punët ose mallrat blihet drejtpërdrejt nga Autoriteti Publik, Kosova ofron tani një mjedis ligjor dhe ekonomik të favorshëm për zhvillimin e Partneritetit Publik-Privat (“PPP”). PPP ka tendencë t’i japë zbatimin e tërë projektit një entiteti të vetëm. Duke hapur mundësi investimi dhe mobilizuar investime private, PPP shfaqet në shumë mënyra si një zgjidhje ekonomikisht efikase dhe e qëndrueshme.

6.1. PROKURIMI PUBLIK

Prokurimi publik i referohet procesit me të cilin autoritetet publike, si qeveria ose autoritetet lokale, blejnë punë, mallra ose shërbime nga kompanitë. Në Kosovë, e gjithë procedura e prokurimit publik zhvillohet online përmes sistemit të e-prokurimit. Republika e Kosovës filloi të aplikojë këtë sistem në prokurimin publik në mes të vitit 2016. Që nga 1 janari 2019, ka filluar aplikimi i plotë i sistemit të e-prokurimit për prokurimin publik.

Zbatimi i sistemit të e-prokurimit në Kosovë mund të konsiderohet një histori suksesi dhe reforma kryesore e prokurimit në vitet e fundit. Sistemi i e-prokurimit është plotësisht funksional dhe në përdorim me modulet kryesore të sistemit, si E-tenderimi, prokurimet qendrore, dhe moduli i administrimit të ankesave.

Operatorët ekonomikë mund të aplikojnë në një tender, të dorëzojnë një kërkesë për pjesëmarrje, ose çdo dokument tjetër të nevojshëm ose të lejuar për t’u paraqitur gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

Në Kosovë, prokurimi publik rregullohet me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji nr. 04/L-237, Ligji nr. 05/L-068 dhe Ligji nr. 05/L-092 (“Ligji për Prokurimin Publik”). Ligji për Prokurimin Publik është miratuar dhe ndryshuar me qëllim reformimin e prokurimit publik dhe sigurimin e përputhshmërisë së rregulloreve të Kosovës me Direktivat e BE-së.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, bazuar në përgjegjësitë dhe autorizimet e parashikuara nga Neni 87.2 (4) i Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji nr. 04/L-237, Ligji nr. 05/L-068 dhe Ligji nr. 05/L-092, ka formalizuar dhe shpallur aktet nënligjore:

- *Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, dhe*
- *Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik.*

Ligji për Prokurimin Publik synon të sigurojë përdorimin më efikas, ekonomik, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, burimeve publike dhe çdo fondi dhe burimi tjetër të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Ai gjithashtu synon të sigurojë integritetin dhe llogaridhënien e zyrtarëve publikë, shërbëtorëve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit.

Ky Ligj zbatohen për aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese (d.m.th. autoritete publike dhe organet e qeverisura nga ligji publik) dhe koncesionarët e punëve.

Sa i përket afatit brenda të cilit konsumatori ka të drejtën e tërheqjes, Ligji për Shërbimet e Shoqërisë së Informatike më parë caktoi një afat “të paktën” 7 ditë. Megjithatë, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit më vonë parashikoi një periudhë prej 14 ditësh.

Politika e Privatësisë: Kur bëhet blerje online, bizneset mbledhin të dhëna personale nga konsumatorët si: emri dhe mbiemri, adresa e dorëzimit të mallrave, numri i telefonit, llogaria bankare, shënime për kartën bankare, etj. Në këtë drejtim, bizneset duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshme mbi ligjshmërinë e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashikon gjoba deri në 40,000 euro

ose 2% deri 4% të xhiros së përgjithshme të vitit fiskal të mëparshëm, në përputhje me GDPR. Prandaj, bizneset duhet të përgatisin Politikën e Privatësisë në përputhje me dispozitat ligjore për të informuar konsumatorët mbi të dhënat personale të mbledhura, mënyrën e përpunimit, ligjshmërinë e përpunimit, të drejtën për fshirjen e këtyre të dhënave dhe të drejta të tjera të garantuara nga ligji (shih 13. Mbrojtja e të Dhënave).



Politika e Cookies: Ky dokument i rëndësishëm lidhet gjithashtu me mbrojtjen e të dhënave personale të konsumatorëve. Ndonjëherë përfshihet në Politikën e Privatësisë, por shpesh është një dokument i veçantë dhe i ndarë. Uebfaqet mbledhin cookies të vendosura nga përdoruesit gjatë aksesit dhe navigimit në uebfaq. Disa nga këto cookies janë thelbësore, ndërsa të tjerat janë alternative. Ato përdoren për të identifikuar më mirë përdoruesin si dhe për të kuptuar aksesin e tij për qëllime marketingu. Kur mblidhen të dhëna (cookies) nga përdoruesit, duhet të merret pëlqimi. Njoftimi për dhënien e pëlqimit duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm. Përdoruesve duhet t'u jepet mundësia të pranojnë vetëm cookies të caktuara (thelbësore) ose të gjitha cookies. Përdoruesit gjithashtu duhet të kenë opsionin për të mos dhënë pëlqim për mbledhjen e cookies.

11.2. SHËRBIMET E SHOQËRISË INFORMATIKE

Shërbimet e shoqërisë informatike janë çdo shërbim i ofruar për shpërblim, në distancë, me mjete elektronike dhe në kërkesë individuale të përfituesit të shërbimeve. Kjo përfshin, për shembull, shërbime si rrjetet sociale, shërbimet e rezervimit, shërbimet video me kërkesë, dhe aplikacionet e lojërave.

Kjo, për shembull, nuk përfshin:

- *shërbime të cilat, edhe pse mund të kërkojnë përdorimin e pajisjeve elektronike, nuk kryhen në distancë, si ekzaminimi ose trajtimi mjekësor, ATM-të, parkingjet;*
- *shërbime që nuk ofrohen përmes mjeteve elektronike, si shërbimet e ofruara nga telefoni ose faksi;*
- *shërbime që nuk ofrohen me kërkesë individuale, si transmetimi i radios ose televizionit, etj.*

Ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë në mënyrë të lehtë dhe të qasshme emrin, adresën, detajet (përfshirë email dhe URL), detajet e regjistrimit të biznesit dhe numrin e TVSH-së. Nëse aktiviteti i ofruesit është subjekt i autorizimit ose për profesione të rregulluara, kërkohet informacion shtesë, si autoriteti mbikëqyrës ose trupi ose institucioni profesional.

Të gjitha komunikimet tregtare pjesë e një shërbimi të shoqërisë informatike duhet të identifikohen qartë si të tilla. Duhet gjithashtu të identifikohet personi fizik ose juridik në emër të të cilit bëhet komunikimi tregtar, ofertat promovuese, konkurset ose lojërat dhe kushtet e tyre.

Sa i përket kontratave të lidhura me mjete elektronike, Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike specifikon gjithashtu se, përveç nëse palët që nuk janë konsumatorë bien dakord ndryshe, përfituesi duhet të informohet:

- *para lidhjes së kontratës mbi hapat teknikë për lidhjen e kontratës; regjistrimin eventua të kontratës nga ofruesi dhe aksesueshmërinë e saj; mjetet për identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve të shënimit para vendosjes së porosisë; gjuhët e ofruara për lidhjen e kontratës;*
- *nëse ekzistojnë, çdo kode të sjelljes të cilave ofruesi i përmbahet dhe mënyrën e konsultimit të tyre elektronikisht.*

Ky detyrim për informacion nuk zbatohet për kontrata të lidhura ekskluzivisht me shkëmbim të email-eve ose komunikimeve individuale. I njëjti ligj parashikon gjithashtu se termat e kontratës dhe kushtet e përgjithshme duhet të jenë në dispozicion në mënyrë që përfituesi të mund t'i ruajë dhe riprodhojë.

11.3. FATURIMI DHE PAGESA ELEKTRONIKE

Detajet që përfshihen në faturimin elektronik përcaktohen nga Ligji për Shoqërinë Informatike. Këto përfshijnë datën e lëshimit; një numër rendor; numrin e TVSH-së (nëse aplikohet); emrin dhe adresën e personit tatimpagues dhe të klientit; sasinë; çmimin; natyrën e mallrave ose shërbimeve; datën e furnizimit të mallrave ose përfundimit të shërbimit ose të pagesës paraprake (nëse një datë mund të përcaktohet dhe ndryshon nga data e faturës); shumën e tatueshme, çmimin njësi pa tatim, çdo zbritje jo e përfshirë në çmimin njësi, normën e TVSH-së të aplikuar; shumën e TVSH-së për t'u paguar. Nuk është e detyrueshme nënshkrimi i faturës.

Faturat mund të dërgohen në formë letre, ose, nëse klienti e pranon, përmes mjeteve elektronike. Autenticiteti dhe origjina e faturave të dërguara me mjete elektronike garantohen përmes nënshkrimit elektronik të avancuar ose të kualifikuar, ose, nëse kërkohet, përmes shkëmbimit elektronik të të dhënave (EDI – transferim elektronik nga kompjuteri te kompjuteri i informacionit duke përdorur një standard të rënë dakord). Nëse klienti pranon shprehimisht, faturat mund të dërgohen edhe përmes mjeteve elektronike të tjera.

11.4. IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK

Në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 korrik 2014 mbi Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besimit për Transaksionet Elektronike në Tregun e Brendshëm dhe në shfuqizim të Direktivës 1999/93/EC, Ligji i ri Nr. 08/L-022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besimit në Transaksionet Elektronike (“Ligji për Identifikimin Elektronik”) shfuqizoi dispozitat e Ligjit për Shoqërinë e Informacionit lidhur me përdorimin e nënshkrimit (Kapitulli XIII).

Ligji i ri për Identifikimin Elektronik e përcakton identifikimin elektronik si procesin e përdorimit të të dhënave të identifikimit të një personi në formë elektronike, të cilat përfaqësojnë në mënyrë unike ose një person fizik ose një person juridik, ose një person fizik si përfaqësues të një personi juridik.

Identifikimi elektronik duhet të nisë vetëm nga personi që i nënshtrohet identifikimit. Identifikimi elektronik përfshin mjete identifikimi të tilla si nënshkrimi elektronik dhe vula elektronike.

Ministria vepron si autoritet mbikëqyrës dhe është përgjegjëse për dhënien e statusit të ofruesve të shërbimeve të besueshme të kualifikuara, si dhe për mirëmbajtjen, përditësimin dhe publikimin elektronik të listës së këtyre ofruesve. Ministria shqyrton raportet e auditimit të dorëzuara nga Inspektori, mund të urdhërojë auditime të jashtëzakonshme kur është e nevojshme dhe bashkëpunon me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të siguruar përputhshmërinë dhe mbikëqyrjen efektive të ofruesve të shërbimeve të besueshme.

11.4.1.Nënshkrimi Elektronik

Nënshkrimi elektronik është e dhëna në formë elektronike që lidhet me ose është logjikisht i lidhur me të dhëna të tjera në formë elektronike dhe që përdoret nga nënshkruesi për të nënshkruar. Nënshkruesi është një person fizik.

Nënshkrimi elektronik nuk mund të përdoret nëse nuk lejohet nga një ligj i veçantë dhe:

- në fushën e së drejtës familjare dhe të së drejtës së trashëgimisë;
- në veprimet ligjore që kërkojnë legalizim publik, akt noterial ose autorizim gjyqësor;
- në veprimet ligjore lidhur me sigurimin për lirimin me kusht;

Nënshkrimet elektronike ndahen në të thjeshta, të avancuara dhe të kualifikuara.



Nënshkrimet elektronike të thjeshta nuk kërkojnë asnjë verifikim identifikimi dhe për këtë arsye ofrojnë një nivel të ulët verifikimi. Megjithatë, nënshkrimi elektronik i thjeshtë është i vlefshëm dhe i pranueshëm, dhe vlefshmëria ose pesha e provave nuk mund të mohohet vetëm sepse është në formë elektronike dhe nuk përmbush një standard më të lartë (nënshkrim elektronik i kualifikuar).

Nënshkrimi elektronik i avancuar duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- të lidhet në mënyrë unike me nënshkruesin;
- të jetë i aftë të identifikojë nënshkruesin;
- të përdorë të dhëna për krijimin e nënshkrimit elektronik, të cilat janë nën kontroll të vetëm të nënshkruesit;
- të lidhet me të dhënat që nënshkruan, në një mënyrë që mund të zbulojë çdo ndryshim të mëvonshëm në to.

Nënshkrimi elektronik i kualifikuar është një nënshkrim elektronik i avancuar që bazohet në një certifikatë të kualifikuar për nënshkrim elektronik dhe krijohet nga një pajisje e kualifikuar për krijimin e nënshkrimeve elektronike. Nënshkrimi elektronik i kualifikuar ka efektin juridik ekuivalent me një nënshkrim dorëshkrim. Ai përfaqëson nivelin më të lartë të sigurisë për nënshkrimet elektronike. Nënshkruesi ka kontrollin e vetëm mbi çelësat e përdorur për krijimin e nënshkrimit.

Certifikata e kualifikuar për nënshkrim elektronik duhet të lëshohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimeve të besimit. Ajo duhet të përmbajë:

- treguesin se është një certifikatë e kualifikuar;
- të dhënat mbi ofruesin e shërbimeve të besimit të kualifikuar dhe vendin e tij të regjistrimit;
- detajet e nënshkruesit, nëse përdoret një pseudonim, kjo duhet të specifikohet qartë;
- të dhënat e verifikimit të nënshkrimit elektronik që korrespondojnë me krijimin e nënshkrimit elektronik;
- informacionin që identifikon periudhën e vlefshmërisë së certifikatës;
- kod-identifikuesin e certifikatës së ofruesit të shërbimeve të besimit të kualifikuar;

- *nënshkrimin ose vulën elektronike të avancuar të ofruesit të shërbimeve të besimit të kualifikuar që e ka lëshuar dhe ku certifikata që mbështet vulën ose nënshkrimin është në dispozicion pa pagesë;*
- *vendndodhjen e shërbimeve që mund të përdoren për të pyetur mbi statusin e vlefshmërisë së certifikatës së kualifikuar;*
- *një tregues që të dhënat e krijimit të nënshkrimit elektronik lidhur me të dhënat e verifikimit të nënshkrimit elektronik ndodhen në një pajisje të kualifikuar për krijimin e nënshkrimeve elektronike.*

11.4.2. Vula Elektronike

Me vulë elektronike nënkuptohen të dhënat në formë elektronike, të cilat lidhen me ose janë logjikisht të lidhura me të dhëna të tjera në formë elektronike për të siguruar origjinën dhe integritetin e tyre. Një vulë elektronike mbështetet në të njëjtat mekanizma si nënshkrimi elektronik, megjithatë, ndryshe nga nënshkrimi elektronik, krijuesi i vulës mund të jetë vetëm një person juridik. Ashtu si nënshkrimet elektronike, vulat elektronike mund të jenë të thjeshta, të avancuara ose të kualifikuara.

Vula elektronike e thjeshtë është e vlefshme dhe e pranueshme, dhe vlefshmëria ose pesha e provave nuk mund të mohohet vetëm sepse është në formë elektronike dhe nuk përmbush një standard më të lartë (vulë elektronike e kualifikuar).

Vulat elektronike të avancuara duhet të përmbushin të njëjtat kërkesa si nënshkrimet elektronike të avancuara.

Vula elektronike e kualifikuar është një vulë elektronike e avancuar që bazohet në një certifikatë të kualifikuar për vulë elektronike dhe krijohet nga një pajisje e kualifikuar për krijimin e vulave elektronike. Ajo gëzon supozimin e integritetit të të dhënave dhe të saktësisë së origjinës së atyre të dhënave, me të cilat lidhet vula elektronike e kualifikuar. Një vulë elektronike e kualifikuar e lëshuar në një shtet anëtar të BE-së duhet të njihet si vulë elektronike e kualifikuar në Kosovë. Kërkesat për certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike janë të ngjashme me ato për certifikatat e kualifikuara për nënshkrime elektronike (shih më sipër).

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE



12. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Mbrojtja e të dhënave rregullohet në Kosovë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 06/L-082 (“Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave”), i cili hyri në fuqi më 13 shkurt 2019. Ky ligj përshtat Rregulloren (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 27 prillit 2016 (GDPR) për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Një ligj tjetër që përfshin dispozita lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale është Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (“Ligji për Komunikimet Elektronike”).

12.1. LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave zbaton për përpunimin e të dhënave personale nga organet publike dhe private dhe për përpunimin e të dhënave personale në zyrat diplomatike dhe konsullore, përfshirë çdo përfaqësi të Kosovës jashtë vendit.

Kontrollin e përgjithshëm mbi qëllimin dhe mjetet e përpunimit të të dhënave e ushtron përdoruesi i të dhënave (“kontrolluesi”). Kontrolluesi mund të jetë person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër.

Autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale është Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP). Ajo gjithashtu jep këshilla institucioneve publike dhe private dhe informon publikun mbi çështjet e mbrojtjes së të dhënave. Ligji nuk kërkon regjistrim të përpunimit të të dhënave personale të AIP. Megjithatë, AIP ka kompetencë të lëshojë dhe të tërheqë certifikimin për organizatat që përpunojnë të dhëna. AIP mund të vendosë gjithashtu gjoba ndaj kontrolluesit deri në 40,000 euro për shkelje të vogla ose 2–4% të xhiros vjetore të vitit paraprak për shkelje serioze.

Ligji përcakton kryesisht principet dhe kërkesat kryesore për përpunimin e të dhënave; të drejtat e subjekteve të të dhënave; detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave; dhe rregullat për transferimin ndërkombëtar të të dhënave.

12.1.1. Parimet dhe kërkesat kryesore

Ligji përcakton parimet kryesore që zbatohen në përpunimin e të dhënave personale:

- **Ligjshmëria, drejtësia dhe transparenca;**
- **Kufizimi** i mbledhjes së të dhënave për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime;
- **Minimalizimi:** Mbledhja dhe përpunimi vetëm i të dhënave të mjaftueshme dhe relevante;
- **Saktësia:** Të dhëna të sakta dhe të përditësuara. Nëse jo, të dhënat duhet të fshihen ose korrigjohen;
- **Ruajtja** e të dhënave vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur ose përpunuar;
- **Integriteti dhe konfidencialiteti** i përpunimit të të dhënave, përfshirë mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar ose i paligjshëm dhe kundër humbjes, shkatërrimit ose dëmtimit aksidental;
- **Përgjegjësia** e kontrolluesit për respektimin e këtyre parimeve.

Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e lirë për një ose më shumë qëllime të caktuara. Përpunimi i të dhënave të një fëmije nën 16 vjeç është i mundur vetëm nëse personi me përgjegjësi prindërore ka dhënë pëlqimin.

Përpunimi pa pëlqim mund të jetë i ligjshëm në raste të caktuara të përcaktuara nga ligji, si kur është i nevojshëm për zbatimin e një kontrate, për mbrojtjen e interesave jetësore, për detyra në interes publik, ose për interesa të ligjshme.

Subjekti i të dhënave mund të tërheqë pëlqimin në çdo kohë. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit bazuar në pëlqim para tërheqjes.

Pa pëlqim të shprehur, është e ndaluar përpunimi i:

- të dhënave që zbulojnë origjinën racore ose etnike, opinionet politike, besimet fetare ose filozofike, ose anëtarësimin në sindikata;
- të dhënave mbi jetën seksuale ose orientimin seksual;
- të dhënave gjenetike ose biometrike për qëllim identifikimi të personit;
- të dhënave mbi shëndetin;

Subjekti i të dhënave, megjithatë, mund të japë pëlqimin e tij të qartë për përpunimin e të dhënave të përmendura më sipër, përveç rasteve kur legjislacioni përkatës parashikon se ndalimi nuk mund të hiqet. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave gjithashtu përcakton përjashtime të tjera nga ky ndalim, si p.sh:

- Kur është e nevojshme në fushën e punësimit, sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale;
- Për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër fizik, kur subjekti i të dhënave është fizikisht ose ligjërish i paaftë për të dhënë pëlqimin;
- Brenda kufizimeve të caktuara, për organizatat jofitimprurëse;
- Nëse përpunimi është i nevojshëm për pretendime ligjore ose veprime gjyqësore;
- Për interes publik, arsye mjekësore dhe shëndetësore;
- Për qëllime arkivimi në interes publik, kërkime shkencore ose historike, ose për qëllime statistikore.

Edhe në rastet e përjashtimeve të përmendura më sipër, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave vendos kufizime për përpunimin, i cili, në veçanti, duhet të kryhet në përputhje me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave themelore të subjektit të të dhënave.

12.1.2. Të Drejtat e Subjektit të të Dhënave

- ***E drejta për informim***

Subjekti i të dhënave duhet të informohet në çdo rast kur të dhënat e tij personale përpunohen. Kjo vlen si në rastin kur të dhënat merren drejtpërdrejt nga individ, ashtu edhe kur merren nga burime të tjera.

Subjekti i të dhënave duhet të njoftohet për identitetin dhe kontaktin e kontrolluesit, të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave kur është e aplikueshme, qëllimin e përpunimit dhe bazën ligjore, palët që do t'i marrin të dhënat, si dhe për faktin nëse ato do të transferohen jashtë vendit.

Përveç informacionit të lartpërmendur, subjekti i të dhënave duhet të informohet edhe për kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave, të drejtën për të kërkuar qasje, përmirësim apo fshirje të së dhënave, të drejtën për të tërhequr pëlqimin, ekzistencën e vendimmarrjes automatike duke përfshirë profilizimin, dhe të drejtën për të paraqitur ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

- ***E drejta në qasje***

Në çdo rast, subjekti i të dhënave ka të drejtë të marrë konfirmim nëse të dhënat e tij po përpunohen apo jo dhe, nëse po, të ketë qasje në to dhe në disa informacione të tilla si:

- *qëllimi i përpunimit;*
- *identiteti dhe të dhënat e kontaktit të kontrolluesit dhe, nëse aplikohet, të dhënat e kontaktit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave;*
- *kategoritë e të dhënave;*
- *marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale;*
- *periudha e ruajtjes ose, të paktën, kriteret e përdorura për ta përcaktuar atë;*
- *ekzistenca e të drejtës për korrigjim, fshirje, kufizim dhe kundërshtim (shih më poshtë), si dhe e të drejtës për të paraqitur ankesë pranë AIP;*
- *në rast se kontrolluesi synon t'i transferojë të dhënat në një shtet të tretë ose organizatë ndërkombëtare, subjekti i të dhënave duhet të informohet për këtë dhe për të drejtat e tij që lidhen me transferimin;*
- *e drejta për të tërhequr pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale;*
- *ekzistenca e vendimmarrjes së automatizuar, përfshirë profilizimin, rëndësia dhe pasojat e parashikuara të saj.*

Nëse ekziston detyrim ligjor ose kontraktual për mbledhjen e të dhënave, subjekti i të dhënave nga i cili mblidhen këto informacione duhet të njoftohet për këto detyrime dhe pasojat e tyre.

Kur të dhënat nuk mblidhen drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi duhet ta informojë subjektin për burimin e të dhënave personale dhe, nëse aplikohet, nëse këto të dhëna vijnë nga burime të aksesueshme publikisht. Në këtë rast, e drejta për informim nuk zbatohet në disa situata, si: kur subjekti i të dhënave tashmë e ka informacionin; kur ofrimi i informacionit është i pamundur ose do të kërkonte një përpjekje joproporcionale (veçanërisht për qëllime arkivimi në interes publik, për qëllime shkencore, historike ose statistikore); ose kur mbi të dhënat ekziston një detyrim i ruajtjes së sekretit profesional.



- ***E drejta për korrigjim dhe fshirje***

Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë nga kontrolluesi korrigjimin e të dhënave personale të pasakta që lidhen me të, si dhe plotësimin e të dhënave të paplota, përfshirë përmes dhënies së një deklarate plotësuese.

Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë fshirjen e të dhënave të tij personale nëse ai tërheq pëlqimin. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave parashikon gjithashtu arsye të tjera për ushtrimin e së drejtës për fshirje, si p.sh.: kur të dhënat personale nuk janë më të nevojshme në raport me qëllimin e përpunimit; kur subjekti i të dhënave kundërshton përpunimin (shih më poshtë, e drejta për kundërshtim); kur të dhënat janë përpunuar në mënyrë të paligjshme; kur të dhënat duhet të fshihen për të përmbushur një detyrim ligjor, etj.

Megjithatë, e drejta për fshirje nuk zbatohet në disa raste, përfshirë kur përpunimi është i nevojshëm për ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes dhe informacionit, për përmbushjen e një detyrimi ligjor ose për interes publik, për arsye të shëndetit publik, për qëllime arkivimi në interes publik, ose për kërkesa ligjore.

- ***E drejta për kufizimin e përpunimit***

Si një alternativë ndaj fshirjes, subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë kufizimin e përpunimit të të dhënave të tij personale kur:

- *saktësia e të dhënave personale kontestohet nga subjekti i të dhënave;*
- *të dhënat janë përpunuar në mënyrë të paligjshme;*
- *kontrolluesi nuk ka më nevojë për të dhënat personale, por subjekti i të dhënave i kërkon ato për të ngritur, ushtruar ose mbrojtur një kërkesë ligjore;*
- *subjekti i të dhënave ka ushtruar të drejtën për kundërshtim (shih më poshtë), duke pritur verifikimin nëse arsyet legjitime të kontrolluesit mbizotërojnë mbi ato të subjektit të të dhënave.*

Nëse të dhënat janë të kufizuara, përveç ruajtjes së tyre, ato mund të përpunohen vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave; ose për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore; ose për mbrojtjen e të drejtave të një personi tjetër (fizik ose juridik); ose për arsye të rëndësishme të interesit publik.

- ***E drejta e transferimit të së dhënave***

Subjekti i të dhënave ka të drejtë të marrë të dhënat që ia ka dhënë kontrolluesit dhe t'i bartë ato te një tjetër kontrollues pa pengesë, kur përpunimi bazohet në pëlqim ose kontratë dhe kryhet në mënyrë të automatizuar.

- ***E drejta për të kundërshtuar përpunimin***

Individi mund të kundërshtojë përpunimin e të dhënave të tij në çdo kohë, veçanërisht kur përpunimi bëhet për qëllime të interesave legjitime ose marketingut. Nëse nuk ka baza më të forta që mbizotërojnë interesin e subjektit të së dhënave, kontrolluesi duhet të ndalojë përpunimin.

- *Vendimmarrja automatike dhe profilizimi*

Subjekti i të dhënave ka të drejtë të mos jetë subjekt i një vendimi të bazuar vetëm në përpunim të automatizuar, përfshirë profilizimin, kur ky vendim prodhon efekte në lidhje me të ose ndikon në mënyrë të ngjashme.

12.1.3.Detyrimet e Kontrolluesit dhe Përpunuesit të të Dhënave

- *Kontrolluesi*

Kontrolluesi i të dhënave (“kontrolluesi”) është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër i cili, vetëm ose së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.

Kontrolluesi duhet të zbatojë masa për të siguruar pajtueshmërinë e përpunimit me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave. Ai duhet të marrë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, si pseudonimizimi dhe minimizimi i të dhënave, si dhe të integrojë garancitë e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave.

Kontrolluesi duhet të zbatojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar që, si parim i përgjithshëm, të përpunohen vetëm të dhënat personale që janë të nevojshme për çdo qëllim specifik të përpunimit. Të dhënat personale nuk duhet të bëhen të aksesueshme për një numër të pacaktuar personash pa ndërhyrjen e individit.



Nëse kontrolluesi merr vesh për një shkelje të sigurisë së të dhënave personale, ai duhet, nëse është e mundur, brenda 72 orëve, të njoftojë Agjencinë për Informim dhe Privatësi, përveç rasteve kur shkelja nuk ka gjasa të paraqesë rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizikë.

Nëse shkelja e të dhënave ka gjasa të paraqesë një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi duhet të njoftojë subjektin e të dhënave pa vonesë të panevojshme, përveç rasteve kur:

- *kontrolluesi ka zbatuar masa mbrojtëse, në veçanti duke bërë që të dhënat të jenë të pakuptueshme, siç është enkriptimi;*
- *kontrolluesi ka marrë masa për të siguruar që rreziku nuk ka më gjasa të materializohet;*
- *do të përfshinte një përpjekje joproporcionale, ku një njoftim publik do të ishte i mjaftueshëm për të siguruar informimin efektiv të subjekteve të të dhënave.*

Nëse përpunimi kryhet nga një përpunues, kontrolluesi duhet të përdorë vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për zbatimin e masave që sigurojnë pajtueshmërinë e përpunimit me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave dhe mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave.

• **Përpunuesi**

Përpunuesi i të dhënave (“përpunuesi”) është person fizik ose juridik, nga sektori publik ose privat, i cili përpunon të dhëna personale për dhe në emër të kontrolluesit të të dhënave.

Përpunuesi duhet të emërohet me një marrëveshje detyruese me kontrolluesin, e cila përcakton se përpunuesi duhet të:

- *veprojë vetëm sipas udhëzimeve të dokumentuara të kontrolluesit;*
- *vendosë detyrime konfidencialiteti për të gjithë personelin që përpunon të dhënat përkatëse;*
- *sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale që përpunon;*
- *respektojë rregullat që lidhen me emërimin e nën-përpunuesve (shih më poshtë);*
- *zbatojë masa për të ndihmuar kontrolluesin në përmbushjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave;*

¹⁴ sipas zgjedhjes së kontrolluesit, në përfundim të shërbimit t'i fshijë ose t'ia kthejë të gjitha të dhënat personale kontrolluesit dhe të fshijë kopjet ekzistuese (përveç rasteve kur Ligji për Arkivat kërkon ruajtjen e të dhënave);

¹⁵ i sigurojë kontrolluesit të gjitha informacionet e nevojshme për të dëshmuar pajtueshmërinë me detyrimet e mësipërme dhe të lejojë e të kontribuojë në auditimet e kryera nga kontrolluesi ose një auditor tjetër i mandatuar nga kontrolluesi.

Përpunuesi mund të veprojë vetëm brenda autorizimeve të dhëna nga kontrolluesi dhe nuk ka të drejtë të përpunojë të dhëna personale për qëllime të tjera.

Përpunuesi duhet të njoftojë kontrolluesin pa vonesë të panevojshme për çdo shkelje të sigurisë së të dhënave personale.

Përpunuesi nuk mund të angazhojë një përpunues tjetër (nën-përpunues) pa autorizim paraprak me shkrim të kontrolluesit, i cili mund të jetë specifik ose i përgjithshëm. Në rastin e autorizimit të përgjithshëm, përpunuesi duhet ta informojë kontrolluesin për çdo ndryshim të synuar që lidhet me shtimin ose zëvendësimin e përpunuesve të tjerë, duke i dhënë kontrolluesit mundësinë të kundërshtojë këto ndryshime. Në rastin e autorizimit specifik, detyrimet që zbatohen për përpunuesin zbatohen edhe për nën-përpunuesin, por përpunuesi fillestar mbetet plotësisht përgjegjës ndaj kontrolluesit.

Përpunuesit dhe, nëse është e aplikueshme, përfaqësuesit e tyre, duhet të mbajnë regjistra të aktiviteteve të përpunimit të kryera në emër të kontrolluesit.

Në rast mosmarrëveshjeje mes kontrolluesit dhe përpunuesit, përpunuesi, me kërkesë të kontrolluesit, duhet t'ia kthejë të gjitha të dhënat kontrolluesit, pa pasur asnjë të drejtë për të mbajtur kopje ose për t'i përpunuar ato më tej.

- **Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave (ZMD)**

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave (ZMD) është një figurë kyçe në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. Emërimi i ZMD-së nuk varet vetëm nga madhësia e organizatës, por nga natyra dhe intensiteti i përpunimit të të dhënave personale, sidomos kur bëhet fjalë për përpunime të ndjeshme ose të shkallëzuara, që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi të drejtat dhe liritë e individëve.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP) në Kosovë, kontrolluesi dhe përpunuesi caktojnë një ZMD në çdo rast, në qoftë se:

- *Përpunimi kryhet nga një organ publik (përjashtim bëjnë gjykatat që veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore);*
- *Aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga veprimet përpunuese që për shkak të natyrës, objektit apo qëllimit të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjektit të të dhënave; ose*
- *Aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga përpunimi në shkallë të gjerë të kategorive të veçanta të të dhënave dhe të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale.*

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave duhet të operojë në mënyrë të pavarur brenda organizatës. Ai ka përgjegjësinë kryesore për:

- *Informimin dhe këshillimin e kontrolluesit dhe përpunuesit dhe të punësuarve të tyre, që janë të përfshirë në sistemin e përpunimit të dhënave, në lidhje me detyrimet e tyre në raport me mbrojtjen e të dhënave;*
- *Dhënien e këshillave, sipas nevojës, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën;*
- *Bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), duke qenë pika kryesore e kontaktit.*

Një ZMD duhet të ketë njohuri të thella në fushën e mbrojtjes së të dhënave, ligjit dhe praktikave të privatësisë, si dhe një kuptim të mirë teknik për mënyrën se si trajtohen të dhënat në organizatë. Kualifikimet kryesore përfshijnë:

- *Ekspertizë ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtave të njeriut;*
- *Njohuri teknike mbi sigurinë e informacionit dhe menaxhimin e rrezikut;*
- *Aftësi të mira komunikuese dhe trajnim të stafit;*
- *Përvojë praktike në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të privatësisë, s.p.sh. i GDPR.*

Organizatat mund të zgjedhin një punonjës të brendshëm ose një profesionist të jashtëm për këtë rol, në varësi të madhësisë dhe nevojave të tyre.

Ligji kërkon që emërimi i ZMD-së të njoftohet pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi në Kosovë. Ky njoftim:

- *Siguron transparencë lidhur me personat përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave në organizata;*
 - *Lehtëson komunikimin midis AIP-së dhe ZMD-së;*
 - *Përmban të dhëna kontaktuese dhe informacione të tjera relevante për funksionimin efektiv të ZMD-së.*
- **Përfaqësuesit e kontrolluesve ose përpunuesve që nuk janë të vendosur në Kosovë**

Nëse kontrolluesi ose përpunuesi nuk është i vendosur në Kosovë, ai duhet të caktojë me shkrim një përfaqësues në Kosovë. Megjithatë, ky detyrim nuk zbatohet në disa raste, si p.sh. për përpunimin në shkallë të vogël që nuk përfshin të dhëna personale të ndaluara, si dhe për autoritetet ose organet publike.

Përfaqësuesi duhet të ketë mandat nga kontrolluesi ose përpunuesi për t'u kontaktuar, krahas ose në vend të kontrolluesit apo përpunuesit.

- ***Siguria e të dhënave personale***

Për të arritur një nivel të përshtatshëm sigurie që garanton mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave, kontrolluesi ose përpunuesi mund të përdorë:

- *pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale;*
- *rishikime të vazhdueshme të sigurisë së sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;*
- *aftësi për redundancë dhe kopje rezervë (backup);*
- *teste, vlerësime dhe shqyrtime të rregullta të sigurisë.*

Duhet të merren parasysh, veçanërisht, rreziqet që mund të rezultojnë nga shkatërrimi, humbja, ndryshimi, zbulimi i paautorizuar ose qasja e paautorizuar aksidentale apo e paligjshme në të dhënat personale.

12.1.4. Transferimi Ndërkombëtar i të Dhënave

Transferimi në vende të tjera ose organizata ndërkombëtare i të dhënave personale që përpunohen ose synohen të përpunohen pas transferimit mund të bëhet vetëm nëse vendi ose organizata ndërkombëtare në fjalë siguron një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave. Lista e këtyre vendeve përcaktohet nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Megjithatë, Agjencia për Informim dhe Privatësi mund të autorizojë transferimin ose zbulimin e të dhënave personale në një vend ose organizatë ndërkombëtare që nuk siguron nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, nëse:

- *kjo parashihet nga një ligj tjetër ose traktat ndërkombëtar detyrues;*
- *subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose të saj;*
- *transferimi është i nevojshëm për përmbushjen ose zbatimin e një kontrate ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit, ose të një kontrate të lidhur në interes të subjektit të të dhënave;*
- *transferimi është i nevojshëm për interes publik, për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave, për themelimin, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore;*
- *transferimi bëhet nga një regjistër publik;*

■ kontrolluesi i të dhënave ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve, duke përfshirë ushtrimin e të drejtave të ofruara.

12.1.5. Ndëshkimet dhe gjobat

Transferimi në vende të tjera ose organizata ndërkombëtare i të dhënave personale që përpunohen ose synohen të përpunohen pas transferimit mund të bëhet vetëm nëse vendi ose organizata ndërkombëtare në fjalë siguron një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave. Lista e këtyre vendeve përcaktohet nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Megjithatë, Agjencia për Informim dhe Privatësi mund të autorizojë transferimin ose zbulimin e të dhënave personale në një vend ose organizatë ndërkombëtare që nuk siguron nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave, nëse:

- kjo parashihet nga një ligj tjetër ose traktat ndërkombëtar detyrues;*
- subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose të saj;*
- transferimi është i nevojshëm për përmbushjen ose zbatimin e një kontrate ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit, ose të një kontrate të lidhur në interes të subjektit të të dhënave;*
- transferimi është i nevojshëm për interes publik, për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave, për themelimin, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore;*
- transferimi bëhet nga një regjistër publik;*
- kontrolluesi i të dhënave ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve, duke përfshirë ushtrimin e të drejtave të ofruara.*

12.2.UDHËZUES PRAKTIK: SI TË FILLONI ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË BIZNESIN TUAJ

Ky kapitull është një përmbledhje e hapave kryesorë që çdo organizatë duhet t'i ketë parasysh, duke ofruar këshilla konkrete për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe mbrojtjen e të dhënave të subjekteve të të dhënave personale.

1. Vlerësoni gjendjen aktuale të përpunimit/kontrollimit të të dhënave!

Filloni duke bërë një inventar të të dhënave që grumbulloni dhe përpunoni dhe përcaktoni cilat janë të dhëna personale, të dhëna të ndjeshme dhe të dhëna që lidhen me monitorim ose analiza të avancuara.

Ky hap është i domosdoshëm për të kuptuar masën e përputhshmërisë me Ligjin dhe për të identifikuar rreziqet kryesore.

2. Emëroni ose kontraktoni një person përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave dhe, kur kërkohet, angazhoni Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave (ZMD)!

Për çdo organizatë, është e rëndësishme të ketë një person të përgjegjshëm brenda strukturës që monitoron përputhshmërinë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky person mund të jetë një punonjës i brendshëm ose një profesionist i jashtëm, i cili siguron se procedurat e përpunimit të të dhënave ndiqen korrekt, stafi trajnohet, dhe regjistrat e përpunimit mbahen në mënyrë të rregullt.

Në rast se aktivitetet tuaja përfshijnë përpunime të ndjeshme ose të shkallëzuara, ose nëse jeni një institucion publik, është e detyrueshme të caktoni edhe një ZMD. ZMD-ja vepron si pika kryesore për këshillim ligjor dhe teknologjik dhe është përgjegjës për komunikimin me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP). Sigurohuni që emërimi i ZMD-së të njoftohet pranë AIP-së për transparencë dhe funksionim efektiv.

3. Krijoni dhe mbani regjistrat e përpunimit!

Sipas nenit 39 të LMDHP-së, çdo aktivitet përpunimi duhet të dokumentohet: qëllimi, kategoritë e të dhënave, pranuesit, afatet e ruajtjes dhe masat e sigurisë. Për bizneset, është e dobishme të përdorin një formular standard për çdo aktivitet, të mbajnë regjistrat në një vend të qëndruar dhe t'i përditësojnë rregullisht sipas ndryshimeve në proceset ose partnerët që përpunojnë të dhëna.

Një praktikë e tillë ju ndihmon për të demonstruar përputhshmërinë me ligjin, për të identifikuar rreziqet dhe për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave personale brenda organizatës.

4. Përpiloni politika dhe procedura të brendshme!

Hartoni politika për mbrojtjen e të dhënave, procedura për trajtimin e kërkesave të subjekteve të të dhënave, si dhe për menaxhimin e shkeljeve si dhe sigurohuni që stafi të jetë i informuar dhe i trajnuar mbi këto politika.

5. Kryeni vlerësim të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave!

Kur aktivitetet tuaja përpunojnë të dhëna që paraqesin rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e individëve, bëni një Vlerësim të Ndikimit (DPIA). Për bizneset, kjo do të thotë të identifikoni rreziqet, të dokumentoni masat që merrni për t'i minimizuar ato dhe të përgatiteni për çdo inspektim ose kërkesë nga AIP-ja.

Ky hap ndihmon të shmangni shkeljet serioze dhe të tregoni përkushtim ndaj mbrojtjes së të dhënave.

6. Merrni masat e duhura të sigurisë!

Zbatoni masa teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat: enkriptim, pseudonimizim, kontroll qasje, rikuperim të të dhënave në rast incidenti dhe testim të rregullt të sistemit të sigurisë. Kjo minimizon rreziqet dhe demonstroi përputhshmëri me LMDHP-në.

7. Krijoni një plan për rastet e shkeljes së të dhënave!

Hartoni procedura për njoftimin e shkeljeve, duke përcaktuar se si dhe kur do të informohet AIP-ja dhe, kur është e nevojshme, subjekti i të dhënave. Mbani dokumentacion të plotë për çdo incident për të siguruar gjurmueshmëri dhe përgjegjësi.

8. Monitoroni dhe përmirësohuni vazhdimisht!

Kontrolloni rregullisht përputhshmërinë, përmirësoni proceset dhe trajtoni stafin. Kjo siguron mbrojtje të dhënash, minimizon rreziqet dhe ndërton një kulturë të respektit për privatësinë brenda organizatës.

9. Konsultimi me ekspertë!

Në rast paqartësish ligjore ose teknike, kërkoni ndihmë nga ZMD-ja, avokatë apo konsulentë të specializuar. Parandalimi i gabimeve është më i thjeshtë se zgjidhja e shkeljeve.

Ndërmarrja e të gjithë këtyre veprimeve/masave mund të mos jetë e nevojshme në rastin tënd, andaj mund të filloni me konsultimin me ekspertë që nga fillimit, kështu mund të mënjanoni kostot e larta të ndërmarrjes së veprimeve të panevojshme, mënjanoni gjokat eventuale si dhe në mënyrën më të saktë e shpejtë do të arrini që të siguroheni që veprimtarinë tuaj po e ushtroni në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Fillimi i përputhshmërisë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të duket sfidues, por një qasje e strukturuar dhe praktike e bën procesin të menaxhueshëm. Çdo hap që ndërmerrni, jo vetëm që minimizon rrezikun ligjor, por gjithashtu forcon besimin e klientëve dhe partnerëve të biznesit.

Hapi i parë është gjithmonë më i rëndësishmi, filloni tani, dhe ndërtoni një sistem të besueshëm dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

12.3. SANKSIONET DHE GJOBAT NË RASTET E SHKELJEVE TË TË DHËNAVE PERSONALE

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk është çështje zgjedhjeje apo etike, por një obligim i detyrueshëm ligjor që imponon përgjegjësi të drejtpërdrejtë dhe sanksione serioze ndaj çdo shkelësi.

Ligji i ka dhënë Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) kompetenca të plota për të hetuar, urdhëruar masa korrigjuese dhe vendosur gjoka administrative kundër kontrolluesve dhe përpunuesve që nuk i zbatojnë detyrimet ligjore.

Shkeljet mund të sjellin pasoja financiare të konsiderueshme, dëmtim të reputacionit dhe humbje besimi nga klientët. Njohja e këtyre masave nuk ka të bëjë vetëm me shmangien e ndëshkimeve, por edhe me ndërtimin e një praktike të qëndrueshme dhe të besueshme të përpunimit të të dhënave.

12.3.1.Kompetencat e AIP

Agjencia, sipas detyrës zyrtare apo në bazë të ankesës, mund të kryejë inspektime dhe kontrolle, për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave. Duke vepruar kështu, Agjencia:

- 1. Mbikëqyrë ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale;**
- 2. Mbikëqyrë përshtatshmërinë e procedurave dhe masave që janë ndërmarrë për sigurinë e të dhënave personale në pajtim me ligjin;**
- 3. Mbikëqyrë dhe vepron në lidhje me: regjistrat e aktiviteteve të përpunimit; njoftimin e shkeljeve të të dhënave; vlerësimin e ndikimit të mbrojtjes së të dhënave; zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave; kodet e sjelljeve; mekanizmat e certifikimit; dhe regjistrimet e zbulimit të të dhënave të marrësve.**

Duhet pasur të qartë se gjatë kontrollit, Agjencia (zyrtarët e inspektimit) kanë të drejtë që të kontrollojnë dhe konfiskojë çdo dokumentacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave, që të kontrollojnë përmbajtjen e sistemeve të dosjeve, kontrollojnë e konfiskojnë dokumentacionin që rregullon sigurinë e të dhënave, kontrollojnë ndërtesat, verifikojnë masat dhe procedurat që kanë për qëllim të sigurojnë të dhënat personale etj.

Duke vlerësuar rezultatet e kontrolleve, Agjencia ka të tagër që të:

- Të urdhërojë korrigjimin e parregullsive (p.sh., fshirjen, anonimizimin ose bllokimin e të dhënave);
- Të kufizojë ose ndalojë përkohësisht përpunimin e të dhënave;
- Të zbatojë të drejtat e subjekteve të të dhënave;
- Të vendosë gjoba;
- Të japë paralajmërime ose këshilla për shkelje të vogla.

12.3.2.Gjobat administrative

Ndonëse, nuk janë masat e vetme që Agjencia mund të shqiptojë ndaj shkelësve të dispozitave të LMDHP-së, gjobat janë masa më e rëndësishme në kuptim të implikimeve që ka ndaj përpunuesve dhe kontrolluesve, pra atyre financiare. Ligji, për të siguruar që gjobat do

të arrijnë efektin e tyre mirëpo edhe për tu siguruar që përpunuesve dhe kontrolluesve do tu vihen përsipër gjoba të përballueshme, ka përcaktuar kritere të qarta që Agjencia duhet t'i respektojë në momentet e përcaktimit të gjobave. Pra, Agjencia, për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, vendosë gjoba kundërvajtëse, duke marrë parasysh kritere si:

- *Natyren, rëndësinë, kohëzgjatjen e shkeljes, duke marrë parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e përpunimit përkatës, si dhe numrin e subjekteve të të dhënave të prekura dhe nivelin e dëmit të shkaktuar;*
- *Karakterit të qëllimshëm dhe mospërfillës të shkeljes;*
- *Masat e marra nga kontrolluesi ose përpunuesi për të lehtësuar dëmin e pësuar;*
- *Shkallën e përgjegjësisë së kontrolluesit ose përpunuesit përkitazi me masat teknike dhe organizative të zbatuara nga ata;*
- *Shkeljet e mëparshme të kontrolluesit dhe përpunuesit;*
- *Shkallën e bashkëpunimit me Agjencinë;*
- *Kategoritë e të dhënave personale të prekura; etj.*

Ligji parasheh gjoba:

- *Deri në 40,000 €: përpunim i paligjshëm i të dhënave, mbrojtje e pamjaftueshme, shkelje që përfshijnë vëzhgimin me kamerë ose të dhënat biometrike, ose mosrespektim i mbikëqyrjes nga DPO.*
- *Deri në 12,000 €: shkelje të vëzhgimit me kamerë në ndërtesat me apartamente.*
- *Deri në 10,000 €: shkelje të rregullave të marketingut të drejtpërdrejtë ose dispozitave të përgjithshme të vëzhgimit me kamerë.*
- *Deri në 8,000 €: shkelje që lidhen me të dhënat e aksesit në ndërtesa ose mbikëqyrjen nga DPO.*
- *Deri në 5,000 €: shkelje në lidhje me ndërlidhjen e sistemeve të dosjeve.*

Nëse Agjencia konstaton një shkelje të rëndë dhe të përhapur të të dhënave personale, ajo mund të shqiptojë gjoba nga njëzet mijë (20,000) deri në dyzet mijë (40,000) euro.

Për kompanitë dhe ndërmarrjet, gjoba mund të arrijë nga 2% deri në 4% të qarkullimit të përgjithshëm vjetor të vitit financiar paraparak, në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 27 prill 2016, mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të tyre.

12.4. LIGJI PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (“Ligji për Komunikimet Elektronike”) përfshin dispozita specifike lidhur me përpunimin e të dhënave personale.

Për shembull, lidhur me konfidencialitetin e komunikimeve, mund të theksohen dy dispozitat e mëposhtme:

- *Përdorimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike për të ruajtur informacione ose për të aksesuar informacione të ruajtura në pajisjet terminale të një abonenti ose përdoruesi lejohet vetëm nëse abonenti ose përdoruesi i përfshirë informohet qartë dhe në mënyrë të plotë për qëllimet e përpunimit dhe i ofrohet e drejta për të refuzuar një përpunim të tillë nga kontrolluesi i të dhënave;*
- *Ndërmarrësit duhet të marrin masa në sistemet e komunikimeve elektronike dhe sistemet e përpunimit të të dhënave për të ruajtur sekretin e komunikimeve elektronike dhe të dhënave personale, si dhe për të ndaluar aksesin e paautorizuar në këto sisteme.*

Ndër dispozitat e tjera, Ligji për Komunikimet Elektronike përcakton gjithashtu parimet e mëposhtme:

- *Fshirja e të dhënave të trafikut kur nuk janë më të nevojshme për qëllimin e transmetimit të komunikimeve;*
- *Informimi mbi llojet e të dhënave të trafikut që përpunohen dhe kohëzgjatjen e këtij përpunimi;*
- *Përpunimi për qëllimin e marketingut të shërbimeve të komunikimeve elektronike vetëm për kohën e nevojshme për këtë qëllim dhe mundësia që përdoruesi ose abonenti të tërheqë pëlqimin e tij ose të saj në çdo kohë;*
- *Informimi i abonentit ose përdoruesit mbi llojet e të dhënave të trafikut që përpunohen dhe kohëzgjatjen e përpunimit;*
- *Informimi i përdoruesve ose abonentëve, para dhënies së pëlqimit, mbi llojin e të dhënave të vendndodhjes që përpunohen dhe nëse të dhënat do të transferohen te një palë e tretë;*
- *Mundësia që përdoruesi ose abonenti të tërheqë pëlqimin e tij ose të saj për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes në çdo kohë.*

E DREJTA E MJEDISIT



13. E DREJTA E MJEDISIT

Për të zbatuar Standardet e BE-së dhe dispozitat lidhur me mjedisin të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Kosova ka miratuar një numër të madh ligjesh dhe rregullore mjedisore. Parimet kryesore të Mbrojtjes së Mjedisit janë vendosur në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Këto parime janë të përfshira gjithashtu në ligje të tjera që rregullojnë fushën e ligjit mjedisor. Disa nga këto parime janë:

1. *Parimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm;*
2. *Parimi i Integritimit në Mbrojtjen e Mjedisit;*
3. *Parimi i Parandalimit dhe Kujdesit;*
4. *Parimi i Harmonizimit Gradual me Standardet e BE-së;*
5. *Parimi i Përputhshmërisë me Ligjin e BE-së;*
6. *Parimi “Ndotësi Paguej”;*
7. *Parimi i Qasjes Publike në Informacion, etj.*

Sipas Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit është organi shtetëror që kryen, në nivel qendror dhe lokal, inspektimin mjedisor; në mënyrë që të sigurojë respektimin e normave dhe standardeve të legjislacionit mjedisor dhe zbatimin e tyre. Inspektorati ka kompetencë për të shqiptuar gjoja dhe për të iniciuar procedura penale për shkelje të ligjeve mjedisore.

Nga të gjitha detyrimet mjedisore që zbatohen gjatë themelimit të një biznesi ose projekti industrial, është e rëndësishme të theksohet sistemi i licencimit: Kosova ka zhvilluar një set të plotë mjetesh për menaxhimin mjedisor bazuar në licencimin mjedisor dhe të drejtën mbi ujin.

13.1. LEJET MJEDISORE

Projektet si projektet infrastrukturore dhe industriale, projektet e ndërtimit, minierat, bujqësia, energjia, pyjet dhe projektet ujore kërkojnë leje specifike administrative mjedisore.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) lëshon leje mjedisore, pëlqime mjedisore, licenca të integruara dhe autorizime mjedisore. Komunat janë përgjegjëse për lëshimin e lejeve mjedisore komunale.

13.1.1. Pëlqimi Mjedisor

Pëlqimi mjedisor lëshohet nga MMPH si kusht paraprak për zbatimin e një projekti. Lëshimi i lejes së ndërtimit ose çdo leje tjetër në lidhje me projekte që i nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) është i kushtëzuar me pëlqimin mjedisor. Për të marrë pëlqimin mjedisor, aplikanti duhet të dorëzojë një raport të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) te MMPH.

Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM) do të shqyrtojë pasojat mjedisore të një projekti ose propozimi zhvillimor. Sipas rregullave të Kosovës, ai duhet të kryhet për të gjitha projektet që mund të shkaktojnë ndotje të madhe mjedisore ose të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut. Ai mbulon projektet në industri, miniera, energji, trafik, turizëm, bujqësi, pyje, menaxhim të ujit dhe aktivitete komunale, si dhe të gjitha projektet e planifikuara mbi pasuritë natyrore të mbrojtura dhe vlerat e mbrojtura mjedisore, si dhe në rrethinën e vlerave të mbrojtura kulturore. Pa Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor, ekzekutimi i projektit nuk mund të fillojë.

Procedura për VNM përshkruhet në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor, i cili shfuqizon legjislacionin e mëparshëm në këtë çështje. Shqyrtimi i aplikimeve për VNM bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor.

Ligji i ri ofron një listë të gjerë të projekteve që janë detyrimisht subjekt i procedurave të VNM, si dhe të projekteve që shqyrtohen rast pas rasti. Për sa i përket të fundit, për të përcaktuar nëse një projekt mund t'i nënshtrohet VNM, aplikanti duhet të japë informacion mbi karakteristikat e projektit, pasojat e mundshme për mjedisin, dhe masat e parashikuara për të shmangur ose parandaluar pasojat negative mjedisore.

Ndëshkimet sipas Ligjit Nr. 08/L-181 përfshijnë gjoba nga 20.000 deri në 40.000 euro për person juridik, dhe nga 1.000 deri në 4.000 euro për personin fizik përgjegjës të personit juridik, veçanërisht në rast se është nisur projekti pa kryer VNM, nëse janë dorëzuar të dhëna, deklaratat, dokumente ose informacione të rreme, ose në rast të mos-plotësimit të obligimeve për masat e mbrojtjes të parashikuara në raportin e VNM.

13.1.2. Leja Mjedisore

Fillimi i funksionimit të objekteve të ndërtuara, instalimeve dhe makinerive që kanë qenë subjekt i VNM është i kushtëzuar nga marrja paraprake e një Leje Mjedisore nga MMPHI. Një Leje Mjedisore për funksionim jepet për një periudhë pesëvjeçare dhe gjatë procedurës së aplikimit dhe periudhës së provës për miratimin teknik, por jo më vonë se gjashtë muaj pas fillimit të funksionimit.

Procedura (aplikimi, shqyrtimi dhe vendimi) për lejet mjedisore është përshkruar në UA Nr. 04/2022-MMPHI për Lejen Mjedisore. Aplikimet shqyrtohen nga Komisioni për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisore.

13.1.3. Leja e Integruar

Funksionimi i impianteve dhe aktiviteteve që mund të kenë ndikim negativ në shëndetin e njeriut dhe mjedisin kërkon një leje të integruar për të parandaluar dhe kontrolluar ndotjen mjedisore.

Procedura (aplikimi, shqyrtimi dhe vendimi) për lejet e integruara përshkruhet në Ligjin Nr. 08s/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes. Sipas Ligjit, kërkesa për leje përfshin: të gjitha masat e përshtatshme për parandalimin e ndotjes; përdorimin e teknikave më të mira të disponueshme, standardet e mira në menaxhimin e mbetjeve, përdorimin e ujit dhe energjisë; parandalimin e aksidenteve dhe kufizimin e pasojave të tyre në lidhje me shëndetin e njeriut dhe mjedisin; masat e nevojshme, në rast të ndalimit të aktivitetit, për të shmangur çdo rrezik ndotjeje dhe për të rikthyer vendin e instalimit në një gjendje të sigurt, të pastër dhe natyrale.

Një leje është e vlefshme për një periudhë dhjetëvjeçare. MMPHI shqyrton kushtet e një lejeje pas çdo pesë vjetësh dhe gjithashtu kur vlerësohet e nevojshme lidhur me: ndotjen e shkaktuar nga instalimi; ndryshimet në teknikat më të mira të disponueshme; informacionin e ri që kërkon përdorimin e teknikave të tjera në operim; ndryshimet në ligjin që aplikohen për kushtet e lejes.

Ligji parashikon gjoba që variojnë nga 15,000 deri në 50,000 euro për subjektet që funksionojnë pa autorizim nga MMPHU.

13.1.4. Autorizimi Mjedisor

Funksionimi i të gjitha aktiviteteve që nuk janë subjekt i Pëlqimit Mjedisor, Lejes Mjedisore apo Lejes së Integruar, por që megjithatë mund të shkaktojnë shqetësim mjedisor, është i lidhur me autorizimin mjedisor nga Ministria.

Procedura (aplikimi, shqyrtimi dhe vendimi) për autorizimin mjedisor përshkruhet në UA Nr. 01/2021 për Autorizimin Mjedisor. Aplikacionet shqyrtohen nga Komisioni për vlerësimin dhe lëshimin e Autorizimit Mjedisor.

13.1.5. Lejet Mjedisore Komunale

Aktivitetet që nuk janë subjekt i autorizimeve të përmendura më sipër, por që mund të shkaktojnë dëme mjedisore, janë subjekt i lejes mjedisore komunale (LMK). Qëllimi i një leje të tillë është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis të projekteve publike dhe private.

Procedura (aplikimi, shqyrtimi dhe vendimi) përshkruhet në UA Nr. 01/2017-MESP për Lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale. Shqyrtimi i aplikacioneve bëhet nga një Komision i krijuar nga Drejtori i komunës përkatëse.

Lëshimi i lejeve të ndërtimit dhe zhvillimi i aktiviteteve përkatëse është i kushtëzuar me LMK. Skadimi i vlefshmërisë së LMK bëhet nëse aplikanti nuk fillon zbatimin e projektit brenda 2 viteve.



13.2. LEJET UJORE

Të drejtat për ujin janë e drejta ligjore për të përdorur ujin nga një burim i caktuar ujor. Ato mund të jepen përmes koncesioneve ose lejeve ujore.

13.2.1. Leje Ujore

Leja për ujë është e drejta e dhënë për përdorimin ose derdhjen e një sasive uji për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë të caktuar. Lejet për ujë lëshohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MESP).

Sipas Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, leja për ujë mund të lëshohet për:

- *nxjerrjen e ujit për konsum të përgjithshëm;*
- *derdhjen e ujërave të ndotura;*
- *ndërtimin, rindërtimin ose prishjen e ndërtesave dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin e ujit;*
- *aktivitetet e minierave dhe punët gjeologjike që ndikojnë në regjimin e ujit;*
- *kërkimin hidro-gjeologjik dhe mbledhjen e të dhënave;*
- *shfrytëzimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilës;*
- *përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike dhe gjeotermale; dhe*
- *aktivitete të tjera që mund të ndikojnë në regjimin e ujit.*

Lejet për ujë përcaktojnë veçanërisht destinacionin, mënyrën dhe kushtet e përdorimit të ujit, derdhjen e ujërave të ndotura, regjimin e punës së objekteve dhe impianteve, si dhe hedhjen e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme.

Procedura (aplikimi, shqyrtimi dhe vendimi) për lejet për ujë është e rregulluar nga UA Nr. 03/2018 mbi procedurat për Lejet për Ujë.

Në varësi të llojit të objektit dhe pajisjeve, si dhe qëllimit të përdorimit të ujit, një leje për ujë mund të lëshohet për një periudhë jo më shumë se 15 vjet, përveç lejeve për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati i lumenjve dhe bregu i trupave ujorë sipërfaqësorë, të cilat lëshohen për një vit, me mundësi zgjatje. Për lejet e ujit për nevojat e energjisë, periudha e lejes mund të arrijë deri në 40 vjet.

Leja për ujë duhet të rishikohet të paktën çdo 5 vjet.

Shkelja e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-147 për kërkesën e lejes për ujë dënohet me gjobë: nga 10.000 deri 50.000 euro për personat fizikë dhe nga 50.000 deri 100.000 euro për personat juridikë.

13.2.2. Koncesionet për ujëra

Koncesioni i ujërave është kontrata që i mundëson mbajtësit të koncesionit të shfrytëzojë çdo të drejtë ekskluzive për të nxjerrë, përdorur dhe derdhur ujë, në përputhje me kushtet e koncesionit.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, aktivitetet e biznesit që kryhen me përdorimin e ujit nga trupat ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore duhet të realizohen përmes dhënies së koncesionit. Koncesioni mund të jepet për:

- *Përdorimin e ujit për sistemet e vaditjes;*
- *Përdorimin e fuqisë së ujit për gjenerimin e energjisë elektrike;*
- *Përdorimin e ujit për nevoja teknologjike;*
- *Përdorimin e ujërave minerale dhe termale;*
- *Mbushjen e ujit në shishe për qëllime tregtare;*
- *Kultivimin e peshqve dhe shpendëve ujore;*
- *Ofrimin e shërbimeve turistike, sportive dhe shërbimeve të tjera rekreative, duke përfshirë ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve të përhershme.*

Të gjithë koncesionet e ujërave jepen përmes konkursit publik.

SEKTORI I ENERGJISË



14. SEKTORI I ENERGJISË

Kosova për shumë vite i ka përmbushur nevojat e saj energjetike duke u mbështetur në termocentrale me qymyr. Megjithatë, në vitet e fundit Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në zhvendosjen e prodhimit të energjisë nga termocentralet drejt burimeve të ripërtëritshme.

Angazhimi i Kosovës për të prodhuar 35% të energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) deri në vitin 2031 përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm drejt qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë mjedisore. Ky objektiv ambicioz është në përputhje me përpjekjet globale për luftimin e ndryshimeve klimatike dhe krijon një mjedis jashtëzakonisht tërheqës dhe mbështetës për investime në sektorin e energjisë.

Si shumë vende në zhvillim, Kosova ka një kërkesë në rritje për energji. Kjo kërkesë nxitet nga rritja e popullsisë, urbanizimi dhe industrializimi.

Kosova ka potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme, veçanërisht në energjinë diellore dhe të erës. Kosova i kushton vëmendje të veçantë Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë. Ky fakt ka bërë që shumë investitorë globalë të investojnë dhe të mbështesin projekte të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Një iniciativë e tillë mbështetet nga Kosova përmes krijimit të politikave të ndryshme pozitive.

Pozita gjeografike e Kosovës ofron mundësi për integrim rajonal energjetik me vendet fqinje. Kjo mund të rrisë sigurinë energjetike dhe të hapë mundësi të tjera për tregtinë e energjisë.

Ndërsa është në proces të përmirësimit dhe modernizimit të infrastrukturës së saj energjetike, e cila përfshin sistemet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, Kosova paraqet mundësi të konsiderueshme për përmirësimin e efikasitetit energjetik, veçanërisht në sektorin rezidencial dhe industrial.

Si pasojë e liberalizimit të tregut të energjisë, Kosova ka ndërmarrë hapa seriozë për ta bërë atë më konkurrues. Kjo ka hapur dyert për shumë investitorë privatë që të marrin pjesë në treg dhe të kontribuojnë në zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Qeveria ka punuar në legjislacion dhe iniciativë politike për të inkurajuar kalimin drejt burimeve më të pastra dhe më të qëndrueshme të energjisë, për të promovuar liberalizimin e tregut dhe për të tërhequr investime nga sektori privat. Ligji për Investimet e Huaja mbron, promovon dhe inkurajon investimet e huaja në Republikën e Kosovës, duke u ofruar investitorëve të huaj një sërë të drejtash dhe garancish themelore për të siguruar që investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen me drejtësi, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të pranuar.

Korniza ligjore dhe rregullative e sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës është e formësuar nga anëtarësimi i Kosovës në Komunitetin e Energjisë dhe aspirata e saj për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

14.1. INFORMATA TJERA SHITESË NË LIDHJE ME SEKTORIN E ENERGISË NË KOSOVË

Peizazhi energjetik i Kosovës është i pasur me potencial, falë pozitës së saj strategjike gjeografike, burimeve të bollshme të ripërtëritshme dhe një mjedisi rregullativ mbështetës. Ai ofron një perspektivë premtuese për investitorët vizionarë të interesuar në shfrytëzimin e potencialit transformues të energjisë së ripërtëritshme.

Prodhimi dhe Kërkesa e Energjisë: Në nëntor 2025, disponueshmëria bruto e energjisë elektrike në Kosovë arriti në 634.84 GWh, ndërsa konsumi total i energjisë elektrike ishte 509.47 GWh, duke shënuar një rritje prej 0.39% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak. Burimet alternative të energjisë përbënin 12.14% të konsumit total të energjisë elektrike, duke reflektuar një diversifikim gradual të miksit energjetik.

Gjatë së njëjtës periudhë, importet e energjisë elektrike arritën në 325.04 GWh, ndërsa eksportet në 247.29 GWh, përfshirë sasinë e transmetuar. Këto të dhëna theksojnë varësinë e vazhdueshme të Kosovës nga tregtia ndërkufitare e energjisë elektrike për të balancuar furnizimin dhe kërkesën vendore, si dhe demonstrojnë një nivel të caktuar të kapacitetit eksportues në tregun rajonal të energjisë.

Në të njëjtën kohë, prodhimi i qymyrit, si një shtyllë kyçe e gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë, shënoi rritje. Në nëntor 2025, prodhimi i qymyrit arriti rreth 663,413 mijë tonë, duke shënuar një rritje prej

2.94% krahasuar me nëntorin 2024. Kjo rritje e prodhimit vendor të qymyrit kontribuoi në ruajtjen e prodhimit bazë të energjisë elektrike dhe në zbutjen e rreziqeve të furnizimit, veçanërisht gjatë periudhave me konsum të rritur.

Perspektiva e Energjisë së Ripërtëritshme: Sektori i energjisë së ripërtëritshme në Kosovë ofron një mundësi të jashtëzakonshme investimi, veçanërisht në energjinë e erës dhe atë diellore. Vendi ka arritur piketa të rëndësishme në rrugëtimin e tij drejt energjisë së ripërtëritshme në vitet e fundit. Më poshtë gjeni informata më të detajuara mbi zhvillimet e energjisë së erës dhe asaj diellore në Kosovë.

Energjia e Erës: Prodhimi i energjisë së erës është një segment me rritje të shpejtë në peizazhin global të energjisë. Në Kosovë, investimet në energjinë e erës janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Aktualisht, kapaciteti i instaluar i energjisë së erës është 137 MW, me disa projekte të tjera në zhvillim.

Rreth 17% e territorit karakterizohet nga shpejtësi të qëndrueshme të erës mbi 6 m/s, ndërsa zonat malore regjistrojnë shpejtësi mesatare të erës deri në 8 m/s. Këto kushte krijojnë parametra teknikë optimale për zhvillimin e kapaciteteve të energjisë së erës dhe e pozicionojnë Kosovën mbi mesataren e shumë vendeve evropiane për sa i përket potencialit të energjisë së erës.

Angazhimi i Kosovës për zhvillimin e energjisë së erës, i kombinuar me një klimë të favorshme investimi, mbështetje rregullative, stimuj qeveritarë dhe kërkesë në rritje për energji të pastër, paraqet perspektiva tërheqëse për investitorët. Zhvillues ndërkombëtarë janë të angazhuar aktivisht në projekte shtesë të energjisë së erës, duke ofruar një të ardhmepremtuesë për investime që kontribuojnë në rritjen ekonomike, qëndrueshmëri dhe avancim mjedisor.

Energjia Diellore: Pozita gjeografike e Kosovës e bën atë një lokacion ideal si për projekte të vogla ashtu edhe për projekte të mëdha fotovoltaike (PV). Ritmi i zhvillimit të projekteve diellore në Kosovë është në rritje, me interes gjithnjë e më të madh nga investitorët për angazhim në kapacitete të reja diellore në mbarë vendin.

Me një fokus të fortë në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), Kosova paraqitet si një destinacion tërheqës për investitorë dhe zhvillues të etur për të marrë pjesë në formësimin e infrastrukturës energjetike të së ardhmes.

14.2. ANKANDI I PARË SOLAR NË KOSOVË

Ministria e Ekonomisë ka zhvilluar së fundmi ankandin e saj të parë solar, i cili ka qenë i fokusuar në dhënien e një çmimi të garantuar të blerjes për energjinë elektrike të prodhuar nga një Central Solar Fotovoltaik me kapacitet 100 MW, që do të ndërtohet në tokë publike. Ky ankand parashihet të jetë i pari nga shumë ankande të energjisë së ripërtëritshme që pritet të organizohen në të ardhmen.

Qëllimi strategjik është vendosja e çmimeve konkurruese, ulja e kostove, rritja e qasjes në energji të përballueshme dhe të qëndrueshme, si dhe forcimi i transparencës në prokurimin e energjisë. Kontrata e ankandit do t'i jepet ofertuesit me çmimin më të ulët të garantuar të blerjes.

Duke zgjedhur organizimin strategjik të ankandëve, Qeveria e Kosovës synon vendosjen e çmimeve konkurruese për energjinë e ripërtëritshme, uljen e kostove, zgjerimin e qasjes në energji të përballueshme dhe të qëndrueshme, si dhe rritjen e transparencës në prokurimin e energjisë.



14.3. ANKANDI ENERGJISË SË ERËS SI NJË MOMENT KYÇ NË TREGUN E ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME NË KOSOVË

Në dhjetor 2024, Kosova ka lansuar ankandin e saj të parë konkurrues për energjinë elektrike të prodhuar nga era, me një kapacitet total të instaluar prej 100 MW. Kjo nismë përfaqëson një hap të rëndësishëm në avancimin e zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme përmes mekanizmave transparentë dhe të bazuar në treg për prokurimin e energjisë.

Ankandi është strukturuar në dy faza: faza e parakualifikimit, e cila synon të sigurojë pjesëmarrjen e ofertuesve me kapacitete të mjaftueshme teknike dhe financiare, dhe faza e ofertimit financiar. Kjo qasje synon të promovojë konkurrencë efektive, efikasitet të kostove dhe stabilitet afatgjatë të çmimeve, duke u mbështetur në përvojën pozitive të ankandeve të mëparshme për energjinë e ripërtëritshme.

Kosova ofron kushte natyrore të favorshme për prodhimin e energjisë nga era, me rreth 17% të territorit të saj të karakterizuar nga shpejtësi të qëndrueshme të erës mbi 6 m/s, si dhe potencial edhe më të lartë në zonat malore. Prodhimi i energjisë nga era përputhet gjithashtu mirë me periudhat e rritjes së kërkesës për energji elektrike, veçanërisht gjatë muajve të dimrit, duke kontribuar në sigurinë e furnizimit dhe në uljen e varësisë nga importet e energjisë elektrike.

Në tërësi, lansimi i ankandit të parë për energjinë e erës pasqyron angazhimin strategjik të Kosovës për diversifikimin e miksit energjetik dhe forcimin e pozitës së saj si një destinacion tërheqës për investime në energjinë e ripërtëritshme në rajon.

14.4. STRATEGJIA E ENERGJISË SË KOSOVES 2022-2031

Me miratimin e Strategjisë së saj Energetike, Kosova është angazhuar që deri në vitin 2031 të arrijë një pjesëmarrje prej 35% të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, si dhe synon arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050.

Një element kyç i kësaj strategjie është zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në treg, në veçanti përdorimi i ankandeve konkurruese, me qëllim sigurimin e burimeve të reja të energjisë së ripërtëritshme me çmime të përballueshme dhe konkurruese.

14.5. LIGJI PËR PROMOVIMIN E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË

Ligji për Promovimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë hyri në fuqi më 19 prill 2024 dhe vendos kuadrin kryesor ligjor për zhvillimin dhe mbështetjen e energjisë së ripërtëritshme në Republikën e Kosovës. Ligji përcakton një objektiv kombëtar, sipas të cilit burimet e ripërtëritshme të energjisë duhet të përbëjnë 32% të konsumit të përgjithshëm final të energjisë deri në vitin 2030.

Qëllimi i Ligjit është të rrisë përdorimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe kogjenerimin në sektorin e energjisë elektrike, në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes, si dhe në sektorin e transportit. Objektivat e tij përfshijnë përmbushjen e kërkesës për energji, rritjen e sigurisë së furnizimit, përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurimin e përfitimeve shoqërore dhe të shëndetit publik, duke promovuar gjithashtu mundësi të barabarta punësimi brenda sektorit të energjisë.

Skemat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë bazohen në marrëveshje kontraktuale të lidhura midis Prodhuesit të Privilegjuar dhe Operatorit të Energjisë së Ripërtëritshme. Këto marrëveshje mund të kenë formën e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (Power Purchase Agreement), një Kontrate Premium, ose një Kontrate për Diferencë (Contract for Difference), dhe zbatohen përmes premieimeve stimuluese ose tarifave stimuluese.

Kostot e skemave mbështetëse mbulohen përmes Fondit të Mbështetjes së Energjisë së Ripërtëritshme, i cili financohet nga të ardhurat e mbledhura në kuadër të detyrimeve për energjinë e ripërtëritshme. Sa i përket premieimeve stimuluese, mbështetja financiare jepet për Prodhuesit e Privilegjuar në formën e një premiumi të fiksuar—i cili paguhet mbi çmimin e tregut ditor sipas Kontratës Premium—ose një premium simetrik të lëvizshëm, i llogaritur si diferenca midis një çmimi të fiksuar dhe një çmimi referencë, dhe paguhet sipas Kontratës për Diferencë.

Në rastin e tarifave stimuluese, mbështetja financiare jepet përmes një çmimi të garantuar për blerjen e energjisë për çdo kilovat-orë të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme dhe të dorëzuar në rrjetin e energjisë elektrike, bazuar në një Marrëveshje për Blerje të Energjisë.

14.6. PIKA KYÇE TË POLITIKËS DHE MARRËDHËNIEVE PËR INVESTIME

Në këtë kontekst, disa elementë kyç kanë rëndësi të veçantë për investorët dhe aktorët e sektorit të energjisë:

- 1. Zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme përbën një prioritet strategjik të politikës publike në Republikën e Kosovës dhe reflektohet në mënyrë të qëndrueshme në instrumentet legislative, rregullatore dhe strategjike.*
- 2. Kosova ka vendosur një objektiv të qartë për zhvillimin e afërsisht 1,300 MW kapacitet të ri të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2031, duke sinjalizuar angazhimin e fortë për investime të mëdha në infrastrukturën e energjisë së pastër.*
- 3. Shteti është i angazhuar që të paktën 35% e konsumit të energjisë elektrike të sigurohet nga burimet e ripërtëritshme deri në vitin 2031, duke forcuar sigurinë afatgjatë të tregut për projektet e energjisë së ripërtëritshme.*
- 4. Ligji për Promovimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë krijon një kuadër të gjerë dhe miqësor për investorët, duke mundësuar pjesëmarrje të gjerë përmes mekanizmave transparentë, konkurrues dhe të bazuar në treg.*
- 5. Kosova mbetet e përputhur me objektivat e dekarbonizimit të Bashkimit Evropian dhe detyrimet e Komunitetit të Energjisë, duke forcuar parashikueshmërinë rregullatore dhe mbështetur konvergencën me politikat energjetike dhe klimatike të BE-së.*

FALIMENTIMI



15. FALIMENTIMI

Falimentimi në Republikën e Kosovës rregullohet nga Ligji Nr. 08/L-256 për Falimentimin, duke shërbyer si një proces ligjor kyç që u ofron bizneseve një mundësi për lehtësim nga detyrimet financiare kur nuk janë në gjendje t'i përmbushin, për shkak të humbjes së aftësisë pague. Ky kuadër ligjor luan një rol të rëndësishëm në legjislacionin e Kosovës, duke synuar të nxisë sipërmarrjen, të reduktojë stigmat rreth dështimeve të biznesit dhe, në fund, të krijojë një ambient ekonomik më të favorshëm.

15.1. PASOJAT

Procedurat e falimentimit në Kosovë mund të rezultojnë në dy pasoja kryesore: ristrukturim dhe likuidim.

15.1.1. Riorganizimi

Riorganizimi është një procedurë gjyqësore në kuadër të procedurës së falimentimit, nëpërmjet të cilës debitorit të falimentimit i mundësohet ristrukturimi i aktivitetit të tij afarist, me qëllim për të arritur në një situatë më të qëndrueshme financiare. Ky ristrukturim bëhet përmes rishikimit dhe ridrejtimit të kostove, si dhe mënyrave të prodhimit të produkteve apo ofrimit të shërbimeve.

Qëllimi kryesor i këtij procesi është të sigurojë që një kompani e cila mund të ketë vështirësi financiare, të ndjekë rrugën e riorganizimit dhe të shpëtojë nga likuidimi. Kjo bëhet e mundur pasi që procesi i riorganizimit i jep debitorit një periudhë kohe të caktuar për të rikthyer pozitën e favorshme financiare, që do të mundësonte përmbushjen e detyrimeve ndaj kreditorëve të tij. Pra, riorganizimi mund të ndihmojë në mbajtjen 'gjallë' të kompanisë në biznes, si dhe në ruajtjen e vendeve të punës.

Riorganizimi si procedurë gjyqësore iniciohet vetëm me kërkesën e debitorit. Sipas kësaj, i bie që përzgjedhja e kësaj procedure është tërësisht në vullnetin e debitorit. Megjithatë, ligji parasheh një rrethanë kur riorganizimi është i detyrueshëm për debitorin. Këtu kemi të bëjmë me rastet kur debitori i falimentimit është NVM, kur rasti çdoherë trajtohet si riorganizim.

Sidoqoftë, riorganizimi iniciohet pra nga debitori, i cili përpilon edhe planin e riorganizimit. Ky plan përmban një analizë të detajuar financiarembihapat që debitorizotohet të ndërmarrë për të përmirësuar veprimtarinë e tij afariste, me qëllim arritjen e një gjendjeje solvente, ku pastaj përmbushja e detyrimeve ndaj kreditorëve do të bëhet e mundur. Duke qenë se detyrimet nuk po realizohen aktualisht, plani i riorganizimit zakonisht përfshin edhe shtyrjen e afateve të pagesës së tyre deri në kohën kur debitori parashikon rimëkëmbjen financiare.

Pasi ky plan paraqitet në gjykatë, i njëjti i nënshtrohet procesit të votimit nga ana e kreditorëve të falimentimit, të cilët votën e tyre e japin varësisht prej vlerësimit që kanë për planin e riorganizimit të ofruar nga debitori. E në fund, plani i riorganizimit i nënshtrohet edhe miratimit nga ana e gjykatës.

Në procedurë të riorganizimit, debitori parimisht mbetet në posedim të kompanisë së tij, që do të thotë se i njëjti vazhdon të menaxhojë me kompaninë si çdoherë tjetër, përveç se tani duhet që politikat afariste t'i zhvillojë në pajtim me planin e miratuar të riorganizimit.

Qëllimi i kësaj procedure është që debitori i falimentimit të rikthehet në gjendje financiare stabile, ku do të jetë në gjendje që t'i përmbushë detyrimet që i ka ndaj kreditorëve, proces ky i rregulluar me planin e riorganizimit. Pasi plani të përmbushet në tërësi, gjykata do ta mbyllë rastin e riorganizimit dhe kompania debitore do të kthehet në kontroll të plotë të drejtuesit e saj, për ta zhvilluar aktivitetin afarist pa pengesa.

Në të kundërtën, po që se plani i riorganizimit nuk përmbushet nga debitori, që për shkak ka humbjen e vlerës së pasurisë së falimentimit, gjykata mund të urdhërojë shndërrimin e procedurës së riorganizimit në likuidim.

15.1.2.Likuidimi

Sipas ligjit tonë të falimentimit, likuidimi është një proces i cili mundëson shitjen e aseteve të debitorit dhe pastaj shpërndarjen e pasurisë së falimentimit të krijuar nga ajo shitje, te kreditorët e falimentimit, në mënyrë që të përmbushen detyrimet ndaj tyre.

Përderisa te riorganizimi qëllimi ishte rimëkëmbja financiare e debitorit, në rastet e likuidimit qëllimi është përmbushja e kërkesave të kreditorëve nëpërmjet shitjes dhe shpërndarjes së aseteve të debitorit. Edhe procedura e likuidimit hapet me vendim të gjykatës, mirëpo për dallim nga ajo e riorganizimit, këtu caktohet një administrator falimentimi, i cili e udhëheqë komplet procedurën e likuidimit, deri në shitje të aseteve – normalisht, me leje të kohëpaskohshme të gjykatës, kur këtë e kërkon ligji.

Administratori i falimentimit e merr në udhëheqje kompaninë në falimentim (debitorin), me ç'rast ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për të identifikuar dhe rritur pasurinë e falimentimit, e cila në fund do të shitet dhe shpërndahet te kreditorët, sipas rendit dhe prioritetit të përcaktuar me ligj. Kështu, administratori i falimentimit e udhëheqë edhe procedurën e shitjes së aseteve, edhe atë të shpërndarjes së pasurisë së falimentimit, të krijuar nga shitja.

Procesi i likuidimit konsiderohet i përfunduar me rastin e shpërndarjes së të gjithë pasurisë së falimentimit të krijuar nga shitja e aseteve të debitorit. Duke qenë pra se qëllimi i likuidimit është që të përmbushen kërkesat e kreditorëve nëpërmjet shitjes së aseteve të debitorit, atëherë rrjedhimisht i bie se kjo procedurë përfundon pas kryerjes së suksesshme të këtij procesi.

Natyrisht edhe nga përkufizimet si më lart ka përjashtime. Kjo pasi në disa raste nuk është e nevojshme që e gjithë pasuria e debitorit të shpërndahet, për shkak se kërkesat e kreditorëve mund të përmbushen edhe me shpërndarjen e pjesshme të saj. Ndërsa në raste tjera, që në fakt përbën shumicën e rasteve, vlera e aseteve nuk është e mjaftueshme për të përmbushur plotësisht kërkesat e kreditorëve.

BANKRUPTCY

Pavarësisht nga rastet, në momentin kur administratori i falimentimit, memjetet monetare të krijuar angashitja e asetëve të debitorit, përmbush kërkesat e kreditorëve në masën e mundur dhe sipas prioritetit ligjor; procedura e falimentimit përmes likuidimit përfundon. Me këtë rast, debitori i falimentimit shlyhet nga regjistri i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, dhe i tërë aktiviteti afarist i tij konsiderohet i përmbyllur.

Dispozitat e LF-së lejojnë shndërrimin edhe nga likuidimi në riorganizim, po që se arsyeshëm mund të konstatohet se në atë mënyrë kreditorët do të realizonin kërkesat e tyre në masë më të madhe.

Pra, edhe në rastet kur debitori ka kërkuar likuidimin, riorganizimi mund të konsiderohet më i favorshëm nëse asetet e debitorit nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kënaqshëm kërkesat e kreditorëve, ndërsa në anën tjetër ekziston një perspektivë e qëndrueshme për rritje të ardhshme të të hyrave të debitorit, me ç'rast riorganizimi mund të krijojë mundësi për një kthim më të lartë dhe më të drejtë të borxheve.

15.2. PROCEDURA E FALIMENTIMIT

Procedura e falimentimit sipas dispozitave të LF-së, mund të fillojë në dy mënyra: (i) sipas kërkesës së debitorit për fillim të procedurës (inicimi vullnetar); dhe (ii) sipas kërkesës së kreditorëve për fillim të procedurës (inicimi jo-vullnetar).

1. Inicimi vullnetar: nënkupton paraqitjen e kërkesës së debitorit për riorganizim apo për likuidim pranë gjykatës. Në këtë rast, procedura e falimentimit pranë gjykatës së falimentimit fillon me propozimin e vetë debitorit për riorganizim apo likuidim. Duke qenë se ky propozim parashtrohet prej debitorit i cili pretendon se është në paaftësi paguese apo afër kësaj gjendjeje, atëherë i njëjti së bashku me kërkesën duhet të paraqesë edhe dëshmitë e nevojshme, përkatësisht dokumentet financiare adekuate që vërtetojnë një pretendim të tillë.

2. Inicimi jo-vullnetar: është situata kur një apo më shumë kreditorë paraqesin pranë gjykatës së falimentimit kërkesën për iniciimin e procedurës së falimentimit ndaj një debitori. Për iniciimin e procedurës së falimentimit nga kreditorët, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme, në varësi nëse kërkesa paraqitet nga një kreditor ose nga më shumë kreditorë:

Për një kreditor:

- i. Debitori nuk ka paguar të paktën një detyrim për më shumë se 90 ditë.
- ii. Totali i detyrimit të jetë të paktën 30,000 Euro.
- iii. Detyrimi të jetë pa kushte dhe të mos jetë në procedurë kontestimore në gjykatë ose arbitrazh.
- iv. Kreditori nuk ka arritur ta arkëtojë borxhin përmes përmbarimit ose procedurave tjera.

Për dy ose më shumë kreditorë:

- i. Debitori nuk ka paguar të paktën dy detyrime, secili me vonesë prej mbi 90 ditësh.
- ii. Vlera e secilit detyrim të jetë të paktën 5,000 Euro.
- iii. Çdo detyrim të jetë pa kushte dhe të mos jetë në procedurë kontestimore.
- iv. Kreditorët nuk kanë arritur ta arkëtojnë borxhin përmes përmbarimit ose procedurave tjera.
- v. Debitori përgjithësisht nuk po përmbush borxhet pas afatit të pagesës, me një total të papaguar mbi 7,000 Euro.

Në të dy rastet, po që se gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore adekuate, vendosë për inicimin e procedurës së falimentimit (hapjen e rastit). Ky vendim i gjykatës ka pasoja juridike të menjëhershme, siç janë:

1. Maturimi i kërkesave: me hapjen e procedurës së falimentimit, të gjitha kërkesat e kreditorëve, të cilat janë të paarritura për pagesë deri në atë moment, bëhen të arritura sipas ligjit. Kjo do të thotë që, pa marrë parasysh datën e paracaktuar të pagesës, të gjitha detyrimet e debitorit konsiderohen të arritura me hapjen e procedurës, duke mundësuar kështu trajtimin e tyre në procesin e falimentimit.

2. Krijimi i pasurisë së falimentimit: hapja e procesit të falimentimit ka për pasojë edhe krijimin e pasurisë së falimentimit, e cila përbëhet nga të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të debitorit, si dhe interesat e kërkesat në favor të debitorit, ekzistuese në kohën e hapjes së rastit. Kjo pasuri mund të shtohet pas veprimeve ligjore adekuate gjatë zhvillimit të procedurës.

3. Moratoriumi: vendimi i gjykatës për hapjen e falimentimit vendos edhe moratoriumin mbi debitorin e falimentimit dhe pasuritë e tij. Moratoriumi ndalon të gjitha proceset gjyqësore, administrative, përmbarimet, si dhe çdo lloj procedure tjetër e drejtuar kundër aktivitetit afarist të debitorit apo pasurive të tij. Kjo ndalesë vlen për rastet aktive në momentin e hapjes së rastit, si dhe për ato që inicohen më pas.

4. Shkarkimi i debitorit nga kontrolli i pasurisë: debitori humbet kontrollin mbi pasurinë e falimentimit, e cila kalon nën mbikëqyrjen e plotë të administratorit të falimentimit për menaxhim, shitje dhe shpërndarje.

5. Jurisdiksioni ekskluziv i gjykatës: gjykata e falimentimit merr kontrollin e plotë dhe ekskluziv mbi debitorin dhe pasurinë e falimentimit, duke i dhënë asaj autoritetin për të vendosur mbi të gjitha aspektet e procesit.

Këto pasoja juridike paraqiten pra sipas vet ligjit me t'u iniciuar procedura e falimentimit me vendim të gjykatës. Secila prej tyre është e domosdoshme në mënyrë që kjo procedurë të zhvillohet pa pengesa sipas përcaktimeve ligjore, duke u arritur në këtë mënyrë qëllimi i saj.

Në përmbledhje, rregullat e falimentimit në Kosovë ofrojnë një kornizë të rëndësishme ligjore për një sistem financiar të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm. Ato shërbejnë si një mekanizëm mbrojtës për individët dhe bizneset që përballen me vështirësi financiare, duke i bërë thelbësore si për investitorët vendorë ashtu edhe për ata të huaj që zhvillojnë veprimtari ekonomike në Kosovë. Këto rregulla ofrojnë mekanizma ligjorë për mbrojtjen e interesave të shoqërive në rast të gjendjes së vështirë financiare ose sfidave në ushtrimin e veprimtarisë afariste.

FJALË PËRMBYLLËSE

Me publikimin e edicionit të dytë të këtij udhëzuesi gjithëpërfshirës ligjor, kemi kënaqësinë t'ju ofrojmë një burim më të përditësuar dhe më të pasuruar për investitorët që shohin mundësi investimi në Kosovë. Ky udhëzues është ndërtuar mbi bazën e edicionit të parë dhe përfshin zhvillimet më të fundit ligjore, sektorët në zhvillim të investimeve, si dhe informacion të përditësuar mbi lehtësirat dhe praktikatat më të mira për zhvillimin e biznesit në vend.

Kosova vazhdon të ofrojë një ambient investimi dinamik dhe premtues, me tregje në rritje, mundësi strategjike dhe një kuadër ligjor mbështetës. Ky udhëzues synon t'ju ofrojë njohuritë dhe kuptimin praktik të nevojshëm për të kuptuar qartë këtë kuadër në zhvillim dhe për të marrë vendime të informuara dhe të sigurta.

Shpresojmë që edicioni i dytë të shërbejë jo vetëm si një referencë, por edhe si një udhëzues praktik gjatë udhëtimit tuaj investues në Kosovë. Duke qëndruar të informuar, duke shfrytëzuar mundësitë më të reja dhe duke bashkëpunuar me ekspertë ligjorë dhe financiarë të besueshëm, ju mund të shfrytëzoni plotësisht potencialin që ofron Kosova.



VOKSHI & LATA

LAW FIRM

**Rr. “Holger Petersen”, Objekti “Park Residence”,
Hyrja 4, Kati 0, Numër 2,
Prishtinë, Kosovë.**

+383 44 55 66 70

Info@vokshilata.com

www.vokshilata.com